



Instituti për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar IZHBEN – FAMA

Financues i projektit Kolegji FAMA

PROJEKTI I HARTIMIT TE PROGRAMEVE TE PUNESIMIT TE STUDENTEVE TE KOLEGJIT FAMA

Realizues te projektit:

**Isak Mustafa
Bekim Marmullaku,
Selman Selmanaj,
Demir Lima**

Prishtinë , prill 2013

Përmbajtja

Hyrje.....	2
I. LLOJET DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT INDUSTRISE SË DRURIT	8
II. PROGRAMET PËR KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESEVE NË INDUSTRIINË E LËKURË-KËPUCËVE	13
III. PROGRAMET PËR KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESEVE NË INDUSTRIINË E TEKSTILIT	18
IV. PROGRAMET PËR KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESEVE NË BUJQËSI	26
V. PROGRAMET E BIZNESIT PËR KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E INDUSTRISE USHQIMORE DHE PIJEVE	39
VI. PROGRAMI PËR FORMIMIN E BIZNESEVE BUJQËSORE NË KUADËR TË INDUSTRISE, XEHETARISE DHE PYLLTARISE	42
VII. PROGRAMET PËR KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESEVE NË TREGTI	46
VIII. PROGRAMET E ZHVILLIMIT TË BIZNESIT ZEJTAR	50
IX. LITERARURA.....	66

Hyrje

1. QËLLIMI DHE RËNDËSIA E IDENTIFIKIMIT TË PROGRAMEVE TË KRIJIMIT TË BIZNESEVE TË REJA

Identifikimi ka për qëllim gjetjen e programeve adekuate për krijimin dhe zhvillimin e bizneseve të veprimtarive të ndryshme. Synohet që programet e identifikuar të jenë atraktive, akumulative, me çmim të lire të vendit të punës dhe të jenë të përshtatshme për aplikim praktik.

Në zhvillimin e deritashëm ekonomiko-shoqëror të ne, kanë munguar programet e zhvillimit dhe të punësimit për veprimtaritë e ndryshme ekonomike dhe shoqërore edhe pse ekzistojnë resurset materiale dhe kadrovike si faktorë të rëndësishëm në zhvillim dhe punësim.

Për ndryshimin e strukturës ekonomike dhe shoqërore nevojiten të identifikohen dhe aplikohen programe atraktive nga aspekti i ekonomisë së tregut të orientuara për eksport, programe të cilat do t'i plotësojnë nevojat individuale dhe shoqërore me qëllim të ngritjes së nivelit të standardit dhe mirëqenies materiale shoqërore.

Identifikimi i programeve duhet të motivohet me efekte pozitive materiale financiare e veçmas nëse aplikimi praktik i këtyre programeve mundëson rritjen e shpejtë të punësimit dhe ngritjen e nivelit të afarizmit të biznesit tonë në përgjithësi.

Përparësitë komperative të programeve të identifikuar, të cilat do të përmbajnë teknologji dhe produkte të reja, do të mundësojnë shfrytëzimin racional të resurseve tona ekonomike, duke përfshirë potencialin teknik dhe kadrovik nga të gjitha viset tona.

Hulumtimet e bëra profesionale shkencore deri më tash tregojnë se në nivel të çdo familjeje, fshati, qyteti, ekzistojnë mundësitë për identifikimin e ndonjë programi atraktiv specifik në bazë të të cilit do të formoheshin punëtori, dyqane, shitore, ndërmarrje të vogla, kooperativa dhe forma të tjera të organizimit biznesor.

Rëndësi të madhe, në kushtet e tashme, për zhvillimin tonë ka identifikimi i programeve në sektorin e biznesit privat, por edhe të atij shoqëror me qëllim të gjetjes së programeve të reja që do të shërbejnë si bazë, qoftë në zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese, qoftë për formimin e ndërmarrjeve, dyqaneve dhe kooperativave-të reja.

Në hulumtimet e bëra me karakter profesional dhe shkencor me qëllim që të identifikohen sa më shumë programe dhe të formohen sa më shumë firma të reja, synohet të sigurohet një bazë e informatave tekniko-shkencore, që do të shërbejnë në hartimin e konceptonit të zhvillimit strategjik të biznesit në periudhat e ardhshme afatgjata. Mendojmë se rezultatet e hulumtimeve nga ky lëmë përmbajnë propozime dhe ide të shumta, udhëzime për marrjen e masave konkrete për realizimin e shpejtë dhe të suksesshëm të aktiviteteve biznesore në formë të ndryshme të organizimit me elemente të zhvillimit bashkëkohor të biznesit tonë privat në përputhje me ekonominë e tregut.

Koncepti i hulumtimit nga lëmi i identifikimit të programeve të punësimit synon ta paraqet një tërësi të rrumbullakuar të studimit në identifikimin e programeve të punësimit, që është faktor i rëndësishëm në zhvillimin e biznesit privat. Nga ky aspekt është hulumtuar gjendja ekzistuese,

niveli dhe dinamika e punësimit, faktorët që kanë determinuar zhvillimin e deritashëm të biznesit privat, kushtet dhe mundësitë e punësimit ne bazë të programeve të identifikuar etj.

Nga ky aspekt rëndësi të veçantë kanë reformimi struktural e ekonomik - shoqëror, veçmas transformimi i pronës shoqërore në forme private, kooperativiste dhe zgjedhja e shumë problemeve të tjera sistemore që e kushtëzojnë zhvillimin më të shpejtë të biznesit tonë privat.

Hulumtimet profesionale shkencore të arritura në periudha të ndryshme të zhvillimit tonë deri më tani kanë mundësuar që të identifikohen programe të punësimit, në formë të projekteve ideore parainvestigacionale, që përmbajnë treguesit me karakteristikë në bazë të të cilëve janë përcaktuar madhësitë e vlerave me karakter ekonomik, teknik, financiar, kadrovik etj., që mund të shërbejnë si bazë solide për zhvillimin e aktiviteteve investicionale për zhvillimin e programeve konkrete të punësimit, ne ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese shërbyese që do të bazoheshin në teknologjinë bashkëkohore dhe në gjetjen e tregjeve atraktive, që është e mundur nëse struktura e investimeve të programeve të punësimit mundëson çmimin e lire të vendit të punës me akumulim maksimal, që do të shërbejë si bazë e zhvillimit të mëtejshëm për formimin e vendeve të reja të punës.

Synohet hapja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në të gjitha veprimtaritë e biznesit, por me dominim në veprimtaritë prodhuese dhe shërbyese.

Hulumtimet nga lëmenjtë e ndryshëm për identifikimin e programeve konkrete janë bërë individualiste nga punëtorët e ndryshëm shkencore te ne dhe në botën e jashtme, të cilët përvojnë dhe rezultatet nga ky lëmë i kanë publikuar në projekte, punime shkencore, ne revista, si kumtesa në tubime shkencore etj, por puna më e madhe hulumtuese shkencore nga ky lëmë është zhvilluar në punë ekipore në kuadër të institucioneve profesionale shkencore te ne dhe në botën e jashtme..

Ndryshimet në strukturën ekonomike, në strukturën e pronësisë, zhvillimi i pronësisë private (nxitja e iniciativës ndërmarrëse, formimi i ndërmarrjeve, dyqaneve, punëtorive, kooperativave etj.), si dhe përvojat në zhvillimin e deritashëm të biznesit privat, kanë ndikuar në identifikimin dhe zgjedhjen e këtyre programeve për aplikim konkret në biznesin tonë, me qëllim të zbutjes së problemit të papunësisë dhe pengimit të emigrimit të të rinjve në botën e jashtme. Janë trajtuar probleme teorike e kryesisht praktike nga aspekti i hapjes së perspektivës së të rinjve për një punësim më të shpejtë me çmim më të lire të vendit të punës, me formimin e programeve atraktive akumuluese për tërheqjen e kapitalit dhe nxitjen e kthimit të punëtorëve tanë të punësuar në botën e jashtme. Kjo arrihet me zgjedhjen e programeve konkrete për formimin e firmave të reja.

Programet e identifikuar mund të orientohen, kryesisht, në formimin e ndërmarrjeve të vogla që punësojnë deri në 10 punëtorë, që është më se 60% e tërë programeve të identifikuar dhe 71% të firmave të propozuara. Një pjesë e këtyre programeve dhe firmave mund të orientohet në formimin e ndërmarrjeve të mesme, kooperativave, punëtorive etj.

Në bazë të studimeve dhe përvojave të arritura lidhur me zhvillimin e deritashëm të ekonomisë sonë, veçmas në njohuritë lidhur me problemet strukturale të ekonomisë, problemet e papunësisë dhe tendencat në dinamikën e zhvillimit të deritashëm të zhvillimit të biznesit privat është bërë përpjekje, që programet e identifikuar dhe formimi i firmave të reja të biznesit privat të orientohen kryesisht në biznesin e vogël, në lëmin zejtar, tregtar, shërbyes, shoqëror, në industrinë ushqimore, në veprimtarinë bujqësore, në ndërtimtari, transport, hotelieri, turizëm etj, duke insistuar që në të ardhmen të formohet një strukturë optimale në zhvillimin e biznesit privat, duke respektuar ligjet dhe kushtet e biznesit bashkëkohor. Nga ky aspekt më se 33% të programeve të identifikuar dhe të propozuara për realizim i përbëjnë programet dhe firmat në veprimtaritë zejtare, më se 15% programet e veprimtarive bujqësore dhe të industrisë ushqimore, më se 10%

programet me karakter të shërbimeve shoqërore-hoteliere-turistike, më se 10% të programeve në zhvillimin e biznesit tregtar dhe më se 15% të këtyre programeve janë nga industria e drurit, kimike, e tekstilit etj.

Nga ky aspekt rezultatet shkencore dhe përvojat e arritura të realizimit të këtyre projekteve zënë vend të posaçëm në konceptin dhe përmbajtjen e programeve të identifikuar dhe të propozuara për aplikim në lëmin e punësimit dhe zhvillimit të biznesit privat. Duhet të kemi parasysh se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të jenë forcë motorike e zhvillimit ekonomik shoqëror. Për këtë arsye në përcaktimet dhe orientimet tona duhet respektuar përvoja e shteteve të zhvilluara, teknologjia dhe transferi në kushtet e ekonomisë sonë e veçmas në zhvillimin e bujqësisë, industrisë përpunuese etj. Duhet kushtuar kujdes të veçantë aftësisë të kuadrove, të profilit ndërmarrës, nëpërmes formave të ndryshme të arsimimit, siç janë studimet e rregullta dhe studimet pasdiplomike, punimi i magjistraturave dhe doktoratave, specializimet, kurset, seminarët, formimi i laboratorëve dhe instituteve ku do të angazhoheshin dhe punësoheshin kuadro të talentuara dhe me ambicie të zhvillimit të aktiviteteve ndërmarrëse menaxherike dhe krijimit të liderëve bashkëkohorë.

Efikasiteti i zhvillimit të biznesit privat duhet të bazohet në programe kualitative që kanë si bazë idenë e mire dhe kapitalin e nevojshëm. Në jemi deficitarë me këto elemente dhe detyrohemi në këtë fazë fillestare të zhvillimit të biznesit privat të huazojmë idetë, teknologjinë, kapitalin, organizimin dhe elemente të tjera për zhvillimin e një biznesi bashkëkohor konkurrent si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm. Duhet të kihet parasysh programet që punësojnë 5 deri në 10 punëtorë me angazhim të kapitalit prej 10.000€ deri 100.000€. Realizimi i këtyre programeve do të shërbente si bazë për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik shoqëror dhe për rritjen e punësimit në vende të lira të punës. Puna në identifikimin dhe realizimin e programeve të zhvillimit dhe punësimit duhet të jetë proces kontinuitiv, duke përmbajtur zgjedhjen e ideve ndërmarrëse, përgatitjen, vlerësimin, realizimin e programeve dhe realizimin e rezultateve afariste.

Programimi i zhvillimit të punësimit kërkon përkrahje, kohë dhe shpenzime, që do të thotë se është investim në të tanishmen për të realizuar efekte në të ardhshmen. Punën në programin e zhvillimit dhe punësimit, duhet racionalizuar dhe organizuar, duke filluar prej zgjedhjes së idesë deri te eksploatimi, gjegjësisht komercializimi. Zgjedhja e ideve duhet të marrë formën e zgjidhjeve ideore të bazuara në përvoja të përgjithshme, informata teknologjike, ekonomike, financiare etj. Duhet mundësuar zgjedhjen e ideve që janë të përshtatshme nga aspekti i tregut, teknikës, teknologjisë, organizimit, financimit dhe kriterëve të tjera shoqërore që mund të shërbejnë në punën e mëtejme në formë të hartimit - studimit parainvesticional, që paraqet studimin në nivel më të lartë të elaborimit të zgjedhjes së idesë, që do të thotë zgjedhja ideore mundëson vendosjen për hartimin e studimit investicional eventual. Vetëm studimi investicional me tërë bazën dokumentuese mund të shërbejë për marrjen e vendimit përfundimtar se a do të pranohet apo do të hiqet dorë nga ndonjë prej programeve të identifikuar, të propozuara e të prezantuara. Pasi të aprovohet studimi investicional duhet qasur hartimit të studimit detal që do të mundësojë zhvillimin, kryerjen dhe realizimin e programit konkret. Aktiviteti i tërësishëm lidhur me identifikimin e programeve, hartimin e studimeve parainvesticionale, studimin investicional dhe realizimin e tyre në programe konkrete kërkon një qasje multidisciplinare dhe angazhim të një numri ekspertësh me njohuri nga lëmenj të ndryshëm profesionalë që mund të japin zgjidhje për probleme konkrete. Nga ky aspekt në programet e identifikuar dhe të propozuara janë konsultuar kuadro interdisciplinare nga vendi dhe ekspertë të ndryshëm të shteteve të zhvilluara botërore. Kjo ka qenë me se e nevojshme që për çdo program, zakonisht, të krijohet dokumentacioni në

aspektin e tregut, në aspektin teknik-teknologjik, në aspektin ekonomik-financiar, në aspektin organizativ, menaxherik, urbanistik-ndërtimor, ekologjik, juridik, politik e të tjera. Në bazë të analizave hartohen planet afariste, të ashtuquajturat plane të biznesit, që do të shërbejnë si bazë për inicimin, financimin, organizimin, zhvillimin, kontrollimin e aktiviteteve ndërmarrëse gjatë tërë afatit të jetesës së programit të propozuar.

Në këtë punim i paraqesim në formë të shkurtër, si informata të rëndësishme të zgjedhjes ideore, për çdo program, me qëllim që të nxitet hartimi i studimeve parainvesticionale dhe investicionale, duke hartuar edhe planin biznesor për realizimin e tyre. Kjo do t'i mundësojë çdo ndërmarrësi potencial që të mundet shumë shpejt dhe në mënyrë kualitative të ndërmarrë aktivitetet, të financojë dhe të udhëheqë dhe zhvillojë biznesin në dobi të vet dhe në dobi të përgjithshme.

Propozimi i zgjedhjes së programeve të identifikuar për punësim nuk është planifikuar deri në detale. Studimi i mëtejshëm i detajuar do të varet nga interesi dhe nevojat e subjekteve të biznesit privat. Zgjedhja e programeve konkrete është bërë nga veprimtaritë tradicionale të biznesit, janë organizuar biseda të shkurtra me ekspertë si dhe me pronarët e firmave ekzistuese private nga meset e ndryshme të vendit tonë. Pronarëve të këtyre firmave dhe individëve të tjerë të interesuar për hapjen e firmave të reja u është propozuar që t'u ofrohen programet e identifikuar, realizimi i të cilave mund të ofrojë prodhime dhe shërbime atraktive për tregun tonë dhe të jashtëm. Në këtë mënyrë ka lindur dhe është zhvilluar ideja e zhvillimit të programeve prodhuese-shërbyese me teknologji të re dhe të ndryshme në forme të studimit me titull "Punësoj veten dhe të tjerët" e që të gjitha programet janë përmbledhur në formë të librit të programeve për Krijimin dhe Zhvillimin e Bizneseve.

2. DISA TREGUES KARAKTERISTIKË TË PROGRAMEVE PËR KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESEVE

Nga programet e identifikuar për zhvillimin e biznesin privat në zejtarinë prodhuese - shërbyese dhe janë identifikuar 30 programe, në bujqësi dhe në industrinë ushqimore 47 programe, në biznesin tregtar 4 programe, në industrinë e drurit 9 programe, në industrinë e tekstilit 17 programe dhe në industrinë e lëkurë-këpucëve 8 programe, gjithsej 115 programe

Në kuadër të këtyre programeve është vlerësuar se mund të punësohen në biznesin zejtar - prodhues, shërbyese dhe transportues afër 300 punëtorë, në biznesin tregtar afër 120 punëtorë, në biznesin bujqësor afër 200 punëtorë. Nga aspekti i punësimit janë me rëndësi edhe: industria e tekstilit afër 270 punëtorë, industria e lëkurë-këpucëve mbi 200 punëtorë, industria e drurit mbi 300 punëtorë.

Në kuadër të këtyre programeve ku parashihet të formohen më shumë firma në zejtarinë prodhuese shërbyese, në shërbimet transportuese dhe në veprimtaritë e biznesit tregtar që në këtë të fundit janë mbi 300 firma ku secila do të punësonte përafërsisht prej 10 deri 13 punëtorë. Mbi 350 firma gjegjësisht njësi punuese mund të formohen në biznesin bujqësor dhe në industrinë ushqimore, çdonjëra prej tyre përafërsisht mund të punësojë nga 11 punëtorë.

Në programet e biznesit të industrisë së tekstilit dhe të industrisë së lëkurë këpucëve mund të formohen mbi 150 firma të reja ku mesatarisht një firmë mund të punësojë mbi 30 punëtorë. Në industrinë e drurit gjithashtu parashihet të formohen mbi 100 firma (njësi punuese) që secila do të punësonte prej 9 deri 19 punëtorë, varësisht se për cilën veprimtari të biznesit është fjala.

Është vlerësuar se secila firmë përafërsisht mund të punësojë nga 13 punëtorë, mirëpo numri më i madh i të punësuarve në një firmë mund të jetë te industria e lëkurë-këpucëve 32 punëtorë, te industria e tekstilit 30 punëtorë.

Për realizimin e programeve parashihet madhësia e lokalit për një firmë mbi 300 m², kurse për një punëtor të punësuar përafërsisht 30 m².

Sa i përket sipërfaqes së lokalit afarist, përveç bujqësisë dhe industrisë ushqimore, vend me rëndësi zënë edhe lokalet për tregti, veçmas lokali afarist për shitje me shumicë, dhe pakicë, për shitoret klasike, shtëpitë e mallrave, minimarketet, stacionet grumbulluese, depot për qendrat e ndryshme tregtare në qytete dhe fshatra.

Lokali më i madh afarist për një firmë, sipas vlerësimeve, duhet siguruar te programet e punësimit në bujqësi dhe në industrinë ushqimore, në industrinë e lëkurë-këpucëve, në industrinë e drurit. Për një punëtor nevojiten të sigurohen: në programet e punësimit zejtar 12m², në industrinë e tekstilit 13m², në biznesin tregtar 22m², në veprimtarinë metalo-përpunuese 24m², në biznesin e industrisë së lëkurë-këpucëve 27m² etj.

Vendi më i shtrenjtë i punës për punësimin e një punëtori, sipas vlerësimeve tona, është në industrinë e drurit 84.000€, pastaj në programet e punësimit në bujqësi dhe në industrinë ushqimore 68.000€, në industrinë e lëkurë-këpucëve 50.000€ për një vend pune, kështu që në programet e punësimit të industrisë së drurit dhe të industrisë së lëkurë-këpucëve që mund të punësojnë mbi 250 punëtorë.

Nga aspekti i realizimit të bruto fitimit programet më akumulative janë në zejtari ku raporti i bruto fitimit ndaj kapitalit të angazhuar është 1.3 (në 1€ investime -1.3€ bruto fitim), Programet më pak

akumuluese, sa i përket raportit të kapitalit dhe bruto fitimit, janë programet e industrisë së drurit, industrisë së lëkurë-këpucëve.

Është karakteristike se në disa programe të identifikuara siç janë: veprimtaritë e industrisë së drurit, industria e lëkurë-këpucëve, të cilat kanë koeficient të ulët të raportit mes kapitalit të angazhuar dhe bruto fitimit për një punëtor realizojnë fitimin më të madh sesa mesatarja e të gjitha programeve.

DISA KARAKTERISTIKA DHE RËNDËSIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS SË DRURIT

Identifikimi i programeve nga përpunimi i drurit bazohet në shfrytëzimin e resurseve materiale, natyrore me të cilat disponojmë nga kjo veprimtari, duke pasur parasysh numrin e të papunësuarve dhe përvojat e kuadrove që janë të punësuar në këtë veprimtari e që disponojnë me një përvojë të gjatë të ne.

Janë iniciuar një numër idesh që mund të komponohen në identifikimin dhe hartimin e projekteve për përpunimin e drurit në prodhime të llojeve të ndryshme siç janë: *programi i prodhimit të galanterisë së drurit, programi i prodhimit të zdrukthëtarisë ndërtimore, programi i prodhimit të paletave dhe ambalazhës së drurit, programi i prodhimit të pllakave dhe ivericës së drurit, programi i prodhimit të shpërplakave, programi për prodhimin e briketit, programi për prodhimin e mobilieve dhe orendive shtëpiake, të lokaleve afariste, programi i prodhimit të veglave të drurit për nevoja të bujqësisë, pajisje dhe instrumente të ndryshme për nevoja të shkollave si dhe shumë produkte që mund të përdoren në ndërtimtari si dërrasat e holla për kulm etj.* Në identifikimin e programeve prodhuese nga përpunimi i drurit janë komponuar shumë ide dhe rezultate shkencore sidomos informatat për përcaktimin e normave teknike, ekonomike të programeve konkrete siç janë: madhësia e lokalit afarist, numri i të punësuarve, kapitali i deponuar, bruto fitimi vjetor, raporti në 1€ investime.

Produktet e industrisë së drurit kanë karakteristika të veçanta siç janë: prodhimet luksoze, shërbejnë konsumit të gjerë në afat të gjatë, shumë prej këtyre produkteve nuk janë të diferencuara si parketi, produktet e galanterisë, ambalazhit etj.

Nga ky aspekt duhet pasur kujdes se çka prodhohet dhe për kë do të prodhohet, kush do të punësohet dhe me çfarë çmimi të kushtimit do të prodhohet dhe çfarë fitimi do të krijohet etj.

Në kuadër të këtij punimi janë prezantuar identifikimi i programeve, realizimi praktik i të cilave do të mundësoj punësimin e punëtorëve, angazhimin e kapitalit, ndërtimin e lokalit afarist, sigurimin e bruto fitimit vjetor, çmimi i kapitalit për një punëtor dhe fitimi për një punëtor, raporti në 1 € investime.

I. LLOJET DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT INDUSTRIKË SË DRURIT

1. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E GALANTERISË SË DRURIT

Kjo fushë përfshinë asortimentin e gjerë të sendeve shtëpiake si mjetet e sendeve shtëpiake, aparateve ose pjesëve të stabilimenteve dhe mund të identifikohen në këto programe: pjesët e veglave shtëpiake, (te kuzhinës varëset, garnishllat, llajsnat dekorative, kapse petkash – vegla për mbajtjen e teshave, elementet për veglat me kombinim me materiale të tjera (shkallë, kolovajza, policat këndore etj.), pjesët për çerdhe të fëmijëve, foshnjoreve, pjesët për nevoja të këpucëtarëve (take, nallane, kallëpe etj.), llambadarët, këmbalec për qirinj, lule, kornizat për piktura, pasqyre etj.

Në kuadër të këtij programi mund të formohen punëtori për përpunimin gjysmë industrial në seri të vogla të prodhimit të galanterisë së drurit siç janë: kleçkat për dhëmbë ose rrëmojca, shkopinj të për akullore, shkopinj të për mish të fërguar, prodhimi i produkteve dekorative, p.sh.: për lojëra, për lule etj.

Programet e këtyre prodhimeve duhet të jenë elastike, të përshtatshme me qëllim që asortimenti i tyre t'u përgjigjet nevojave të tregut apo të punohen sipas porosisë.

Drunjtë për prodhimin e këtyre produkteve duhet të teren, të jenë të llojeve të ndryshme, të ahut, të bungut, të arrës, të frashrit etj.

Varësisht nga madhësia e programit duhet të ekziston edhe tertorja e drurit me qëllim që të shkurtohet procesi i prodhimit, duhet të shfrytëzohen mbeturinat e drurit me rastin e përpunimit të këtyre prodhimeve, në këto prodhime mund të komponohen edhe produkte të tjera të metalta apo të plastikës, duhet aplikuar teknologji moderne në realizimin e këtyre produkteve, t'i kushtohet kujdes problemeve ekologjike.

Prodhimet e këtyre programeve mund të angazhohen në reparte të veçanta të prodhimit duke punësuar numër të vogël apo të madh të punëtorëve, madhësia e reparteve për realizimin e këtyre programeve mund të jenë 5 e më shumë punëtorë varësisht prej numrit të papunësuarve, nevojave të tregut, sigurimit të lëndës së parë etj.

Për realizimin e prodhimeve të galanterisë së drurit p.sh. programi që punëson 5 deri në 10 punëtorë, parashihen normat e caktuara të sigurimit të lokalit afarist prej 150m², të sigurohet kapitali prej 513.000€ ku do të realizohet bruto fitimi vjetor në shumë prej 176.000€, në raport 1€ investime 0,34€ bruto fitim. Këto norma mund të ndryshojnë varësisht prej numrit të punëtorëve dhe llojit të produktit. P.sh. për prodhimin e galanterisë së drurit në mënyrë gjysmë industriale mund të punësohen numër më i madh i punëtorëve, 7 deri në 14 punëtorë, ku nevojitet siguri i lokalit prej 100m² deri në 200m², ndërsa kapitali i deponuar do të jetë më i vogël se sa te programi i prodhimit të galanterisë prej 5 punëtorëve, ku puna duhet të jetë më profesionale dhe më e modernizuar, ku realizohen produkte dekorative dhe atraktive. Te ky program konkret duhet të sigurohet kapitali prej 123.000€ deri në 246.000€, normalisht do të shpenzohet kryesisht për pajisje teknike, për makina, instalime, vegla pune dhe lokal afarist. Bruto fitimi vjetor te ky

program do të jetë më i madh se te programi tjetër prej 104.000€ deri në 208.000€, në raport 1€ investime 0,80€ bruto fitim.

Programet që mund të punësojnë më shumë punëtorë nga prodhimet e galanterisë kanë gjithashtu rëndësi për zhvillimin e biznesit të industrisë së drurit, reparalet formohen në një nivel më të lartë të prodhimit.

Në kuadër të reparaletve mund të zhvillohen shërbime të ndryshme teknike, të formohen tertoret për terjen e drunjve, shërbimet komerciale etj.

2. PROGRAMI I PRODHIMIT TË PALETAVE DHE AMBALAZHËS PREJ DRURIT

Për prodhuesit e këtij programi ka nevojë tregu e posaçërisht për ambalazhin për pemë dhe perime. Me këtë program mund të përfshihen dy reparalet ku kishin me u përpunua 2.000 deri 2.500m² të hedhurinave nga druri dhe do të punësoheshin 80 punëtorë.

Ky program bazohet në prodhimin e ambalazhit prej drurit siç janë: prodhimi i paletave, sanduqeve me destinime të caktuara, prodhimi sanduqeve për pemë dhe perime, për artikuj nga shpezëtaria, prodhimet e të gjitha tipave të sanduqeve, kontejnerëve, ambalazhi për paketimin e dërgesave të veçanta. Ambalazhi nga druri me makina dhe vegla shumë të thjeshta, gati pothuajse kryesisht me dorë, nëse nuk kemi të bëjmë me ndonjë seri të madhe të këtij ambalazhi.

Prodhimet e këtij programi duhet të jenë shumë fleksibile.

Kapacitetet e këtij programi duhet locuar në vendet konsumuese të ambalazhit siç janë qendrat tregtare, në vendet ku kultivohen pemët e perimet, këto kapacitete duhet ndërtuar në vendet ku është zgjedhur infrastruktura, ku ekziston rryma, uji, rruga e asfaltuar etj.

Duhet pasur kujdes që programi të jetë afatgjatë, funksional, të ketë asortiment të ndryshëm, çmimi i prodhimit të jetë i lirë, të sigurohen kushtet për bashkëpunim afatgjatë të blerësit dhe konsumuesit. Kuadrot që do të punojnë në këtë program duhet të kenë kualifikim dhe përvoja profesionale.

Duhet hulumtuar tregun dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut ky program duhet të inovohet me modele dhe asortimente të reja e të qiten prej përdorimit ato produkte që nuk kanë plasman në treg.

Nevojat për lokal afarist, kapital dhe punësim varen nga madhësia e produkteve të këtij programi. Nga ky aspekt këtë program mund të kategorizojnë në bazë të punësimit në katër grupe: në grupin e parë mund të punësohen prej 5 deri në 10 punëtorë, në grupin e dytë programi që punëson 10 deri në 20 punëtorë, në grupin e tretë programi që punëson 25 deri 50 punëtorë dhe në grupin e katërt programi që punëson 50 deri në 100 punëtorë.

Qëllimi i programit është që të punësojë sa më shumë punëtorë, me çmim sa më të lirë të vendit të punës, të krijojë sa më shumë fitim në krahasim me mjetet e angazhuara për një punëtorë, t'i ofrojë tregut prodhime të lira në asortimente të ndryshme me qëllim që të plotësohen nevojat e konsumuesve nga lëmi prodhues, shërbyes, individual, gjegjësisht nevojat e qytetarëve për këto produkte etj.

Programi bazohet në resurset materiale-kadrovike ekzistuese tek ne, sidomos për llojet e produkteve të këtij programi disponojmë me lëndë të parë, me fuqi punëtoresh, me treg të sigurt në kuadër të tregut të brendshëm, duke pasur parasysh lidhshmërinë e këtij programi me zhvillimin e bujqësisë, veçmas pemëtarisë, ndërtimitarisë, zhvillimit të tregtisë etj.

Për realizimin e këtij programi nga kategoria e parë ku do të punësohen deri 10 punëtorë, nevojitet përafërsisht në bazë të normave të përcaktuara nga ekspertët e njohur profesional që kanë punuar në identifikimin e programeve të këtij lloji apo të ngjashëm, duhet siguruar 400m² deri 800m² sipërfaqe të nevojshme, kapitali prej 277.000€ deri në 550.000€ ku do të realizohet fitimi prej 160.000€ deri në 320.000€. Kapitali do të shpenzohet për pajisje dhe lokal afarist ndërsa bruto fitimi mund të shërbejë për zgjerimin e riprodhimit të kapaciteteve të këtij programi.

Çmimi i një vendi të punës, gjegjësisht kapitali i deponuar për një punëtor do të jetë përafërsisht 55.000€, kurse fitimi për një punëtor do të jetë mbi 30.000€.

Në programin e kategorisë së dytë ku punësohen 10 deri në 20 punëtorë nevojiten 400m² deri në 800m² lokal afarist, sigurimi i një kapitali në shumë prej 430.000€ deri 860.000€, ku kryesisht do të shpenzohet për sigurimin e makinave dhe veglave të ndryshme për afër 64%, sigurimi i bruto fitimit vjetor në shumë prej 110.000€ deri në 220.000€.

Një vend i punës do të kushtojë 43.000€, kurse fitimi për një punëtor është 11.000€.

3. PROGRAMI I PRODHIMIT TË MOBILIEVE SHTËPIAKE

Këtu është fjala për pjesët e mobilieve të cilat mund të komponohen në kushte të ndryshme hapësinore dhe interiere të cilat nuk mund të gjenden në shitje të lirë. Prodhen në kombinime të ndryshme: druri-druri, druri- pllaka, druri-metali, druri-pëlhura, druri-lëkura etj.

Ky program mund të përfshijë edhe pjesët e mobilieve që punohen sipas sistemit “punoje vetë” me përpunimin e elementeve në punëtori deri te sistemi i montimit, me zgjidhje konstruksionale që mundësojnë unifikimin maksimal të elementeve me kombinimin e tyre të llojllojshëm. Ky repart do të punësonte 50 punëtorë.

Ky program bazohet me prodhimin e orendive të llojeve të ndryshme qoftë sipas porosisë apo në seri, prodhimi i garniturave të mëdha. Prodhimi kryhet kryesisht prej materialit natyror nga llojet e ndryshme të drurit që kanë karakteristika të kualitetit të lartë. Kapacitetet e këtij e programi duhet orientuar afër vendeve urbane ku jetojnë më se 100.000 banorë që kanë standard të lartë në vendet ku janë tendencat e ndërtimit të banesave dhe shtëpive, programi duhet të jetë fleksibil, prodhimet të kryhen në lokale të vogla, varësisht prej numrit të punëtorëve dhe pajisjeve teknike si dhe kërkesave të tregut, puna duhet të jetë profesionale, punëtorët të jenë të kualifikuar dhe me kualifikime të larta, makinat të jenë universale me qëllim që t'i përgjigjen fleksibilitetit të programit. Në prodhimet e këtij programi mund të realizohet edhe ndarja e punës në grup-operacione të ndryshme që mundësojnë shfrytëzimin racional të punës së punëtorit. Makinat te ky program punojnë pa mbeturina të dëmshme, nuk krijojnë erëra, tym, nuk kemi ndonjë përkufizim të kushteve të mikrolokacionit apo makrolokacionit.

Pika e rentabilitetit mund të arrihet me shfrytëzimin e kapaciteteve prej 40-50%.

Gjatë prodhimit të këtyre mobilieve mbesin mbeturina të materialit që mund të shërbejnë për nxehje dhe krijohen produkte të dorës së dytë, në formë të briketit që kanë rëndësi të madhe për nevojat e tregut.

Shumë pjesë të prodhimit të mobilieve mund të kombinohen nga llojet e prodhimeve të tjera të metalta, p.sh. shtretërit si jogi, mund të përdoren në kombinim me plastikë etj.

Ndërtimi i kapaciteteve të këtij programi mund të bazohet në kërkesën e tregut, të punësimit, në kushtet për sigurimin e lëndës së parë etj. Nga aspekt programi karakterizohet në 4 grupe siç janë:

Grupi i parë – programi për prodhimin e mobilieve që punëson 5 deri në 10 punëtorë, grupi i dytë – programi që punëson 11 deri në 22 punëtorë, grupi i tretë – programi për prodhimin e

mobileve që punëson 25 deri 50 punëtorë, grupi i katërt – programi për prodhimin e mobileve që punëson 50 deri në 100 punëtorë.

Programi për prodhimin e mobileve që punëson 5 deri në 10 punëtorë, kërkon lokal afarist në sipërfaqe prej 450m² deri në 900m², kapitali i deponuar prej 600.000€ deri në 1.200.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë prej 230.000€ deri në 460.000€. Raporti nr 1€ investime 0,37€ bruto fitim.

Një vend i punës kushton 120.000€, kurse fitimi për një punëtor është 46.000€.

Programi i kategorisë së dytë të prodhimit të mobileve që punëson 11 deri në 22 punëtorë, kërkon sigurimin e sipërfaqes prej 300m² deri në 600m², kapitali i deponuar prej 430.000€ deri në 860.000€, ndërsa fitimi prej 200.000€ deri në 400.000€, raporti në 1€ investime është 0,45€ bruto fitim. Një vend i punës kushton 39.000€.

4. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E SHPËRPLLAKAVE

Kjo prodhimitari ka mundësi të organizohet në kuadër të fabrikave të shpërplakës si program plotësues.

Shpërplakat përdoren në industrinë e mobileve.

Ky program do të përpunonte 700m³ dhe do të punësonte 15 punëtorë. Kapitali i deponuar duhet të jetë 375.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 320.000€. Raporti në 1€ investime është 0,85€ bruto fitim.

Një vend i punës kushton 25.000€, kurse fitimi për një punëtor është 21.000€.

Problemi ekologjik nuk është i shprehur.

5. PROGRAMI I PRODHIMIT TË KIOSQEVE

Duke pasur parasysh zhvillimin e iniciativës private në tregti ndihet nevoja gjithnjë e më e madhe për shfrytëzimin e kiosqeve të drurit. Nga ky aspekt është me rëndësi të prodhohen kiosqe nga materiali natyror. Prodhimi i kiosqeve duhet t'i përgjigjet normave të proceseve tekniko-teknologjike, të ketë karakter të montazhes, të punohet pjesë pjesë me qëllim që të montohet. Në kioskë instalohet rryma, uji, duhet të ketë kulmin, të vendoset në vendet e caktuara, të ngjyroset etj.

Për realizimin e këtij programi nevojiten 70m² deri në 140m² lokal, kapitali i deponuar duhet të jetë 100.000€ deri në 200.000€, ku kryesisht do të harxhohet për lokal dhe pajisje të ndryshme. Bruto fitimi vjetor mund të jetë prej 60.000€ deri në 120.000€. Raporti në 1€ investime 0,51 bruto fitim.

Programi mund të aktivizohet brenda 6 muajve, kurse kapitali i deponuar të kthehet për dy vjet e gjysmë.

Problemi ekologjik si te programet tjera.

6. PROGRAMI I PRODHIMIT TË VEGLAVE NGA DRURI PËR BUJQËSI

Meqenëse në bujqësi përdoret një numër veglash nga druri është atraktive që të formohen reparte për prodhimin e këtyre veglave, duke pasur parasysh shfrytëzimin e lëndëve të para, fuqinë punëtore, nevojat e tregut etj. në këto vegla bëjnë pjesë bishtat e sëpatave, grabujave, tërfurqve, shatave etj.

Programi i këtyre prodhimeve duhet locuar në ato vise ku është e zhvilluar bujqësia, sepse aty është qendra e konsumit të këtyre produkteve.

Për realizimin e këtij programi nevojitet lokal prej 50m² deri në 100m², punësimi prej 5 deri në 10 punëtorë, kapitali i deponuar prej 60.000€ deri në 120.000€, ku kryesisht do të shpenzohen për ndërtimin e lokalit afarist afër 40%. Bruto fitimi vjetor do të realizohet prej 75.000€ deri në 150.000€ ndërsa raporti në 1€ investime 1,12€ bruto fitim.

Programi aktivizohet për një vit, kurse kapitali mund të kthehet për afër dy vjet.

Çmimi i një vendi të punës është 12.000€, kurse fitimi për një punëtor është 15.000€.

Problemi ekologjik duhet zgjidhur si te programet tjera.

7. PROGRAMI I PRODHIMIT TË DËRRASAVE TË HOLLA E TË GJATA PËR KULM DHE NEVOJA TJERA PËR NDËRTIMIN E SHTËPIVE

Produktet e këtij programi janë në përdorim gjithnjë e më shumë duke pasur parasysh ndërtimin e shtëpive, kulmi i të cilave përbëhet nga pjesët e këtij programi. Prodhimi mund të jetë masovik prej pjesëve të tipizuara të drurit të cilat mund të blihen dhe të montohen në kulm.

Këto pjesë të kulmit përveç prej dërrasave mund të përbëhen edhe prej pjesëve të drurit që kanë mbetur pas prishjes së ndonjë shtëpie apo ndërtese. Materialet e këtij produkti duhet të jenë të madhësive të ndryshme, të kenë dizajn dhe karakteristika të tjera të prodhimit.

Makinat duhet të jenë universale me qëllim që të prodhohen lloje të ndryshme të produkteve që shërbejnë për kulm.

Për realizimin e këtij programi nevojiten prej 160m² deri në 320m², mund të punësohen prej 20 deri në 40 punëtorë, kapitali të sigurohet prej 200.000€ deri në 400.000€. Bruto fitimi vjetor prej 200.000€ deri në 400.000€. Raporti në 1€ investime është 1,16€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 10.000€ kurse fitimi për një punëtor është gjithashtu 10.000€.

Problemi ekologjik i ngjashëm si te programet tjera.

8. PROGRAMI I PRODHIMIT TË SUVENIREVE PREJ DRURI

Ky program është atraktiv. Mungojnë prodhimet e suvenireve në treg. Prodhimi i suvenireve është në seri të vogla për nevoja speciale dhe unike. Programi lokohet në ato vende ku jetojnë më se 50.000 banorë.

Suveniret duhet të përmbajnë elemente artistike, të jenë të dizajnit të lartë dhe të nxisin interesim për konsumatorin. Përmes suvenireve paraqiten karakteristikat regjionale, kombëtare etj.

Në kuadër të repartit për prodhimin e suvenireve mund të jenë edhe shitoret për shitjen e suvenireve të drurit.

Për realizimin e këtij programi nevojitet sipërfaqe prej 100m², të punësohen 10 punëtorë, deponimet e kapitalit prej 170.000€ që kryesisht do të shpenzohen për lokal afarist, bruto fitimi vjetor është 167.000 €, raporti në 1€ investime 0,94€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 17.000 €, kurse fitimi për një punëtor 16.700 €.

Programi aktivizohet për 3 muaj, kurse kapitali i deponuar kthehet për një vit.

9. PROGRAMI I PRODHIMIT TË REKUIZITAVE TË NDRYSHME NGA DRURI PËR NEVOJA TË SHTËPISË

Në kuadër të këtij programi prodhohen enë të drurit, dërrasa, pajisje të drurit, brumë, artikuj dekorativ etj.

Programi duhet të lokohet afër vendeve konsumuese me kusht që të mos ketë konkurrencë, të ketë kushte për ndërtimin e lokalit.

Dizajni, asortimenti duhet të jenë në përputhje me nevojat e tregut dhe qytetarëve.

Për realizimin e këtij programi nevojiten 200m², të punësohen 20 punëtorë, kapitali i deponuar duhet të jetë 360.000€, bruto fitimi vjetor 370.000€, raporti në 1€ investime është 0,94 bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 18.500€, kurse fitimi për një punëtor është 18.500€.

Programi aktivizohet për një vit, kurse kapitali i deponuar kthehet për 2 vjet.

II. PROGRAMET PËR KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESEVE NË INDUSTRIJËN E LËKURË-KËPUCËVE

DISA KARAKTERISTIKA DHE RËNDËSIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIJËS SË LËKURË-KËPUCËVE

Zhvillimi i industrisë së lëkurë-këpucëve paraqet një veprimtari të rëndësishme të biznesit tonë kosovar. Ekziston një traditë e zhvillimit të zejes së kësaj veprimtarie në trevat e ndryshme të Kosovës. Zhvillimi i kësaj dege industriale është bazuar kryesisht në përpunimin e lëkurës për prodhimin e këpucëve të llojeve të ndryshme sipas gjinisë, për meshkuj, për femra, në asortimente të ndryshme sipas moshave.

Duke pasur parasysh nivelin e zhvillimit të blegtorisë të ne, potencialin kadrovik, ekzistojnë mundësitë që zhvillimi i kësaj veprimtarie në të ardhmen të orientohet kryesisht në sektorin privat të organizuar në punëtori të pavarur, në ndërmarrje private, në shoqëri aksionare, në shoqëri me përgjegjësi të pakufizuar, në kooperativa, në ndërmarrje të përziera dhe në forma tjera. Si bazë e zhvillimit të kësaj veprimtarie në të ardhmen mund të shërbejnë një numër i programeve të identifikuar nga kjo veprimtari. Në programet që prezantohen në këtë punim jepen disa informata karakteristike lidhur me përmbajtjen e programit, mundësitë teknologjike, problemet e tregut nga aspekti i sigurimit të lëndës së parë, teknologjisë dhe fuqisë punëtore, nevojat për lokal afarist, shuma e kapitalit që duhet siguruar me rastin e realizimit të çfarëdo programi të propozuar, realizimi i bruto fitimit vjetor, afatet e aktivizimit të programit dhe koha e kthimit të kapitalit, iniciohen edhe problemet ekologjike, jepen çmimet e kushtimit të një vendi të punës, realizimi i fitimit për një punëtor.

Programet e propozuara konkrete janë bazuar në idetë e shumë anëtarëve profesional shkencorë të vendeve të ndryshme të cilët në hulumtimet e veta kanë arritur t'i definojnë titujt e programeve, t'i përcaktojnë standardet gjegjësisht normat teknike-ekonomike dhe shumë elemente të tjera që mund të shërbejnë për hartimin e biznes planit për çdo program të propozuar. Në bazë të këtyre elementeve shumë programe të propozuara të anëtarëve të ndryshëm janë studiuar dhe analizuar në Qendrën e Biznesit të Vogël "Eureka" dhe idetë e ndryshme dhe rezultatet shkencore të tyre janë komponuar në programe konkrete që mund të gjejnë aplikim në zhvillimin e industrisë përpunuese të lëkurës tek ne.

Duke pasur parasysh lëndën e parë kryesisht lëkurën e cila mund të gjejë përdorim të gjerë në prodhimin e produkteve, gjysëmprodukteve ose në formë të lëndës së parë për përpunimin e mëtejshëm janë propozuar programe konkrete nga lëmi i prodhimit të lëkurës, të galanterisë së lëkurës,

programi për prodhimin e gëzofit, programi për prodhimin e pjesëve të ndryshme që përmban produkti i këpucëve, programi për prodhimin e mbulesave dhe dorëzave mbrojtëse, programet e prodhimit të lëkurës për nevoja teknike, programet për përpunimin e mbeturinave të lëkurës etj.

Lëkura si material dhe si lëndë e parë ka vlerë të lartë me veti të veçanta të materialit natyror fisnik etj. Sasia e lëkurës varet nga numri i shtazëve, bagëtisë gjegjësisht prej shtazëve të therura (të prera).

Zhvillimi i shkencës, teknologjisë, ngritja profesionale e kuadrove ndikojnë në zhvillimin e shpejt të kësaj dege, kështu që vetë prodhimi i lëkurë-këpucëve ngrihet në nivel shkencor, p.sh. në dizajnimin e këpucëve aplikohen metodat e ndryshme shkencore, krijohen kuadro profesionale, inkuadrohen kuadro interdisciplinare dhe konsultantë të ndryshëm nga medicina, kimia etj. Te ne ekzistojnë mundësitë për themelimin e kësaj veprimtarie duke pasur parasysh zhvillimin e ndërmarrësisë dhe iniciativës private, kështu që përdorimi i lëkurës përveç prodhimit të këpucëve gjithnjë e më shumë po shpenzohet për mobilie, veshje etj. Moda ka rëndësi të madhe në prodhimin e këtyre produkteve të kësaj veprimtarie me qëllim që të nxitet konsumuesi në treg për blerjen sa më të madhe të këtyre produkteve në treg.

Duhet kushtuar kujdes organizimit të prodhimtarisë, projektimit, konstruktimit të modeleve të ndryshme etj. nga ky aspekt duhet shfrytëzuar sistemin informativ teknologjik, literaturën profesionale shkencore, pjesëmarrjen në panairë të ndryshme shkencore etj.

Duhet shfrytëzuar çdo proces teknologjik kimik, çdo lloj të lëkurës, mbeturinat e saj, që të mund të hartohen programe konkrete të punësimit, duhet të studiohen burimet e financimit, të zhvillohet prodhimtaria që është e lidhur me këto produkte si pastrimi, larja etj. Duhet përcjellur zhvillimin e makinave, veglave për realizimin e këtyre produkteve. Këto programe mund të locohen në të gjitha meset e veçanërisht në ato mese ku kemi numër të madh të të papunëve. Mirëpo rekomandohet që ndërtimi i fabrikave nga këto programe të jenë afër reparteve të thertoreve, ku janë të zgjedhur problemet e infrastrukturës si sigurimi i rrymës, ujit, ku mund të zgjidhet problemi ekologjik, shfrytëzimi i kemikaleve, zvogëlimi i mbeturinave, harxhimi sa më i vogël i energjisë etj.

LLOJET DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË INDUSTRIJË SË LËKUR-KËPUCËVE

1. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E GALANTERISË SË LËKURËS

Prodhimet e këtij programi mund të jenë të ndryshme siç janë: prodhimi i çantave, çantave për rrugë, rripa, dorëza, galanteria e imtë, prodhimi i mbajtëseve për pushkë, futrolla për nevoja të ushtrisë, gjuetisë, peshkatarisë etj., prodhimi i lëkurës teknike dhe i lëkurës për destinime të ngjashme.

Karakteristikë e përbashkët e këtyre prodhimeve është se lënda e parë është me origjinë natyrore ose artificiale, prej lëkurës artificiale, tekstilit, kashtës, bazohet në prodhimin tradicional regjional. Përpunimet e prodhimeve nuk janë të rënda, kryhen në lokale të përshtatshme, cikli i prodhimit nuk është i gjatë, lehtë mund të ndryshohet struktura e prodhimeve prej një lëkure në një lëkurë tjetër, punët kryhen me dorë por janë edhe të automatizuara, kërkojnë dizajn të mirë me modele bashkëkohore, duhet pasur kujdes me rastin e qepjes në karakteristikat dhe strukturën e lëkurës. **Kryesisht në realizimin e këtij programi marrin pjesë zejtarët nga veprimtaria e**

lëkurës, çdo prodhim i këtij programi mund të angazhohet si program i veçantë varësisht nga nevojat e tregut në varshmëri nga lokacioni, struktura kualifikuese, struktura e pajisjes teknike etj. Për realizimin e këtij programi nevojiten 205m² gjegjësisht 320m², varësisht nga madhësia e programit dhe struktura e produkteve në kuadër të këtij programi. Deponimi i kapitalit është 380.000€ deri 870.000€. Bruto fitimi vjetor është 350.000 deri në 700.000€. në kuadër të këtij programi do të punësohen 11 gjegjësisht 22 punëtorë. Çmimi për një vend pune është 40.000€ ndërsa fitimi për një punëtor është afër 35.000€. raporti në 1€ investime është 1,3€ te prodhimi i galanterisë së lëkurës ndërsa te galanteria e lëkurës për armë të zjarrit 1,10€ ndërsa raporti më i vogël realizohet te prodhimi i galanterisë së lëkurës.

Me rastin e ndërtimit të kapaciteteve të këtij programi duhet zgjedhur disa probleme ekologjike. Realizimi i këtyre programeve mund të organizohet edhe në formimin e punëtorive të pavarura zejtare por gjithmonë duhet pasur parasysh ngjyrën, kualitetin, modën, por prodhimi përfundimtar duhet të jetë natyror dhe i materialit me kualitet të lartë. Shpeshherë prodhimet e galanterisë së lëkurës duhet harmonizuar në pjesët tjera të veshjes.

2. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E MBULESAVE MBROJTËSE DHE DORËZAVE MBROJTËSE NGA LËKURA

Prodhimet e këtij programi janë të kërkuara në treg e sidomos prodhimi i mbulesave mbrojtëse është i kërkuar për banorët e ndërtesave të larta, te shoferët dhe punëtorët që punojnë në temperatura të larta, ndërsa dorëzat mbrojtëse kanë karakter mbrojtës së mjeteve higjienoteknike, i mbrojnë duart prej veprimeve mekanike dhe kimike. Këto dorëza përherë janë të kërkuara sidomos në industri dhe veprimtari tjera ekonomike ku me dispozita ligjore parashihet si obligim që ti mbajnë punëtorët gjatë punës. Çdo njëri prej këtyre prodhimeve mund të zhvillohet si program i veçantë ose të formohet një punëtor i përbashkët për prodhimin e këtyre produkteve. Duhet pasur kujdes përdorimin e lëkurës së destinuar për këto nevoja, të përpunuara me procedurë teknologjike të veçantë me elemente të mjeteve mbrojtëse kundër zjarrit ose prodhimi klasik i dorëzave mbrojtëse, ku zhvillohet një strukturë dhe një numër operacionesh teknologjike për prodhimin e tyre. Prodhimi i këtyre produkteve mund të angazhohet edhe si zeje shtëpiake.

Nevojiten 110m² deri në 220m², do të punësohen 9 deri 18 punëtorë varësisht nga madhësia e programit dhe llojit të produkteve të këtij programi. Kapitali i deponuar do të jetë prej 200.000€ deri në 400.000€, bruto fitim prej 189.000€ deri në 380.000€. programi mund të aktivizohet për gjysmë viti kurse kapitali të kthehet brenda një viti, ndërsa raporti në 1€ investime afër 0,90€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 22.000€ për një punëtor, kurse fitimi për një punëtor është 21.000€ bruto fitim.

3. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E TABANËVE BAZË DHE I TABANËVE NGA LËKURA

Tabanët bazë janë pjesa e poshtme e këpucëve. Prodhet në seri të mëdha me aplikim të teknologjisë bashkëkohore, ndërsa tabanët nga lëkura janë me vlerë dhe modë të lartë. Kjo lëkurë përdoret prej lëkurës së lopëve por më rrallë prej lëkurës së kuajve apo të ndonjë lëkure tjetër. Kombinohet edhe me materie minerale bimore dhe sintetike. Këto produkte janë shumë të

kërkuara në treg prandaj nga ky aspekt duhet kushtuar kujdes kualitetit, çmimeve e sidomos modelit të tabanëve, sepse tabanët nga lëkura natyrore më së shpeshti përdoren në këpucët e modës së lartë.

Për prodhimin e tabanëve nevojitet sipërfaqja prej 120m² deri 240m², ndërsa për prodhimin e tabanëve nga lëkura 1250m² deri 2500m². Në këtë program në kuadër të këtyre prodhimeve mund të punësohen për prodhimin e llojit të parë prej 8-16 punëtorë, ndërsa te prodhimi i dytë prej 50-100 punëtorë. Në prodhimin e tabanëve bazë do të angazhohej kapitali prej 260.000€ deri 520.000€,

4. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E DORËZAVE TË LËKURËS

Ky prodhim mund të realizohet në kuadër të nevojave shtëpiake në seri të vogla me një specializim të dukshëm. Dorëzat duhet të prodhohen prej lëkurës së kualitetit të lartë dhe prodhimi duhet të jetë në harmoni me zhvillimin e modës, lëkura të jetë natyrore, e qepur mirë, dizajn të mirë, me çmime të volitshme, por edhe të organizohen format e shitjes dhe blerjes së lëndës së parë për prodhimin e dorëzave.

Për prodhimin e këtij produkti nevojiten sipërfaqe prej 40-80m², ku do të punësoheshin 3-6 punëtorë. Kapitali prej 70.000 – 140.000€. bruto fitimi vjetor është prej 123.000 – 146.000€ varësisht prej madhësisë së këtij programi. Projekti mund të aktivizohet brenda 6 muajve ndërsa kapitali të kthehet për 1 vit në raport 1€ investime 1,70€ bruto fitim.

Problemi ekologjik nuk është aq i shprehur, çmimi i një vendi të punës është 23.000€ kurse fitimi për një punëtor rreth 41.000€.

5. PROGRAMI I PRODHIMIT TË TOPAVE TË LËKURËS

Ky program është atraktiv për tregun tonë duke pasur parasysh kërkesat e zhvillimit të sportit si në futboll, basketboll, volejball, vaterpolo etj. Duhet që lëkura për prodhimin e topave të jetë nga llojet e ndryshme të kafshëve duke pasur kujdes që kjo lëkurë të jetë me çmim sa më të lirë.

Për formimin e një punëtorie të prodhimit të topave të lëkurës duhet të sigurohen 50-100m², mund të punësohen 3 apo 6 punëtorë me sigurimin e një kapitali prej 90.000 deri 180.000€ ku bruto fitimi vjetor do të kishte me qenë i barabartë me kapitalin e deponuar.

Kapitali kthehet për 1 vit e gjysmë kurse programi të aktivizohet për 6 muaj. Kapitali i angazhuar për një punëtor është 30.000€ për një vit.

6. PROGRAMI PËR PRODHIMET NGA LËKURA PËR NEVOJAT E INVALIDËVE

Prodhimi i ndihmësve për kufizimin e lëvizjes së dorës te fëmijët e vegjël, prodhimi i këpucëve ortopedike, prodhimi i përforcuesve për nyje të këmbës dhe mbrojtëseve për kokë. Këto prodhime karakterizohen me lloje të ndryshme të trupit si për këmbë, duar. Këto produkte shërbejnë si pjesë të prodhimeve të kryera të cilat bashkëngjiten në hekur ose drunj, duken më estetike, shërbejnë si mbrojtëse për vendet e lënduara, janë të qëndrueshme. Në kuadër të këtyre produkteve rëndësi të veçantë i kushtohet këpucëve ortopedike që kryesisht punohen me dorë sipas porosisë. Jepen sipas udhëzimit të mjekut. Prodhohen prej lëkurës së llojeve të ndryshme të kafshëve. Duhet pasur kujdes çmimin e lëkurës që përdoret për prodhimin e këtyre mjeteve ndihmëse.

Programi mund të realizohet në kuadër të një raporti me numër më të madh punëtorësh me makina të specializuara dhe universale, me aplikim të procesit teknologjik në varshmëri prej llojit të prodhimit, makinave dhe veglave të punës.

Për realizimin e programit të këtyre prodhimeve në një repart nevojiten të sigurohen sipërfaqe prej 135-270m², të punësohen 10 deri 20 punëtorë varësisht prej numrit të produkteve të këtij programi për këto destinime. Kapitali i deponuar duhet të jetë prej 215.000 – 430.000€. Bruto fitimi vjetor do të jetë 295.000 – 590.000 €. Kapitali i angazhuar për një punëtor është 21.500€, kurs e fitimi për një punëtor 29.500€. Aktivizimi i programit bëhet brenda gjysmë viti kurse kthimi i kapitalit për 1 vit e gjysmë. Raporti në 1€ investime është 1 deri 1,73€ bruto fitim.

Vendi më i lirë i punës realizohet te prodhimi i këpucëve ortopedike përafërsisht 16.000€, ndërsa fitimi më i madh për një vend të punës te prodhimi i ndihmëseve për kufizimin e lëvizjes për fëmijë 40.000€ ndërsa çmimi për një vend pune 23.000€.

7. PROGRAMI I PRODHIMIT TË MBULESAVE TË LËKURËS PËR AUTOMOBIL

Prodhimi i këtij programi është atraktiv për treg duke pasur parasysh numrin e madh të automobilave individual dhe të firmave. Mund të shitet në tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Mund të prodhohen në bazë të lëkurës së mbetur, nevojitet më shumë punë dore dhe më pak makina. Lëkura duhet të jetë e butë.

Ky program mund të zhvillohet në sipërfaqe prej 45-90m², të punësohen prej 4-8 punëtorë, kapitali të jetë prej 80.000 deri 160.000€. bruto fitimi vjetor do të ishte 100.000€ deri 200.000€. Raporti në 1€ investime 1,20€ bruto fitim. Kapitali i deponuar për një punëtor 20.000€ ndërsa fitimi 25.000€.

8. PROGRAMI I PRODHIMIT NGA LËKURA NË KUADËR TË ARTIZANATEVE SHTËPIAKE

Në kuadër të këtij programi bëjnë pjesë këto produkte: të regjurit me dorë të lëkurës së egërsirave dhe kafshëve shtëpiake, prodhimet nga lëkura e vendit (kallpak, kapuçë, guna, mbulesa etj.), punimi i sendeve të imëta nga hedhurinat e lëkurës (suvenire, galanteri) ose në kombinim me materiale tjera (tekstil, dru), punimi i këpucëve tradicionale kombëtare nga lëkura. Produktet e këtij programi janë atraktive për tregun tonë dhe të jashtëm, janë të lirë, kryesisht punohen me dorë dhe në shtëpi, prezantohen vetitë dhe karakteristikat gjeografike, historike, përvojat tradicionale etj. Duhet pasur kujdes që produktet të prodhohen nga dizajni bashkëkohor, të kenë çmim të lirë dhe të jenë atraktive për konsumues.

Për realizimin e këtij programi nevojiten 300m², punësohen 30 punëtorë, kapitali i deponuar 60.000€, bruto fitimi vjetor 180.000€. Raporti në 1€ investime është 3€ bruto fitim. Programi mund të aktivizohet për 3 muaj, kurse kapitali kthehet për 4 muaj. Çmimi për një vend pune është 32.000€, kurse fitimi për një punëtor 6.000€.

Duhet kushtuar kujdes faktorit ekologjik sikurse te programet tjera.

III. PROGRAMET PËR KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESEVE NË INDUSTRIJË DHE TEKSTILIN

DISA KARAKTERISTIKA DHE RËNDËSIA E PROGRAMEVE TË INDUSTRIJË DHE TEKSTILIN

Duke analizuar zhvillimin e industrisë së tekstilit të ne, pozitën e saj në ekonomi, rëndësinë e saj për shtimin e punësimit si dhe nevojat dhe kërkesat e tregut për produkte të industrisë së tekstilit si dhe duke pasur parasysh sigurimin e lëndës së parë nga prodhuesit bujqësorë, kryesisht blegtorët është e mundur të identifikohen disa programe atraktive për punësimin e popullatës në këto veprimtari të rëndësishme industriale.

Programet mund të identifikohen në formë të formimit të salloneve, me butiqe, për prodhimet e tekstilit të meshkujve, femrave, fëmijëve etj. Prodhimet të jenë në formë të rrobave për meshkuj dhe femra, këmbësori, xhemperëve, dorëzave, konfeksionit të lehtë, ndërresat, veshjet e sipërme, prodhimi i veshjeve sportive, rrobat për mbrojtje në punë, çorapet, prodhimi i kukullave, suvenireve, prodhimi i trenerkave, dorëzat unike, veshjet unike.

Programet e prodhimit të industrisë së tekstilit bazohen në lëndën e parë prej leshit, pambukut, konopit, fijeve sintetike, mëndafshit.

Produktet punohen në mënyrë industriale, me dorë, me prerje-qepje dhe shumë aktivitete të tjera që mund të identifikohen në formë të programeve. Programet mund të jenë prodhues, tregtarë siç është punësuesi gjegjësisht ndërmarrja me shitore, me sallone, me butik.

Në këtë punim po i prezantojmë disa programe karakteristike që përmbajnë elemente të identifikuar dhe të vërtetuara nga aspekti teknologjik, tregu dhe parametrat ekonomike ku kanë marrë pjesë shumë ekspertë dhe shkencëtarë të institucioneve shkencore profesionale, idetë e të cilëve janë publikuar në punime shkencore, në programe dhe projekte konkrete për nevojat e zhvillimit të mëtutjeshëm të tekstilit në përmasa më të gjera.

Si programe më atraktive ideore që do të shërbenin për formimin e firmave të vogla prodhuese të industrisë së tekstilit që do të mund të bazohen në njohuritë dhe informatat e rezultateve shkencore të deritashme duhet veçuar këto programe.

LLOJET DHE PROGRAMET E ZHVILLIMIT TË INDUSTRIJË DHE TEKSTILIN

1. PROGRAMI I SALLONIT TË RROBAQEPËSVE NË BUTIK

Në kuadër të këtij programi mund të zhvillohen shumë aktivitete siç janë: matja, prerja dhe qepja e veshmbathjeve për meshkuj, femra dhe fëmijë.

Ky program mund të zhvillohet në të gjitha ato vendbanime ku jetojnë më shumë se 50.000 banorë. Programi përfshin llojet e ndryshme të veshmbathjeve në përputhje me dizajnin e lartë, kualitetin dhe mallrat e ndryshme, varësisht nga kërkesa dhe shitja e porositesit. Meqenëse kërkesat, dëshira, moda ndryshojnë nga aspekti gjinor në kuadër të programit mund të sigurohen produkte të specializuara për femra, meshkuj dhe fëmijë. Realizimi i konceptit të këtij programi është i mundur në formimin e reparteve të veçanta të prodhimit për nevoja të femrave, meshkujve dhe fëmijëve. Në çdo njëri prej tyre mund të punësohen nga 5 deri 10 punëtorë, të angazhohet kapitali nga 23.000€ gjegjësisht 46.000€ që shpenzohet kryesisht për pajisje teknike dhe në rregullimin e lokalit afarist. Programi mund të aktivizohet prej 2 deri në 5 muaj ndërsa kthimi i kapitalit të jetë brenda vitit. Bruto fitimi vjetor mund të jetë te çdo njëri program prej 43.000 gjegjësisht 86.000€, varësisht nga kreativiteti i programit dhe destinimi i prodhimit se a është për meshkuj apo për femra ose për fëmijë.

Programi për femra është më rentabil, me angazhim të të njëjtit kapital si në programin për meshkuj. Realizohet bruto fitimi vjetor prej 56.000€ në 112.000€ ose te programi për fëmijë prej 70.000€ në 140.000€. Te tri këto prodhime në kuadër të këtij programi raporti në 1€ investime realizohet përafërsisht 1,80€ deri 2,35€.

Problemet ekologjike nuk janë të shprehura.

Programi është i realizueshëm dhe veçmas është atraktiv për kushtet tona ku kemi shtimin e popullsisë me dinamikë të shpejtë ku pjesëmarrja e moshës fëmijërore në popullatë është dukshëm e theksuar. Ekziston mundësia të sigurohen kuadrot profesionale, dizajnerët, përndryshe ekziston tradita e kësaj veprimtarie në shumë qytete tona.

Në kuadër të prodhimeve të këtij programi punësohen 15 deri në 30 punëtorë në një sipërfaqe prej 120 deri 180m², me kapital prej 76.000€ deri 152.000€, ndërsa bruto fitimi vjetor 222.000€ deri 338.000€.

Realizimi i këtij programi në këtë vëllim kërkon hapjen e butiqeve ku do të shiteshin të gjitha llojet e prodhimeve të këtij programi por mund të shiten edhe prodhime të prodhuesve të tjerë. Kjo mundëson plasmanin efikas të realizimit të këtyre produkteve si dhe arritja e njohurive dhe përvojave nga kërkesat e konsumuesve për modë dhe dizajn, cilësinë e produktit dhe tjera.

2. PROGRAMI I PRODHIMIT TË KUKULLAVE

Ky program bazohet në prodhimin e kukullave që do të shërbejnë si lodra për fëmijë. Materiali për prodhimin e kukullave përdoret prej mbeturinave të pëlhurës, nga konfeksioni, ndërsa kukullat shërbejnë si suvenir që kryesisht prodhohen prej pëlhurës origjinale që përmbajnë motive karakteristike tradicionale të mesit ku prodhohen. Në prodhimin e këtyre kukullave aplikohet procesi adekuat teknologjik siç është prerja, qepja që bëhet kryesisht në zejet shtëpiake.

Këto produkte duhet të jenë atraktive dhe të përshtatshme që fëmijët të mund t'i veshin lehtë, të kenë ngjyrën adekuate tërheqëse, të jenë të lira. Prodhimi i kukullave në kushtet tona është atraktiv duke pasur parasysh numrin e madhtë fëmijëve.

Në kuadër të këtij programi mund të punësohen 32 punëtorë, varësisht nga lloji i prodhimit të këtij programi. Programi i prodhimit unikat të kukullave është më i lirë për arsye se bazohet kryesisht nga mbeturinat e pëlhurës nga konfeksioni e nga ky aspekt ka edhe akumulim më të madh.

Për realizimin e tërë programit nevojitet sigurim i kapitalit prej 90.000€ që do të shpenzohej kryesisht për lokal afarist afër 50%. Bruto fitimi vjetor mund të jetë afër

340.000€, ndërsa lokali afarist duhet siguruar në sipërfaqe prej 60m² dhe atë nga 30m² për çdo njërin prodhim. Afati i aktivizimit të programit është mjaft i shkurtër prej 1 deri 2 muaj, ndërsa kapitali kthehet brenda gjysmë viti, kurse raporti në 1€ investime do të jetë 3,20 deri 4,4€ bruto fitim varësisht nga prodhimi.

Problemi ekologjik nuk është prezent.

3. PROGRAMI I PRODHIMIT TË KËMISHAVE DHE TRENERKAVE

Prodhimet e këtij programi janë shumë atraktive duke pasur parasysh se mund të vishen në kohën e lirë sidomos trenerkat që prodhohen nga materialet që nuk ndrydhen, të prodhohen nga pambuku ose të materialit të ngjashëm, ndërsa këmishat prodhohen nga viskoza, nga pëlhurat e shtypura me dezenë të ndryshme.

Programi i tillë mund të punësojë 20 punëtorë në një sipërfaqe prej 200m², me kapital prej 240.000€ që do të shpenzohej 63% për pajisje dhe ku do të realizohej bruto fitimi vjetor prej 342.000€. raporti në 1€ investime është 1,44€ bruto fitim.

Programi aktivizohet për një vit, kurse kapitali kthehet për një vit e gjysmë.

Këmishat dhe trenerkat mund të jenë të dizajnit dhe të numrit të ndryshëm, të destinuara për femra, meshkuj dhe fëmijë. Ky program është atraktiv për treg dhe mund të aplikohet në kushtet tona dhe paraqet rëndësi të madhe për shtimin e punësimit. Rëndësi të veçantë në shtimin e punësimit dhe zhvillimit të tekstilit kanë edhe këto programe: programi i prodhimit të rrobave për meshkuj dhe femra, prodhimi i shtofeve të lehta të prodhuara me makina të automatizuara.

4. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E VESHJEVE UNIKATE

Ky program është atraktiv për femra që dëshirojnë që në çdo kohë të kenë diçka për veshje e të mos harxhojnë shumë para. Kryesisht qepjet bëhen në punëtori ose në shtëpi. Duhet pasur kujdes kualitetin e lëndës që e blen dhe t'i kushtohet kujdes dizajnit të lëndës së parë. Duhet organizuar endetore vetanake të dorës.

Ky program mund të realizohet përafërsisht me 20 apo 40m² sipërfaqe që mund t'i punësojë 10 apo 20 punëtorë, me kapital prej 78.000€ deri 156.000€, që do të shpenzohej kryesisht për pajisje dhe lokal. Bruto fitimi vjetor do të realizohej në shumë prej 150.000€ deri në 300.000€, varësisht nga madhësia e programit se a do të punësohen 10 apo 20 punëtorë. Raporti në 1€ investime është 2,18€ bruto fitim.

Problemi ekologjik nuk është i shprehur.

Një vend i punës te ky program do të kushtoj 7.800€, ndërsa bruto fitimi vjetor do të jetë afër 15.000€ për një punëtor.

Nga ky aspekt ky program është real për kushtet tona e veçmas kur disponojmë me një numër të madh të punëtorëve të kualifikuar dhe të pakualifikuar dhe me një numër të madh familjesh ku disa pjesë të këtij programi mund të realizohen në shtëpi.

5. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E KRAVATAVE, KAPELAVE DHE SHESHIRËVE

Ky program mund të zhvillohet si zeje shtëpiake në kooperim me prodhuesit e tekstilit. *Mund të prodhohen kravata, kapela dhe sheshirë të llojeve të ndryshme dhe për raste të ndryshme.* Programi mund të lokohet në ato vende urbane ku jetojnë më se 50.000 banorë. Shitorja vetanake duhet vendosur afër qendrës tregtare ku ka frekuencë më të madhe të blerësve dhe ku ekziston

konkurrencë tjetër. Këto produkte duhet të kenë dizajn dhe kualitet të mirë. Prodhimi i kapelave dhe sheshirëve duhet të orientohet për ato vende ku ekziston tradita për to.

Për realizimin e këtij programi nevojitet një sipërfaqe prej 120m² deri 200m² varësisht prej llojit të produkteve dhe madhësisë. Mund të punësohen prej 14 punëtorë deri 28 punëtorë. Kapitali i deponuar duhet të jetë në shumë prej 79.000 deri 158.000€, kurse bruto fitimi vjetor do të jetë 180.000€ deri 360.000€. Afati i aktivizimit të programit është 2 deri 6 muaj kurse kthimi i kapitalit prej 7 deri 12 muaj. Çmimi i vendit të punës është 5.600€, kurse fitimi për një punëtor 12.000€. Raporti në 1€ investim është prej 2 deri 3€ bruto fitim varësisht prej prodhimit. Te prodhimi i kravatave ky raport është 3,19€ bruto fitim.

Problemi ekologjik nuk është i shprehur.

6. PROGRAMI I PRODHIMIT TË TAPICËRISË PËR AUTOMOBILA

Ky program mundëson prodhimin serik të tapicerisë së automobilave në formë të serisë së vogël dhe unikat prej materialit të ndryshëm për të gjitha llojet e automobilave. Mund të shiten në shitoret vetanake, të montohet dhe të ndreqet tapiceria sipas nevojës dhe dëshirës së konsumuesve. Prodhimi i këtij programi mund të organizohet në një punëtori në ato vise ku ekzistojnë më se 5.000 automobila pa ndonjë konkurrencë direkte. Duhet të ketë dizajnin, asortimentin dhe kualitetin e mirë me çmime të volitshme.

Sipërfaqja afariste për këtë program duhet të sigurohet prej 40 deri 80m², lokal afarist për prodhim dhe prej 20 deri 40m² lokal afarist për shtypje. Punësohen 6 deri 12 punëtorë kurse kapitali i angazhuar duhet të jetë 22.000 deri 44.000€, ki kishte për t'u përdorur për pajisje afër 64%. Bruto fitimi vjetor do të jetë 50.000€ deri 112.000€. raporti në 1€ investim është 2,4€ bruto fitim.

Afati i aktivizimit të këtij programi është 3 muaj, kurse i kthimit të kapitalit është 8 muaj. Çmimi i vendit të punës është afër 3.700€, kurse fitimi për një punëtor është 9.300€.

Problemi ekologjik duhet zgjidhur ngjashëm sikurse te programet tjera.

7. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E NDËRRESAVE PËR FEMRA

Në kuadër të këtij programi prodhohen ndërresat e femrave në seri të vogla dhe unikate prej materialit të ndryshëm dhe kualitetativ. Prodhimet e këtij programi plasohen përmes butikut apo shitores vetanake. Mund të prodhohet edhe për eksport. Prodhimi duhet të ketë karakterin e industrisë së vogël që do të loqej në vendet me më shumë se 100.000 banorë, normalisht ku ekziston një standard dhe kulturë e popullatës.

Duhet pasur kujdes edhe dizajnin dhe asortimentin kualitetativ të prodhimeve të këtij programi.

Sipërfaqja e lokalit afarist është 80m² deri në 160m², të punësohen 9 deri 18 punëtorë, kapitali i nevojshëm është prej 64.000€ deri në 128.000€, bruto fitimi vjetor prej 100.000€ deri në 200.000€, ndërsa raporti në 1€ investime 1,4€ bruto fitim.

Aktivizimi i programit prej 4 deri 6 muaj, kurse kapitali kthehet për një vit.

Nuk ka ndonjë problem ekologjik. Çmimi i një vendi të punës është 7.100€ kurse fitimi për një punëtor 11.000€.

8. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E JASTEKËVE PËR SUPE TË KRAHUT

Prodhimet e këtij programi paraqesin pjesë të veshjes, janë shumë të thjeshta, kanë forma dhe madhësi të ndryshme varësisht nga destinimi si për bluza apo për kostume, për pallto ose jakne.

Duhet organizuar mirë shitjen e këtyre produkteve në bashkëpunim me rrjetin tregtarë për nevojat e blerësve të mëdhenj. Dizajni, asortimenti si dhe kualiteti i çmimeve të këtyre produkteve kanë ndikim të madh në kërkesën për këto prodhime.

Për realizimin e këtij prodhimi nevojitet lokal 250m², mund të punësohen 20 punëtorë. Kapitali i nevojshëm për deponim është 300.000€. Bruto fitimi vjetor do të jetë 440.000€. Raporti në 1€ investime 0,9€ bruto fitim.

Problemi ekologjik nuk është prezent.

Kapitali kthehet për 3 vjet, kurse programi mund të aktivizohet për një vjet. Çmimi i një vendi të punës është 15.000€, kurse fitimi për një punëtor 22.000€.

9. PROGRAMI I TË METAVE TË STOFIT

Në praktikë shpesh herë ngjanë që gjatë endjes së stofit që në disa ekzemplarë të mbesin gabime (të meta) për arsye të ndryshme si p.sh. ndodhë që nuk kanë trashësinë e njëjtë etj. Gabimet mund të përmirësohen përmes pastrimit dhe aktiviteteve të tjera. Duhet të kemi mjete teknike për përmirësimin e këtyre gabimeve si brusha, gjilpëra, gërshërë. Gabimet përmirësohen me dorë që ndikon në rritjen e punësimit etj.

Nevojitet sigurimi i 30m² lokal afarist, të punësohen 2 punëtorë, të angazhohet kapitali në shumë prej 10.000€. Bruto fitimi vjetor do të jetë 11.000€. Raporti në 1€ investime është 1,10€ bruto fitim. Çmimi i një vendi të punës është 5.000€, kurse fitimi për një punëtorë 5.500€.

10. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E TEKSTILIT PËR NEVOJAT E HOTELIERISË DHE TURIZMIT

Në kuadër të këtij programi bëjnë pjesë prodhimi i çarçafëve për shtretër, mbulesat e tavolinave, pantallonat për kamarier, perde dhe rrobe të punës për nevoja të turizmit.

Në tregun tonë ndihet nevojë e madhe për këto prodhime. Duhet kushtuar kujdes dizajnit, asortimentit, çmimit të shitjes. Për prodhimin e këtyre prodhimeve përdoren materiale të ndryshme që mund të sigurohen nga tregu i brendshëm dhe i jashtëm. Prodhimtaria është e thjeshtë sepse puna mund të kryhet me dorë por edhe me makinë. Për çdo lloj prodhimi të këtij programi mund të formohen njësi të vogla prodhuese.

Për realizimin e këtij programi nevojiten 300m², punësohen 30 punëtorë, nevojitet sigurimi i kapitalit prej 120.000€. Bruto fitimi vjetor do të jetë 180.000€. Raporti në 1€ investime është 1,20€ bruto fitim.

Programi mund të aktivizohet për 6 muaj, ndërsa kapitali të kthehet brenda një viti. Çmimi i vendit të punës është 4.000€, kurse fitimi për një punëtor 6.000€.

11. PROGRAMI I PRODHIMIT TË ÇANTAVE SPORTIVE

Në kuadër të këtij programi mund të prodhohen çantat për udhëtime me destinime të ndryshme, çantat për skiatorë, për gjueti, për tenis, motoçiklizëm dhe biciklizëm etj. Për prodhimin e këtyre produkteve mund të përdoren lëndët e para prej leshit, sintetikes, pambukut, konopit. Mund të kombinohen me prodhime të lëkurës dhe me elemente të drurit dhe të metalta.

Duhet kushtuar kujdes dizajnit sipas shijes së sportistëve të llojeve të ndryshme të sportit. Makinat duhet të janë speciale dhe universale për prodhimin e këtyre produkteve. Produktet prodhohen në seri të vogla, individuale dhe me porosi.

Për realizimin e këtij programi nevojiten rreth 300m² sipërfaqe, mund të punësohen 30 punëtorë, nevojitet angazhimi i kapitalit prej 150.000€. Bruto fitimi vjetor do të jetë 180.000€.

Programi mund të aktivizohet brenda 6 muajve, kurse kapitali të kthehet brenda një viti. Raporti në 1€ investime është 1,2€. Çmimi i një vendi të punës është 5.000€, kurse fitimi për një punëtor është 6.000€.

Problemi ekologjik është sikurse te programet tjera të ngjashme në tekstil.

12. PROGRAMI I PRODHIMEVE NË BAZË TË PËRPUNIMIT TË MBETURINAVE NGA TEKSTILI

Mbeturinat nga tekstili kryesisht mund të përdoren në prodhimin e lodrave për fëmijë, për dekorim të rrobave, futrollave për libra etj. Meqenëse mbesin shumë mbeturina me rastin e përpunimit të leshit, të pambukut, stofit, sintetikës përdoren fije, për mbushjen e jastëkëve, për faculeta etj. Problemet e këtij programi janë të lira dhe kanë plasman të gjerë veçanërisht në tregun e plaçkave.

Për realizimin e këtij programi duhet siguruar 250m², të punësohen 25 punëtorë, të angazhohet kapitali prej 75.000€. Bruto fitimi vjetor do të jetë 150.000€ kurse raporti në 1€ investime 2,2€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës 3.000€, kurse fitimi për një punëtor do të jetë 6.000€. Programi aktivizohet brenda 3 muaj, kurse kapitali të kthehet brenda 6 muaj.

Problemi ekologjik nuk është i shprehur.

13. PROGRAMI PËR PËRPUNIMIN E LESHIT

Në ato mese ku është e zhvilluar blegtoria veçanërisht ku ekzistojnë fermat e dhive, lepujve mund të formohet reparti për përpunimin e leshit që do t'i kontribuonte punësimit të popullatës së atyre viseve. Përpunimi i leshit do të organizohet si artizanat. Veshmbathja nga leshi gjithmonë është në modë, kështu që orientimi në këtë prodhim është i leverdishëm, *sepse nga leshi prodhohen çorapet, xhemperët, dorëzat, shallet, kapelat etj.* Ngjyrosja e leshit do të kishte rëndësi të veçantë dhe me qenë në përputhje me kërkesat e tregut.

Veprimtaria mund të kryhet në shtëpi në kooperim me ndonjë kooperativë apo ndërmarrje private. Si dihet këto prodhime janë atraktive sidomos për stinën e dimrit dhe atë për nevoja të foshnjave dhe të rriturve me asortiment të ndryshëm të dimensioneve të ndryshme.

Një pjesë e madhe e familjeve fshatare disponojnë me mjete modeste për përpunimin e tyre siç janë furka me bosht për tjerre, shtiza, kërhamat për lënuarjen e leshit etj. Njohuritë barten prej një gjenerate në tjetrën.

Për realizimin e këtij programi nevojiten 150m², ku do të punësoheshin 20 punëtorë. Për sigurimin e kapitalit nevojiten 40.000€ që kryesisht do të shpenzoheshin për pajisje teknike, sigurimin e lëndës së parë dhe pagesën e punëtorëve. Bruto fitimi vjetor do të jetë 25.000€ kurse raporti në 1€ investime 2,4€.

Programi mund të aktivizohet për 2 muaj, kurse kapitali të kthehet për 5 muaj. Çmimi i vendit të punës është 2.000€ kurse fitimi për një punëtor 4.750€.

14. PROGRAMI I PRODHIMIT TË QYLYMAVE DHE TË PRODUKTEVE TJERA PREJ LESHIT

Në trevën tonë janë të njohura produktet e qylymeve, mbulesave të leshta varësisht nga treva p.sh. nga treva e Dukagjinit *prodhohen sexhadet, dyshekët për shtrojë etj.* Me këtë zeje së pari janë marrë gratë tona duke përgatitur pajën e nusërisë.

Produktet prodhohen nga leshi i deleve. Ky program mund të zhvillohet në të gjitha trevat e Kosovës dhe me investime të vogla të arrihen fitime të mëdha. Duhet pasur pajisje për lënurjen e leshit, tjerren, makina për prerje, për qepje etj. Mund të prodhohen produktet e ndryshme prej leshit, duhet organizuar prodhimin sipas porosisë dhe për treg, duhet zhvilluar raportet kooperuese me qëllim që puna të kryhet kryesisht në shtëpi.

Për realizimin e këtij prodhimi nevojiten 1.000m² deri në 1.200m² lokal i mbyllur, të punësohen 50 punëtorë, ku do të sigurohej kapitali prej 175.000€ që do të përdoret për sigurimin e pajisjeve, lëndës së parë dhe materialit. Bruto fitimi vjetor është 180.000€, raporti në 1€ investime është 1,03€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 3.500€, kurse fitimi për një punëtor 3.600€.

Problemi ekologjik është i ngjashëm sikurse tek programet tjera.

15. PROGRAMI I PRODHIMIT TË ÇARÇAFËVE TË SHTRATIT DHE ÇARSHAFËVE TË TJERË

Në tregun tonë ndihet nevojë e madhe për prodhimin e çarshafëve të fjetjes si për nevoja të shtëpive ashtu edhe për nevoja të hoteleve dhe moteleve, spitaleve etj. *Me rëndësi është edhe prodhimi i çarshafëve të trapezarisë, të tavolinave të kafiqeve, restauranteve duke pasur parasysh shtimin gjithnjë e më të madh të restaurantëve tek ne. Në kuadër të këtij programi mund të prodhohen edhe jastëkë, batanije etj.*

Për realizimin e këtij programi duhet të disponohet me 20 makina qepëse dhe 20 makina përcjellëse të vogla që mund të përdoren në lokale tjera afariste. Lëndën e parë për këto prodhime të gjithë mund ta sigurojnë në tregun e brendshëm.

Nevojitet sigurimi i lokalit afarist prej 500m², të punësohen 20 punëtorë, kapitali i angazhuar të jetë 50.000€. Bruto fitimi vjetor është 65.000€, kurse raporti në 1€ investime 1,3€ bruto fitim.

Programi mund të aktivizohet për 6 muaj, kurse kapitali kthehet brenda vitit. Çmimi i një vendi të punës është 2,5€, kurse fitimi për një punëtor është 3.250€.

Problemi ekologjik është i ngjashëm sikurse te programet tjera.

16. PROGRAMI I PRODHIMIT NGA TEKSTILI NË KUADËR TË ARTIZANATEVE SHTËPIAKE

Në kuadër të këtij programi prodhohen produkte të ndryshme *siç janë veshjet kombëtare, prodhimet për dekorim, mbulesat, punëdoret e thurura sipas modeleve, pëlhurat nga leshi (mbulesat, qilimat dekorativ etj.).* Lënda e parë për përpunimin e këtyre produkteve është kryesisht leshi. Këto prodhime janë prezentë në të gjitha viset tona, prodhohen individualisht nëpër shtëpi, për nevoja të anëtarëve të familjes e më pak për treg. Nevojitet organizimi dhe bashkëpunimi i zejeve shtëpiake nga kjo veprimtari me qëllim të shtimit të prodhimitarisë me asortimente të ndryshme për nevojat e tregut të brendshëm dhe të jashtëm d.m.th. organizohet

përmes kooperativave apo ndërmarrjeve për zeje shtëpiake ku do të sigurohej lënda e parë duke organizuar shitjen e produkteve të gatshme.

Për realizimin e këtij programi nevojiten 500m², punësohen 50 punëtorë me një numër të kooperativave prej 250 varësisht nga viset ku realizohet prodhimi. Kapitali i deponuar për fillimin e aktiviteteve të kësaj njësie prodhuese është 75.000€. Bruto fitimi vjetor duhet të jetë 225.000€ kurse raporti në 1€ investime 3€.

Programi aktivizohet për 3 muaj, kurse kapitali kthehet për 4 muaj. Vendi i punës është 1.500€, kurse fitimi për një punëtor 4.500€.

Problemi ekologjik nuk është i shprehur.

17. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E QYLYMAVE NYJORË TË PUNUAR ME DORË

Rëndësia e programit qëndron në punësimin e fuqisë punëtore të pakualifikuar të femrave. Lënda e parë është e vendit dhe ekziston mundësia e eksportimit të këtyre prodhimeve.

Lënda e parë është materiali: tjerri i leshit nga prodhimtaria e vendit, tjerri i pambukut gjithashtu nga prodhimtaria e vendit të pambukut të importuar.

Teknologjia e prodhimit përfshin: mbështjelljen e tjerit, endjen e tjerit, lidhjen e nyejve, qethjen, terjen dhe ekspeditimin. Objekti dhe pajisja: reparti montues me sipërfaqe prej 500m² (pjesa prodhuese, magazina e lëndës së parë, magazina e prodhimeve të gatshme, drejtoria) 50 veke metalike për endje me dorë, gjerësia punuese 2-3 metra, në secilin punojnë 2 punëtorë, makina për endje, kamion transportues. Tregu: ndërmarrjet e artizanatit shtëpiak dhe sallonet e mobileve. Ekziston mundësia për eksportim.

Ky program punëson 25 punëtorë, kapitali i angazhuar duhet të jetë 100.000€. Bruto fitimi vjetor do të jetë 80.000€ kurse reparti në 1€ investime 0,8€. Çmimi i një vendi të punës është 4.000€, kurse fitimi për një punëtor është 3.200€.

Programi aktivizohet për 6 muaj deri në 1 vit, kurse kapitali i deponuar kthehet për 1 vit e gjysmë.

Problemi ekologjik ngjashëm sikurse te programet tjera.

IV. PROGRAMET PËR KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESEVE NË BUJQËSI

DISA KARAKTERISTIKA DHE RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE TË BUJQËSISË

Duke pasur parasysh kushtet klimatike, nivelin e deritashëm të zhvillimit të bujqësisë, strukturën e fondit të tokës dhe plleshmërisë së saj, zhvillimin e industrisë ushqimore për nevojat e zhvillimit të bujqësisë në shtetet e zhvilluara dhe venet e tjera, pastaj strukturën e popullsisë dhe ecuritë demografike të saj, raportet e popullsisë qytet – fshat, nivelin e punësimit të popullsisë aktive dhe faktorëve të tjerë që ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë dhe shtimin e punësimit në këtë veprimtari kërkojnë medoemos që të përcaktohen kahet e mëtutjeshme të zhvillimit të bujqësisë dhe identifikimit të programeve në bazë të resurseve bujqësore për punësim në kushtet tona kosovare dhe më gjerë. Nga ky aspekt në QBV “Eureka: janë studiuar problemet e punësimit nga aspekte të ndryshme, janë arritur përvoja dhe njohuri lidhur me shumë ide dhe programe që janë identifikuar në institucionet e ndryshme profesionale-shkencore lidhur me punësimin në veprimtari të ndryshme bujqësore.

Duke studiuar mundësitë e zhvillimit të bujqësisë tek ne dhe përcaktimit të kushteve për punësim në këtë veprimtari është bërë përpjekje që të prezantohen disa programe në nivelin e përcaktimit ideor të tyre me përmbajtje të informatave të ndryshme siç janë: përcaktimi i programit konkret, madhësisë së programit dhe lokacionit të tij, përcaktimit të nivelit të kapitalit që duhet të angazhohet për sigurimin e objektit afarist, pajisjes teknike, mjeteve të xhiros, numrit të të punësuarve, realizimit të fitimit, kohës së aktivizimit të projektit dhe kohës së kthimit të kapitalit. Jepen edhe informata të tjera në lidhje me teknologjinë që duhet aplikuar në programe konkrete, llojet e lëndës së parë që duhet siguruar, pajisjen teknike, aplikimin e proceseve teknologjike, nevojat e tregut si dhe problemet teknologjike për realizimin e planit.

Në punim prezantohen më se 10 programe, sipas degëve të ndryshme të veprimtarisë bujqësore me theks të veçantë të programet e sigurimit të prodhimit ushqimor, në bazë të përpunimit të drithërave, pemëve dhe perimeve, prodhimit të mishit, përpunimit të bimëve mjekuese si dhe disa programe të tjera lidhur me zhvillimin e bujqësisë që kanë karakter zejtar dhe të industrisë përpunuese metalike.

Rëndësi të veçantë i kushtohet programeve për zhvillimin e fermave të ndryshme bujqësore. Lidhur me zhvillimin e fermave po japim një thënie angleze që thotë se për me qenë fermer duhet të martohesh dhe të trashëgosh ose të jesh dorështrënguar. Kjo thënie vlen edhe sot.

Blerja e pasurisë në fshat është e shtrenjtë, nëse gjërat janë në gjendje të mirë atëherë janë të shtrenjta, nëse janë në gjendje të keqe duhet të investohet në to. Nuk mendohet vetëm në përrirjen e pasurisë, por duhet të deponohet edhe në farë, pleh duke pasur parasysh çmimet jostabile dhe një pasiguri natyrore, kështu që puna është shumë e vështirë, e shtrenjtë nëse paguhet edhe puna e të tjerëve.

Mund të themi se nuk ka gjeneratë që dikush nuk mendon të kthehet në natyrë, që nuk ëndërron për fermë, për sallatë të mirë, për jetë të qetë dhe të shëndoshë, kthimin në shtëpi në pasuri të babës pasi të kenë provuar nxitjen në qytet.

Në shikim të parë në një moment duket jo vetëm tërheqëse por edhe e dobishme nëse dini se çka dëshironi, nëse keni para për përrirjen e pasurisë gjegjësisht nëse keni njohuri. Në çdo rast duhet të llogaritni në punë të vështirë edhe nëse është pasuria e juaj ose nëse e keni marrë atë me qesim

ose përgjysmë. Por krejt kjo është e pamundur nëse nuk ke makina bujqësore moderne që janë gjithashtu të shtrenjta.

Të merremi me bujqësi kërkohet shumë, fitimi mund të arrihet pas dy vitesh që është e domosdoshme të mbulohen të gjitha me kohë për sigurimin e një jete të rehatshme për vete dhe familjen. Nëse jeni të gatshëm për këtë duhet përfshirë edhe politikën jostabile në bujqësi që e udhëheqin shtetet e zhvilluara. Nuk duhet të jemi të pagximshëm, duke pasur parasysh se toka e mirë dhe puna në të sjellin mirëqenien (pasurinë) nëse dini se çka dëshironi.

Duhet para se gjithash mirë të llogaritni se sa nevojiten mjete për mbajtjen e një ferme, sa për blerjen e farës, plehut dhe deponimeve tjera e pastaj do të kishte me qenë mirë të orientohemi për një lloj të prodhimit dhe më mirë kishte me qenë nëse keni filluar ndonjë kontratë me tregtinë, kooperativën bujqësore ose me ekonominë bujqësore, më pak do të rrezikoni sepse pa sigurimin e tregut për prodhimet e specializuara siç janë këpurdhat, mjedrat, lulet etj., është gjithnjë rrezik i madh. Për fillim mundet që makina bujqësore të blihet së bashku me dikë ose të merret me qesim, mirëpo në asnjë rast nuk duhet të bëni nëse nuk keni njohuri të mjaftueshme apo nëse nuk e keni llogarinë e hartuar me ndihmën e ekspertëve financiarë dhe bujqësorë dhe para se gjithash ju dhe familja juaj nuk jeni të gatshëm të punoni natë e ditë, në shi dhe në diell.

Nëse jeni afër qytetit të madh duhet të orientoheni për treg me kusht që të ofroni mallin e mirë dhe mallin me të cilin të tjerët nuk disponojnë në sasi të mëdha. Edhe në këtë rast ju nevojitet që dikush t'ua shet mallin. Në treg me kombi mund të shkojë bashkëshortja fëmijët ose shitësi.

Nëse keni për qëllim rritjen e zogjve në inkubator nevojiten mjete të mëdha financiare për sigurimin e makinave të këtij lloj biznesi. Lehet e nxehta bazohen në shpenzime nëse merremi me kultivimin e perimeve që zakonisht është e pagueshme për arsye se në dimër kemi pak perime verore që mund t'i sigurojnë lehet e nxehta.

Edhe në punën e fermerëve mund të punohet me anëtarë të familjes ose të hyjnë në raporte të ortakëve me të tjerët. Nuk është ide e keqe krijimi i një bashkimi të tipit të veçantë ku disa familje mund të punonin së bashku në fermë me një pasuri të marrë me qira, ku ka vend të mjaftueshëm që të gjithë të punojnë së bashku. Mund të bëhet edhe diçka tjetër, të bashkohet kapitali, puna, të jetohet larg tokës por që çdo ditë të shkohet atje në punë. E gjithë kjo mund t'i sjell dobi por hyrje në bujqësi pa kurrfarë përvoja është e pamundshme.

Duhet të keni edhe ekspertin financiar për mbajtjen e librave nëse prodhohet racionalisht dhe në mënyrë moderne si prodhues i mallit, të keni këshilltarin juridik nëse është fjala për marrëdhënie në ortaki. Duhet deponuar edhe në propagandën për shitjen e prodhimeve bile edhe diçka nga prodhimet e veta t'i shpërndajnë nëpër shtëpi dhe të shkohet në vendet më të largëta në mënyrë që në treg t'i plasojnë prodhimet e veta në mënyrë që pas disa viteve të konstatojnë se jeton mirë.

Fermën duhet udhëhequr dhe të punohet si në një ndërmarrje. Për këtë është e preferueshme që të fillohet nga një pasuri më e vogël, me një specializim të prodhimit dhe me treg të sigurt.

Në Nju Jork të SHBA-ve kemi një numër të madh të fermerëve që jetojnë mirë sepse mbajnë kontakte të përhershme me Fakultetin e bujqësisë, por edhe përveç ushqimit për vete prodhojnë edhe për blerës të njohur që dëshirojnë ushqim me shije shtëpiake ashtu që prodhimet e veta ata i plasojnë në sasi të vogla shitoreve të pemëve, dyqaneve etj. Prodhimin e mjaltit, ëmbëlsirës, shurupeve të ndryshme, xhemit, pekmezit dhe për sasi të tjera kanë siguruar më parë meze dhe kanë siguruar kontratat për shitje.

Rritja e numrit të shitoreve të vogla tregtare me qytete u ofron mundësi fermerëve që t'i plasojnë produktet e veta.

Duhet të kemi parasysh se në kushtet tona nuk ekziston organizimi i mbledhjes së prodhimeve bujqësore, ato nuk finalizohen dhe plasohen si duhet. Efektet e tyre janë të zvogëluara për 50%.

Leshi, lëkura, bimët mjekësore mblidhen në mënyrë stihike dhe dërgohen jashtë edhe pse ekzistojnë kushtet për finalizimin e tyre në programe konkrete të karakterit përpunues dhe në formë të punëve shtëpiake. Edhe pse blegtoria paraqet degën më të rëndësishme të bujqësisë prodhimet nga blegtoria nuk janë finalizuar në shkallën e duhur. Për këtë arsye *propozohen programet e veçanta të formimit të thertoreve dhe përpunimit të mishit mandej prodhimi i qumështit, vezëve, leshit, përpunimi i yndyrës, lëkurës, qimeve dhe shumë produkteve tjera nga kafshë të gjalla*. Programet nga këto prodhime duhet të plotësojnë nevojat e tregut të brendshëm dhe një pjesë t' i dedikohet tregut të jashtëm.

Në kuadër të prodhimeve bimore mund të realizohen shumë programe siç janë konservimi i pemëve dhe perimeve, përpunimi i pemëve në kompot, në xhem, në vajra, përpunimi i drithit në bukë dhe në pluhura të ndryshme. Nga prodhimet e kafshëve është me rëndësi prodhimi i djathit të llojeve të ndryshme, mishit të thatë për nevojat vetanake si dhe përpunimi i leshit për nevojat e industrisë së tekstilit, të këpucëve etj

Programet e propozuara nga prodhimet bimore mundësojnë që të shtohet prodhimtaria e perimeve siç janë patatet, specat, domatet, ushqimi, trangujt etj., prodhimi i pemëve: millat, kumbullat, rrushi. Programi për kultivimin e duhanit, bimëve mjekuese, këpurdhave, prodhimi i qumështit, mjaltit, leshit, lëkurës etj., kanë rëndësi jo vetëm për punësim, por edhe për shtimin e prodhimtarisë ushqimore dhe veshmbathjes.

Disa programe të propozuara i përkasin zhvillimit të ekonomive shtëpiake të prodhimit bujqësor duke zhvilluar kopshtarinë, pemëtarinë, vreshtarinë dhe blegtorinë.

Me rëndësi të veçantë janë programet për prodhimin e specave dhe domateve dhe prodhimi i lëngjeve dhe pemëve. Propozohen edhe shumë programe nga lëmi i sigurimit të ushqimit për kafshë duke i kushtuar kujdes shtimit të livadheve në mënyrë artificiale dhe në përgjithësi intensifikimin e bujqësisë. Në këtë drejtim me rëndësi të veçantë janë prodhimi i elbit, patateve dhe lakrave.

Mund të propozohen edhe shumë programe lidhur me ujitjen e tokave bujqësore, sigurimin e ujit për pije, ndërtimin e rrjetit rrugor, ndërtimin e stallave dhe lokaleve tjera afariste për ekonominë bujqësore.

Programe të veçanta i kushtohen edhe përpunimit të grurit dhe misrit në produkte të ndryshme ushqimore.

Janë të rëndësishme gjithashtu edhe programet për rritjen e peshqve dhe përpunimin e mishit të peshqve, pastaj zhvillimin e bletarisë, përpunimin e mjaltit.

Programe të veçanta mund të identifikohen në rritjen e hithit si bimë e rëndësishme mjekuese.

Një numër programesh të identifikuar përfshijnë prodhimin dhe përpunimin e bimëve mjekuese, programet në bazë të bimëve ushqyese dhe melmesave në ushqimin e njerëzve, programet në bazë të produkteve sekondare pyjore si lëndë e parë etj.

Lënda e parë kryesisht sigurohet nga tregu i brendshëm.

Programet mund të aktivizohen kryesisht gjatë vitit deri në dy vjet e gjysmë, kurse kapitali i angazhuar në këto programe mund të kthehet brenda një viti por ka programe kur kapitali kthehet për dy ose tri vjet.

Me aplikimin e këtyre programeve mundësohet formimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, formimi i ekonomisë bujqësore në fshat, formimi i kooperativave në fshat etj. Shumë programe të prezantuara mund të realizohen edhe në kuadër të ndërmarrjeve dhe kooperativave ekzistuese. Mbartës kryesor të realizimit të programeve do të jenë ndërmarrësit në pronësinë private sidomos pronarët e pasurive fshatare, të ndërmarrjeve fshatare etj.

Programet e propozuara dhe të identifikuara me elemente karakteristike për analiza dhe studim të mëtutjeshëm ndikojnë në nxitjen e zhvillimit të biznesit privat kryesisht në fshat.

Realizimi i tyre mundëson kthimin e punëtorëve tanë përkohësisht të punësuar në botën e jashtme dhe ndikon në pengimin e emigrimit të rinjve tanë në botën e jashtme.

Me këto programe hapet perspektiva për zhvillimin e bujqësisë dhe shtimin e punësimit në fshat. Parashihet që mjetet financiare për realizimin e këtyre programeve të sigurohen nga punëtorët përkohësisht të punësuar në botën e jashtme, të cilët kapitalin e kursyer mund ta angazhojnë në kapacitetet për zhvillimin e vendlindjes.

Programet janë atraktive dhe tërheqëse edhe për nxitjen e partnerëve të jashtëm për deponimin e kapitalit të tyre në realizimin e këtyre programeve qoftë me deponime të përbashkëta qoftë me kapital plotësisht të vetin.

Financimin e këtyre programeve mund ta bëjnë edhe bankat dhe institucionet e ndryshme financiare botërore, duke pasur parasysh zhvillimin e bujqësisë si veprimtari prioritare në sigurimin e ushqimit të popullatës, ushqimit natyror etj.

LLOJET DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË BUJQËSISË

1. PROGRAMI I PRODHIMIT TË KORNETËVE DHE AKULLOREVE

Ky program bazohet kryesisht në brumërat e ëmbël, të përziera me sheqer, me çokollatë ose me prodhime të pemëve. Konsumues të këtij produkti janë prodhuesit e akulloreve, popullata. Kryesisht plasmani më i madh i këtij produkti realizohet në sezonin e verës e më pak në atë dimëror. Në kuadër të këtij produkti mund të jepen edhe kremra të ndryshme dhe sallata të pemëve, gështenjat, piret etj. Kryesisht programi lokohet në vendin e konsumit në qytet, në qendrat tregtare afër shitoreve të mëdha.

Për realizimin e këtij produkti nevojitet sipërfaqe e lokalit prej 500m², mund të punësohen 4 punëtorë të kualifikuar dhe gjysmë të kualifikuar. Kapitali deponues është 82.000€ që do të shpenzohej në lokal afarist 68%, pajisje 27% dhe nevoja tjera 5%. Ky program mund të realizohet për një kohë të shkurtër për 4 – 6 muaj, ndërsa kapitali mund të kthehet përafërsisht brenda 2 vjetëve. Bruto fitimi vjetor në këto programe mund të realizohet deri në 60.400€, kurse bruto fitimi për 1€ investime mund të jetë afër 0,80€.

Për një punëtorë nevojitet sipërfaqja prej 12,5m². Kapitali i investuar për një punëtor është 20.500€, ndërsa fitimi vjetor 15.000€ për një punëtor.

Kishte me qenë me rëndësi edhe prodhimtaria plastike e kulturave të ndryshme kopshtare në ekonomitë individuale. Investimet janë rentabile sepse koha e reakumulimit është mjaft e shkurtër (nevojitet vetëm një muaj që të rregullohet terreni). Për ekonomitë individuale konsiderohet se janë të nevojshme plateniket në hapësirë prej 300m². material kryesor është mveshja plastike valore me konstruksion të metalit.

Prodhimi i platenikeve kërkon kooperim të organizuar mirë kur është fjala për sektorin individual ose organizimin e funksionit qarkullues në një mënyrë më të përshtatshme (rrjeti i njëjësive të vogla të ekonomisë qarkulluese).

2. PROGRAMI PËR KULTIVIMIN E TRANGUJVE NË PRODHIMTARINË PLASTIKE

Duhet pasur parasysh llojin i cili kishte me dhënë rendimentin më të lartë. Porositet sorta valore RZ që e ka rendimentin e lartë dhe produktet e unjesuara. Ky lloj është i qëndrueshëm ndaj viruseve. Sipërfaqja prej 250m² kishte me qenë më rentabile për këtë lloj të prodhimit që kishte me dhënë diku për 1€ bruto fitim prej 0,57€.

Duhet kushtuar kujdes sortes së trangujve dhe gjithashtu duhet kushtuar kujdes madhësisë së platenikut. Plateniku mund të realizohet thjesht dhe shpejt mund të montohet në vendin e dëshiruar, kështu që mund të demontohet dhe bartet në lokacionet tjera.

Afati i qëndrimit është 4 vjet, është i përpunuar prej konstruksionit të çelikut me diametër 32mm dhe është i mbrojtur për tërë kohën nga galvanizimi. Përveç vetive termoizoluese, folia mundëson edhe pikjen e kondensuesve të ujit nëpër bimë. Ventilimi i plastikës realizohet në mënyrë të thjeshtë. Në këso lloje të plastikës është e mundshme vjelje tri herë në vit. Madhësia e tokës në 200m² për platenik, ku mund të punojnë 4 punëtorë kryesisht anëtarë të familjes.

Nevojitet angazhimi i kapitalit në shumën prej 4.000€ për një platenik. Brenda një muaji mund të realizohet, kurse kapitali mund të kthehet pas vjeljes së gjashtë. Bruto fitimi vjetor është 2.000€ kurse raporti i bruto fitimit për 1€ është 0,45€.

Çmimi për një vend pune është 1.000€ fitimi për një punëtor 500€.

3. PROGRAMI PËR KULTIVIMIN E SPECIVE NË PRODHIMTARINË PLASTIKE

Porositet lloji i specave Tango RZ, Polku RZ, Valetu RZ, Mazurku RZ, prej të cilave më i volitshmi është lloji i specave Tango RZ, që i ka frytet e forta. Kjo është sortë e hershme me rendimente të larta. Prodhimi më rentabil është në sipërfaqe prej 250m². Raporti i bruto fitimit për 1€ investime është 0,80€.

Duhet pasur kujdes për zgjedhjen e llojit të specave, për procesin e kultivimit dhe madhësisë së plastikës. Dimensionet dhe vetitë teknike të platenikut janë të njëjta sikurse te prodhimi i platenikut për kultivimin e trangujve.

Ky lloj prodhimi është më rentabil se sa prodhimi i trangujve. Bruto fitimi është 3.000€, kurse vjelja është katër herë gjatë vitit, ndërsa madhësia e sipërfaqes, numri i të punësuarve dhe sasia e kapitalit janë të njëjta.

Programe të ngjashme me kapital të njëjtë prej 4.000€ me nga 200m² sipërfaqe, me angazhim të 4 punëtorëve. Kemi edhe te PROGRAMET E PRODHIMIT TË DOMATEVE DHE LAKËRAVE TË BARDHA TË SALLATËS, duke respektuar të gjitha vetitë karakteristike, teknike të platenikut, por duke pasur parasysh zgjedhjen e llojit të sallatave të ashtuquajtura Changall RZ, Miledie RZ, Omegu RZ, Arcade RZ, Pui RZ. Mbillen më se 16 filiza (bimë) në një m².

Te domatet duhet pasur parasysh zgjedhjen e sortes Marta RZ që siguron frytin prej 130-150 gram.

Kemi lloje tjera të PROGRAMEVE PËR KULTIVIMIN E SALLATAVE KRISTAL DHE SALLATAVE GJETHEDENDURA NË PRODHIMTARINË E PLASTENIKUT të cilat mund të zhvillohen në sipërfaqe prej 200m² të platenikut, ku do të punonin nga 4 punëtorë, afati i aktivizimit të kapacitetit prej një muaji me një kapital prej 4.000€, që do ta realizonin raportin e bruto fitimit në 1€ 0,45€. Këtu gjatë vitit mund të bëhet vjelja gjashtë herë.

Te sallata Kristal duhet zgjedhur prej shumë llojeve të sallatave llojin Olympus RZ dhe 44-20 RZ. Pesha e sallatës është 500-600 gram, ndërsa te sallata gjethedendur duhet zgjedhur llojin Raisu RZ, Krizet RZ, Sesam RZ etj., që kanë peshën 250-500 gram për kokë.

Edhe te këto lloje të programeve të sallatave prodhimi rentabil kishte me qenë 250 m², raporti i bruto fitimit në 1€ investime është 0,57€.

4. PROGRAMI PËR KULTIVIMIN E SALLATËS VALERIANE

Sallata valeriane është sallata më e kërkuar e gjelbër, e cila kryesisht i ka fletët e gjelbërta, por rentabiliteti optimal i saj arrihet në 250m² sipërfaqe, raporti në 1€ investime është 0,74€ bruto fitim, duke pasur parasysh kushtet e njëjta të programeve tjera (4 punëtorë, 200m² sipërfaqe, 4.000€ të deponuara dhe 4 vjelje gjatë vitit, 3.000€ bruto fitim).

Mund të realizohen edhe programe tjera të rëndësishme siç janë:

5. PROGRAMET PËR KULTIVIMIN E RREPËS SË ËMBËL, TË KUQ DHE KAROTAVE

Të gjitha këto programe mund të realizohen nëse për çdo njëërën sigurohet sipërfaqja e platenikut në 200m², angazhimi i 4 punëtorëve, kapitali i angazhuar prej 4.000€, koha e aktivizimit të kapaciteteve është 1 muaj duke realizuar 6 vjelje, ku realizohen nga 2.000€ bruto fitim në vit me 0,45€ bruto fitim në çdo 1€ investime.

Këto lloje sallatash janë shumë të kërkuara kryesisht ato të gjelbërta, sidomos rrepat e ëmbla që kanë ngjyrën e gjelbër, peshën 150 gr, ndërsa rrepani i kuq i llojit Libero dhe Orion me ngjyrë të kuqe të mbyllur dhe lëkurë të hollë. Porositet që të shitet në treg dhe për përpunimin industrial. Ndërsa prej llojeve të karotave më të njohura janë Marimbo, Cornet, Ultra, Karaton. Shitet në treg e gjithashtu përdoret për përpunimin industrial.

6. PROGRAMET PËR KULTIVIMIN E RREPAVE TË VEGJËL NË PRODHIMTARINË PLASTIKE

Këtë program e karakterizojnë këto të dhëna: 1.000m² sipërfaqe, 4 punëtorë, 10.000€ kapitali i deponuar, koha e aktivizimit 1 muaj, vjelja katër herë gjatë vitit, bruto fitimi 7.000€, raporti i bruto fitimit në 1€ investime është 0,66€.

Pesha e produktit gjatë vjeljes është 50 gram. Përdoret në përgatitjen e sallatave të ndryshme në gjendje të njomë por edhe përpunohet në mënyrë industriale. Duhet pasur kujdes zgjedhjen e sortes dhe madhësisë së platenikut. Të gjitha karakteristikat e platenikëve të llojeve tjera të sallatave vlejné edhe për këtë lloj sallate. Çmimi për një vend pune është 2.500€ kurse fitimi për një punëtor 1.750€.

7. PROGRAMI I KULTIVIMIT TË LAKRËS KINEZE NË PLASTENIK

Ekzistojnë disa lloj lakrash kineze por me karakteristike është Asteni, Brocken dhe Michihili. Prej mbjelljes e deri te vjelja nevojiten 50 deri 60 ditë. Pesha e kokës së lakrës me rastin e vjeljes arrin 1 deri 1,5kg. Mbeturinat janë të vogla ndërsa koka është kryesisht e gjelbër. Koha e vegjetacionit është 85 deri 90 ditë. Duhet të kemi kujdes te zgjedhja e llojit të lakrës, të respektohen normat e procesit të punës dhe të merret parasysh madhësia e platenikut. Karakteristikat teknike të prodhimit të platenikut janë të njëjta sikurse tek platenikët tjerë.

Ky program bazohet në sigurimin e sipërfaqes prej 1.000m², në angazhimin e 4 punëtorëve, deponimin e kapitalit prej 10.000€, aktivizimin deri në një muaj, gjatë vitit vjelja bëhet katër herë, bruto fitimi vjetor 7.000€, raporti i bruto fitimit në 1€ investime është 0,66€. Çmimi për një vend pune është 2.500€ kurse fitimi 1.750€.

Me të njëjtat kushte në 1.000m² sipërfaqe tokësore, me 4 punëtorë, me 10.000€ kapital, brenda një muaji të aktivizimit të kapitalit, vjelja katër herë brenda vitit, realizimi i 7.000€ bruto fitim në raport të bruto fitimit në 1€ investime 0,66€, mund të realizohen këto programe: programi i kultivimit të kungujve, programi i kultivimit të domateve, programi i kultivimit të spinaqit etj.

8. PROGRAMI I KULTIVIMIT TË KUNGUJVE NË PLASTENIK

Produktet e kungujve kanë ngjyrë të verdhë në të gjelbër. Pesha e produktit është 500 gram. Më së tepërmi përdoret për nevojat familjare sidomos për gjellërat e ndryshme të ziera. Me rritjen e sipërfaqes së plastenikut rritet edhe profitabiliteti i programit. Me rastin e realizimit të këtij programi duhet pasur kujdes zgjedhjen e sortes së kungullit, madhësinë e plastenikut, zbatimin adekuat të proceseve të kultivimit etj.

9. PROGRAMI I KULTIVIMIT TË DOMATEVE NË PLASTENIK

Këto produkte kanë ngjyrë të kaltër të mbylltë, kanë peshën 150 deri 20 gram, që përdoren kryesisht për ushqimin familjar por edhe për prodhimin e ushqimit industrial.

10. PROGRAMI I KULTIVIMIT TË SPINAQËVE NË PLASTENIK

Duhet përdorur dy llojet më të rëndësishme të spinaqit siç janë Martine dhe Taurus. Martine është lloj i fletës së trashë me ngjyrë të gjelbër të mbylltë. Kryesisht shitet në treg, përpunohet në mënyrë industriale si dhe teret (thahet). Kjo sortë porositet për mbjellje të hershme.

Edhe te këto lloj programesh duhet respektuar vetitë karakteristike teknike të plastenikëve, zgjedhjen e madhësisë së tij, zgjedhjen e sortës etj.

11. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E DREDHËZAVE

Dredhëza është prodhim rentabil (mbin çdo vit, herët piqet, jep 9-13 t/ha). I përshtatet kushteve të ndryshme ekologjike e më së shumti rritet në tokën argjillore-ranore dhe në tokën me materiet organike. Nuk nevojiten deponime të posaçme investicionale. Vlera përdoruese është e ngjashme me mjedrat.

12. PRODHIMI I DREDHËZAVE NË PLASTENIK

Sorta e hershme e dredhëzave është shumë e kërkuar në tregun e brendshëm dhe mundet në pranverë të shitet mirë, është shumë e preferueshme që të bëhet kultivimi i këtij fryti në plastenik. Duhet t'i kushtohet kujdes teknologjisë për kultivimin e dredhëzave dhe madhësisë së plastenikut. Vetitë e plastenikut janë të ngjashme si te të gjitha plastenikët tjerë të pemëve dhe perimeve.

Me sipërfaqen prej 1.000m², me 4 punëtorë, deponim prej 1.000€, në kohë të aktivizimit prej 3 muajve, bruto fitimi vjetor është 16.000€. Raporti i bruto fitimit në 1€ investime është 1,45€. Çmimi për një vend pune është 250€, kurse fitimi për një punëtor është 4.000€.

13. PROGRAMI I KULTIVIMIT TË MJEDRAVE

Mjedra është më e rëndësishmja nga familja e dredhëzave. Lehtë shumëzohet, frytin fillon ta japë në vitin e parë dhe të dytë kurse më frytdhënëse është në vitin e tretë. Vëllimi i prodhimit ngec në krahasim me kërkesën. Përdoret në gjendje të freskët, të ngrirë dhe në forma të ndryshme të përpunimit. Se sa do të jetë frytdhënëse varet nga lloji, kushtet tokësore dhe masat agroteknike. Mesatarisht mund të llogaritet rreth 10t për 1ha që mundëson prodhimtari rentabile. Janë të përshtatshme toka e shkrihtë, e depërtueshme dhe më pak acidike, e pasur me materie organike që mund të mbajnë lagështinë gjatë kohës së thatë.

14. PRODHIMI I MJEDRËS NË PLASTENIK

Mjedra mund të shitet lehtë në treg me çmim të volitshëm. Kultivimi i Mjadrës është treguar rentabil, nga ky aspekt është e porositshme që të prodhohet.

Duhet pasur kujdes në zgjedhjen e sortes për produkte më të mëdha. Element kritik është zgjedhja e teknologjisë për kultivimin e kësaj peme dhe madhësia e plasteniku.

Në 1.000m² me 4 punëtorë (anëtarë të familjes), me kapital prej 10.000€, në afat të aktivizimit prej një muaji, kapitali mund të kthehet për 2 vjet. Bruto fitimi vjetor është 4.600€, në raport 1€ investime 0,40€ bruto fitim. Çmimi për një vend pune është 2.500€, kurse fitimi për një punëtor 1150€.

15. PROGRAMI I KULTIVIMIT TË MANAFERAVE

Manaferrat kanë plasman të volitshëm në treg, nuk kërkojnë shumë punë, porositet sorta që piqet herët, rentabiliteti është i varur nga madhësia e plastenikut, duhet pasur kujdes për zgjedhjen e teknologjisë për prodhimin e mjadrës.

Me të njëjtin kapital si të kultivimi i mjadrës arrihet bruto fitimi i njëjtë.

16. PROGRAMI I PRODHIMIT TË USHQIMIT NË PLASTENIK

Në plastenik mund të kultivohen të gjitha llojet e perimeve, luleve, këpurdhave, fidanëve të pemëve dhe hortikulturave. Plasteniku duhet ndërtuar prej gypave të aluminit të zinkuar në madhësi prej 4-8mm në formë harkore. Plasteniku mund të jetë disa llojesh. Duhet zgjedhur ventilimin e plastenikut duke lënë në kulm hapësira të cilat mund të çilen me dorë ose përmes motorit të automatizuar. Plasteniku mund të nxehet me ujë të vakët ose me rreze dielli. Është me rëndësi se plasteniku mund të jap gjegjësisht fitimin prej 30 deri 80 herë më shumë në krahasim me sipërfaqen e hapur.

Duhet përdorur ndërtimin e plastenikut kryesisht në sipërfaqen e tokës prej 2.000m² që kishte për të mundësuar angazhimin e 8 punëtorëve me një kapital prej 26.000€ brenda një muaj aktivizimi, kapitali do të kthehej brenda vitit, kurse bruto fitimi vjetor kishte me qenë afër 24.000€ që do të thotë se çdo punëtor do të realizonte 4.000€ brenda vitit që për kushtet e tashme është faktor me rëndësi duke pasur parasysh numrin e madh të të papunësuarve sidomos në familjet fshatare ku pothuajse çdo familje ka më shumë se tetë anëtarë, që të gjithë do të mund të punësoheshin në aktivitete të ndryshme të përpunimit të tokës me anë të plastenikut.

Programe të rëndësishme nga prodhimtaria ushqimore paraqesin edhe *kultivimi i qepëve, rrepave, patateve të hershme etj.*

17. PROGRAMIN E PRODHIMIT TË QEPËVE

duhet angazhuar përafërsisht gjysmë hektari tokë, me angazhimin e katër punëtorëve apo numër më të madh të anëtarëve të familjes me deponime përafërsisht 4.000€ kapital, kishte me u realizua 16.000€ bruto fitim vjetor, që d.m.th. raporti i bruto fitimit për 1€ investime 4€ bruto fitim.

Prodhimi i qepëve kishte me qenë si program sezonal plotësues në bujqësi dhe brenda çdo tri vjetëve kishte me u mbjellur e njëjta tokë. Duhet shfrytëzuar edhe mekanizmin vetjak, kuptohet në shpenzimet e prodhimit të qepëve bëjnë pjesë: shpenzimet e qepëzave (arpaxhikut), përgatitja e tokës, mbrojtja nga sëmundjet dhe insektet e ndryshme, vjelja, magazinimi i qepëve, transporti. Njëkohësisht duhet pasur parasysh zgjidhjen e sortit të qepëve e cila jep rendiment më të lartë dhe mund të shitet më lehtë.

18. PROGRAMI I PRODHIMIT TË RREPAVE

Pothuajse bazohet në të gjitha karakteristikat dhe vetitë për rritjen e qepës, mirëpo rrepani është i qëndrueshëm pothuajse në të gjitha tipet e tokës, kështu që prodhimtaria e këtij programi zakonisht organizohet si zeje shtëpiake.

Në realizimin e këtij programi përveç një gjysmë hektari tokë duhet siguruar edhe 14.000€ kapital deponues që brenda një viti kishin me dhënë 28.000€ bruto fitim vjetor, ku raporti në 1€ investime është 2€ bruto fitim dhe këtu mund të punësohen 4 punëtorë, gjegjësisht bujq ndërmarrës.

19. PROGRAMI I KULTIVIMIT TË PATATEVE TË HERSHME

Duhet të bazohet në mbjelljen e patateve në gjysmë hektari tokë duke siguruar 40m² sipërfaqe në depo, ku do të punonin 4 punëtorë bujq, gjegjësisht anëtarë të familjes duke siguruar kapital prej 18.000€ që kishte me dhënë bruto fitim vjetor 34.000€ gjegjësisht raporti i bruto fitimit për 1€ investime 1,89€ bruto fitim.

Programi realizohet brenda vit me mbjelljen e parë pas pasimit dhe realizimit të gjysmës së produkteve kthehet kapitali.

Programi i kultivimit të patateve të hershme bazohet kryesisht në sipërfaqen prej gjysmë hektari në pronësi individuale dhe mekanizëm individual dhe depo të nevojshme. Kultivimi bëhet në folije të zezë në afat prej tri vjetësh arrihet pjekuria e hershme dhe produktet janë të pastra dhe të harmonizuara. Patatet e hershme nuk kanë lëvore dhe kanë një çmim më të volitshëm në treg. Mikrolokacioni i tyre mund të jetë afër qendrave konsumuese duke pasur parasysh edhe kushtet e infrastrukturës.

20. PROGRAMI I KULTIVIMIT TË MËLMESAVE TRADICIONALE

Ky program është atraktiv sidomos për viset bregdetare ku kemi të njohura bimët mjekuese dhe mëlmesa. Ky mund të jetë program familjar i zezes shtëpiake ku anëtarët e familjes i mbledhin, i klasifikojnë, i pastrojnë, përpunojnë, i paketojnë dhe i plasojnë në treg si mëlmesa siç është oringo etj.

Prodhimet plasohen si të freskëta, të terura etj. Duhet kushtuar kujdes plasmanit të këtyre prodhimeve dhe teknologjisë së përpunimit të tyre.

Programi bazohet në sipërfaqen prej 60m² kryesisht në shtëpi të ndërmarrësit ku do të punësoheshin 8 anëtarë gjegjësisht punëtorë, me sigurimin e kapitalit prej 38.800€ që do të shpenzoheshin në pajisje afër 18%, për automobil të mbajtur afër 77% dhe më se 5% për nevoja të tjera. Bruto fitimi vjetor për këtë program kishte me qenë 92.000€ kurse raporti në 1€ investime 2,2€ bruto fitim.

Aktivizimi i programit mund të realizohet brenda 1-2 muaj kurse për 7 muaj mund të kthehet kapitali.

21. PROGRAMI I KULTIVIMIT TË KËPURDHAVE SHAMPION

Këto këpurdha mund të kultivohen në një bodrum me sipërfaqe prej 500m² në pronësi të pronarit ku mund të punësohen 8 punëtorë, kryesisht anëtarë të familjes, me një kapital prej 78.000€ që kishte për t'u harxhuar për punë zeytare instaluese 26%, për klimatizim 51%, për mobilie 13%, makina dhe vegla tjera 8% dhe për nevoja tjera rreth 2%.

Me aktivizimin e programit prej 2-3 muaj kapitali do të kthehet për 4 muaj dhe bruto fitim vjetor 86.000€ në raport 1€ investime 0,96€ bruto fitim.

Ky program kërkon pak punë, prodhimi lehtë shitet, kryesisht duhet pasur sipërfaqen, gjegjësisht podrumin e pajisur me inventar të nevojshëm, por njëkohësisht duhet pasur energji elektrike, ujë etj.

Duhet pasur parasysh edhe paketimin në kuadër të zejes shtëpiake. Me rëndësi janë edhe kushtet e infrastrukturës etj.

22. PROGRAMI I KULTIVIMIT TË KËPURDHAVE SHAMPIONE DHE KËPURDHAVE TË AHUT NË PLASTENIK

Ky program ka rëndësi që mund të zhvillohet në një familje 3-4 anëtarësh me një sipërfaqe të platenikut prej 200m², me një kapital prej 40.000€ për platenik dhe pajisjen e tij, por mundet edhe një stallë prej 200 deri 400m² të adaptuar sipas kushteve teknologjike të prodhimit. Ky mund të shërbejë si program prodhues dhe mund t'i kontribuoj realizimit të bruto fitimit prej 24.000€ në raport 1€ investime 0,60€ bruto fitim, kurse aktivizimi i programit do të bëhet për 60-90 ditë kurse kapitali kthehet pas 2 vjetësh.

23. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E USHQIMIT NATYROR (USHQIMOR)

Në kuadër të këtij programi kishin për t'u realizuar edhe disa nënprograme: programi për treg dhe i mbeturinave. Mbeturinat kishin me u përdorë si material riprodhues apo ndihmës në produktet tjera si për shembull me rastin e kultivimit të kërmijve që janë të destinuar për treg, një pjesë e tyre mund të shërbejë edhe për ushqimin e peshqve. Kërmijtë ushqehen me bimë dhe perime që mbesin pasi të përgatiten për treg. Ky program kërkon diku rreth 30.000m² sipërfaqe tokë, angazhon 10 punëtorë, kapitali 334.000€ mund të realizohet një bruto fitim vjetor prej 366.000€ në raport 1€ investime 1,19€ bruto fitim. Brenda 6 muajve të angazhimit të kapitalit, kurse kapitali kthehet pas 16 muajve.

24. PROGRAMI PËR AFTËSIMIN E KUADROVE PËR PRODHIMIN DHE PËRGATITJEN E USHQIMIT NATYROR

Ky program do t'u ndihmonte ndërmarrësve që me kurse të shkurta në botën e jashtme ose me sigurimin e literaturës të fitohen njohuritë elementare për këtë punë. Shfrytëzuesit e këtyre kurseve kishin me qenë kryesisht prodhuesit potencial të ushqimit natyror ose konsumuesit e këtij ushqimi. Me këtë rast realizimi i programit mund të tubohen ekspertë të njohur me përvoja botërore për prodhimin dhe sigurimin e ushqimit natyror, seminarët mund të organizohen mbrëmjeve, të shtunave, sidomos në qytete të mëdha siç janë: Prishtina, Peja, Prizreni etj.

Për realizimin e këtij programi nevojiten përafërsisht 100m² lokal që kishte me qenë një sallë e marrë me qira ku do të punësoheshin 2 vetë e më tepër, të sigurohet kapitali prej 6.000€ për pajisje dhe mjete të xhiros që në afat prej 4-6 muaj të aktivizimit të këtij programi mund të realizohen 30.000€ bruto fitim, raporti në 1€ investime 5€ bruto fitim.

25. PROGRAMI I PRODHIMIT DHE PËRPUNIMIT TË ORESHKAVE PËR DIABETIK

Oreshka është me prejardhje prej Amerikës së Jugut, gjegjësisht Meksikës dhe Brazilit që mund të kultivohet edhe në viset mediterane. Fryti i përngjan patates. Në gjendjen e njomë ka shijen e lajthijave të papjekura. Është bimë shumë e ushqyeshme me ndikim shumë të madh në shëndetin e njeriut. Shitet në treg dhe në hotele e restorante, shërbehen me to mysafirët.

Në 2 ha punësohen 10 punëtorë me një kapital prej 10.000€, me aktivizim prej një viti, kapitali kthehet me plasmanin e realizimit të 1/5 të produkteve kurse bruto fitimi realizohet në shumë prej 52.000€, në raport 1€ investime 5,2 bruto fitim.

26. PROGRAMI I PRODHIMIT TË MJALTËS

Rajonet shkrepeore janë të begatshme me bimët mjaltë sjellëse që janë shumë të përshtatshme për bletari si veprimtari përcjellëse e ekonomive individuale. Në kuptimin organizativ, para se gjithash është e domosdoshme të formohen shoqëritë bletare dhe kooperativat bletare në të gjitha komunat përmes të cilave bletarët e ardhshëm do të mund të marrin udhëzime dhe këshilla profesionale, do të furnizoheshin me koshiqe dhe pjesë të tjera si dhe mjete ndihmëse (për ushqim, mbrojtje) dhe materiale ndihmëse.

Krahas mjaltit si prodhim kryesor mund të grumbullohen edhe disa produkte të tjera të rëndësishme të bletës.

Rrëshira ngjitëse të cilën bletët e shfrytëzojnë për mbylljen e të qarave të koshiqeve, por gjithashtu është i njohur edhe si barë shërues që ka përdorim të gjerë. Vlerësohet se nga një koshiq mund të nxjerrën 200gr.

Pluhuri i polenit që është shërues për frymëmarrje dhe organet e tretjes. Për një koshiq mblidhen afër 6kg.

Dylli është produkt që bletarët e përdorin për riprodhimin e hojeve të bletëve.

Bletarët që kanë përvojë dhe merren personalisht me bletari mund të arrijnë që të nxjerrin për një koshiq mesatarisht afër 20kg mjaltë.

Programi i prodhimit të mjaltës dhe produkteve të tjera nga mjalti bazohet në shpërnguljen e koshiqeve me një kamion të veçantë të adaptuar që do të vendoseshin afërsisht 150 koshiqe, me mundësi që më shkurtë ose më gjatë të mbahen në vende të ndryshme ku janë kullosat për bletë. Krahas koshiqeve dhe hojeve nevojiten edhe këto pajisje: Kutia për punë që përmban çekanin, gozhdat, enët për ujë, thika etj., centrifuga, shpueset për korniza, pirunët për heqjen e mbyllëses, derës së koshiqeve, pajisja mbrojtëse, bartësit e kornizave, enët plastike për ushqim, enët për ruajtjen e mjaltit etj.

Kapaciteti i mbajtjes së bletëve varet nga kapaciteti i kamionit ku duhet të vendosen bletët që duhet të kullosin. Nga ky aspekt duhet siguruar 1 ose 2 kamionë, 150 gjegjësisht 300 koshiqe, me sipërfaqe të mbyllur 20 deri 40m², 1 deri në 2 punëtorë që do të punonin nga 1 deri në 2 orë në ditë.

Një program i tillë i organizimit të prodhimit të mjaltës kërkon një kapital prej 112.000€, gjegjësisht 224.000€ që kishin me u shpenzua kryesisht për sigurimin e koshiqeve afër 54%, për kamion rreth 27%, ndërsa për pajisjet tjera 19%.

Programi kish me u realizuar brenda një viti kurse kapitali i deponuar do të kthehet për 3 vjet me bruto fitim vjetor prej 46.000€, gjegjësisht 52.000€, varësisht prej numrit të koshiqeve, ndërsa raporti në 1€ investime 0,40€ bruto fitim.

Ky program është atraktiv për kushtet tona, sidomos një numër i madh i penzionerëve mund të merren më këtë veprimtari me qëllim të realizimit të të ardhurave plotësuese për mbajtjen e familjeve të veta.

27. PROGRAMI I PRODHIMIT TË BRUMIT SHTËPIAK

Ky program është tërheqës për treg, llojet e ndryshme të brumit janë të kërkuara nga konsumues të ndryshëm. Për prodhimin e brumit mund të formohet një repart i prodhimit të brumit sipas recetave të veçanta siç janë: Raviola, tortet dhe brumet nga qumështi. Programi mund të vendoset në vend ku jetojnë më së paku 5.000 banorë. Programi kërkon punë profesionale jo vetëm të teknologjisë së prodhimit të brumit por edhe të tregut etj. Në program mund të punësohen një numër i dukshëm i punëtorëve të përhershëm, por mund të angazhohen edhe bashkëpunëtorë të jashtëm.

Programi mund të realizohet në sipërfaqe prej 120m² në të cilën do të punësoheshin 10 punëtorë, ndërsa kapitali fillestar për realizimin e këtij programi duhet të jetë rreth 206.000€, që kryesisht do të shpenzohet për ndërtimin e lokaleve dhe sigurimin e makinave mbi 60%. Duhet të ketë inventar të mjaftueshëm, mjete transportuese etj.

Kapitali mund të kthehet për 2 vjet, kurse bruto fitimi vjetor do të realizohet rreth 200.000€. Raporti 1€ investime 0,92€ bruto fitim. Ky program mund të jetë me sipërfaqe dhe kapital më të vogël dhe me një numër më të vogël punëtorësh, varësisht nga nevoja e tregut dhe mundësit e ndërmarrësit për realizimin e këtij programi.

28. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E BRUMIT ME PERIME

Në bazë të këtij programi mund të formohet reparti për prodhimin e llojeve të veçanta të brumit të përzier me spinaq, karota, lakra që kishte për t'u vendosur në vendet konsumuese, ku më së paku jetojnë 5.000 banorë, por me kusht që të mos ketë konkurrencë tjetër.

Për realizimin e këtij programi duhet shfrytëzuar përvojat italiane bile edhe teknologjia italiane mund të aplikohet për prodhimin e këtyre produkteve në bazë të këtij programi. Lënda e parë për realizimin e këtij programi mund të sigurohet në vend në sasi të mjaftueshme.

Duhet kushtuar kujdes recetave për prodhimin e brumeve të tilla me asortimente të ndryshme, sipas mundësisë me çmime të volitshme.

Për realizimin e këtij programi mund të sigurohet sipërfaqja prej 120m², me punësim prej 10 punëtorëve, me kapital prej 210.000€ që do të shpenzohet për ndërtimin e lokalit, punët zejtare përafërsisht 40, ndërsa për sigurimin e makinave mbi 30%.

Ndërmarrësi për realizimin e këtij programi duhet të disponoj edhe me mjete transportuese që do të shpenzoheshin 20% të kapitalit për këto nevoja. Programi mund të aktivizohet brenda 1 viti, ndërsa kapitali gjithashtu mund të kthehet për 2 vite e gjysmë me bruto fitim vjetor prej 160.000€ në raport 1€ investime 0,71€ bruto fitim.

29. PROGRAMI I PËRGATITJES SË MERMELADËS, XHEMAVE DHE REÇELEVE

Ky program kryesisht organizohet për sigurimin e mjeteve plotësuese të anëtarëve të familjes. Përgatitet në mënyrë tradicionale prej domateve, limonit, portokajve. Përgatitet reçeli prej qershijave dhe portokajve si dhe reçeli prej ftonit dhe kaçave. Këto lëndë të para mund të sigurohen lehtë kurse procesi i punës kryhet në shtëpinë e ndërmarrësit, kurse plasmani bëhet nëpër shitore të gjërave ushqimore.

Produktet e këtij programi duhet të kenë shije dhe të jenë të lira në krahasim me ato industriale. Me qëllim të prodhimit për treg, për realizimin e këtij programi nevojitet në sipërfaqe prej 50m² në shtëpi, ku do të punësoheshin 4 anëtarë të familjes me një kapital prej 30.000€, për pajisje të ndryshme teknike por kryesisht për blerjen e një automobili që kishin për t'u shpenzuar më se 70% për këtë. Programi mund të aktivizohet për 2 muaj, kurse kapitali do të kthehet brenda vitit, kurse bruto fitimi vjetor mund të jetë 33.000€ në raport 1€ investime 1,10€ bruto fitim.

Duhet kushtuar kujdes të veçantë faktorit ekologjik.

30. PROGRAMI I PRODHIMIT TË SHURUPIT SHTËPIAK

Ky program destinohet kryesisht për nevoja shtëpiake dhe njohësve të mirë të recetave për përgatitjen tradicionale të shurupit natyror prej boronicës, dudit, shtogut, zhumbicës etj.

Këto produkte kryesisht përgatiten në formë të zejeve shtëpiake dhe shiten përmes shitoreve tregtare. Ndërtimi i kapaciteteve të këtij programi preferohet që të realizohet në viset ku ka më shumë se 50.000 qytetarë. Sipërfaqja e lokalit e nevojshme është 40m² që kishte për t'u zhvilluar në shtëpi ose banesë ku do të angazhoheshin 6 punëtorë me 3 orë në ditë pune, kurse kapitali i nevojshëm do të ishte 36.000€ për blerjen e pajisjeve 40%, blerjen e automobilit 56%.

Programi mund të aktivizohet brenda vitit, kurse kapitali të kthehet për 7 muaj. Bruto fitimi vjetor do të jetë 80.000€, në raport 1€ investime 2,10€ bruto fitim.

Niveli ekologjik i njëjtë si tek programet tjera.

V. PROGRAMET E BIZNESIT PËR KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E INDUSTRIËSË USHQIMORE DHE PIJEVE

KARAKTERISTIKAT DHE RËNDËSIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËSË SË PIJEVE DHE USHQIMIT

Prodhimi i mishit paraqet një ndër artikujt kryesor të ushqimit të popullatës. Sigurimi i mishit në rritjen dhe mbajtjen e blegtorisë, shpezëtarisë, peshkatarisë etj. Në kuadër të prodhimit të mishit janë të rëndësishme: programet e thertoreve të zogjve, deleve dhe qengjave, lopëve, programet e prodhimit të suxhukut, programi i prodhimit të suxhukut të qëndrueshëm, prodhimi i përshutës, prodhimi i mishit të terur dhe të kryposur të peshkut, prodhimi i mishit të peshkut të kryposur, ambalazhi vakum i gjërave ushqimore etj.

1. PROGRAMI I PJEKJES SË KAFES ME SHITORE VETANAKE

Ky program mund të organizohet në një miniuzinë të llojeve të ndryshme të kualitetit të kafes duke e paketuar në ambalazh me kombinime të ndryshme dhe duke shitur në shitore vetanake.

Programin duhet locuar në vendet urbane ku jetojnë më se 20.000 banorë dhe në vendet ku ekziston tradita e pirjes së kafes. Shitorja duhet të locohet në vendet ku ka frekuencë të blerësve potencial.

Madhësia e sipërfaqes për realizimin e këtij programi duhet të jetë 120m², punësohen 16 punëtorë, kapitali i deponuar duhet të jetë 154.000€ që kishte për të shërbyer kryesisht për makina të ndryshme afër 47%, inventarit, blerjes së automobilit etj. Aktivizimi i programit bëhet për një apo dy muaj, ndërsa kapitali mund të kthehet për 5 muaj, kurse bruto fitimi vjetor është 600.000€, e raporti në 1€ investime 3,22€ bruto fitim.

Edhe këtu duhet të zgjidhet problemi ekologjik.

2. PROGRAMI I MBUSHTORES SË UJIT

Ky program i pijeve joalkoolike i cili është zhvilluar në Nju Jork në mënyrë shumë të thjeshtë. Ndërmarrësit e këtij programi në një garazh i kanë mbushë me ujë gotat duke blerë makinat dhe shihet prej 3.000 dollarë. Pas një kohe shumë të shkurtë prodhimi i tyre është bërë shumë atraktiv. Këto pije joalkoolike janë kategorizuar në grupin e 30 pijeve të vlerësuara si më të mira për nga shija dhe ngjyra.

Duke pasur parasysh lëndën e lirë natyrore në bazë të këtij programi mund të realizohet fitim i madh.

Për këtë program duhet siguruar 1.000m², punëson 8 punëtorë, angazhon kapital prej 240.000€, programi mund të realizohet për 4 deri 5 muaj, kurse kapitali mund të kthehet për një vjet. Bruto fitimi vjetor është 300.000€.

Raporti në 1€ investime 1,25€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 30.000€, kurse fitimi për një punëtor është 37.500€.

Duhet kushtuar kujdes faktorit ekologjik.

3. PROGRAMI I PRODHIMIT TË KUPAVE TË MISRIT

Ky program është atraktiv, prodhues të tij të njohur kanë qenë amerikanët në bazë të kokrrave të misrit. Në kuadër të këtij programi mund të prodhohen 18 lloj të kupave të misrit. Më i popullarizuari është chedar me djathë dhe karamele dhe ai me aromë taccoa, me maje të thartë, me qepë, me yndyrë të kikirikëve. Këtu mund të shiten edhe kupat me shije të limonit, të portokallit, dredhëzave, ananasit etj. Mund të prodhohen 150 kg kokica ekzotike në ditë. Kokicat shiten në formë të topit, të shtazëve, të ëmbëlsirave etj. është punë e thjeshtë, lënda e parë e lirë, ka mjaft, pikë kritike është organizimi i shitjes.

Sipërfaqja 120m² (ndërtimi i punëtorisë), punësohen 4 punëtorë, kapitali prej 160.000€, pajisja dhe lokali marrin pjesë me 90%, programi aktivizohet për një vjet, kapitali për 1,5 vjet.

Bruto fitimi vjetor 240.000€, raporti në 1€ investime 1,25 bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës 30.000€, kurse fitimi për një punëtor 60.000€.

4. PROGRAMI I FURRËS

Programi i kësaj furre shënon gjithnjë e më shumë rezultate edhe në kohën kur nuk janë kushtet e volitshme, kur ndërmarrësit e tjerë veç i mbyllin lokalet e veta. Shumë furrtarë në prodhimin e bukës realizojnë humbje, mirëpo nëse ndrohet asortimenti në tërësi pas një kohe mund të realizohen rezultate të mira, p.sh. një ndërmarrës i ri pas një viti punë në fletpropaganden e biznesit të vet ofron 78 lloje të prodhimeve nga buka e zezë, e bardhë, peciva të ndryshme, lloje speciale të bukës, ëmbëlsira të ndryshme, ushqim për vegetacion etj. Oferta e prodhimeve ndryshohet varësisht nga stina dhe kërkesa e konsumuesve. E tërë kjo mundëson që furrtorja të nxitë interesimin e restoranteve dhe shitoreve për paraqitjen e shpejt të ushqimit dhe në këtë mënyrë furrtorja ka realizuar një sukses të mirë dhe ka mundësuar hapjen e shitoreve vetanake për shitjen e produkteve të veta.

Programi i furrtores së tillë mund të bazohet në sigurimin e lokalit prej 100m², ku punësohen 4 punëtorë, kapitali i deponuar prej 40.000€, koha e aktivizimit të programit është 4 deri në 6 muaj, afati i kthimit të kapitalit është 9 muaj, bruto fitimi vjetor është 160.000€, raporti në 1€ investime 4€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 10.000€, kurse fitimi për një punëtor është 40.000€.

Duhet të zgjidhet problemi ekologjik.

5. PROGRAMI I PRODHIMIT TË MJETEVE SHËRUESE NË BAZË TË BIMËVE

Ky program bazohet në lëndën e parë prej bimëve, është atraktiv si program i prodhimit të barërave që njerëzit i pranojnë me besim të plotë. Në bazë të këtij programi prodhohet preparati "bioknal" i destinuar për shërimin e lëkurës. Ky preparat ka qenë i ekspozuar në panairin e inovacioneve, në industrinë farmaceutike është i kërkueshëm, mund të gjejë plasman në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

Për realizimin e këtij programi nevojiten 250m² lokal, punëson 6 punëtorë, duhet siguruar kapitali prej 880.000€ që do të shpenzohej për lokal afërsisht 34%, për pajisje 63%, koha e aktivizimit të kapitalit për 4 deri 6 muaj, afati i kthimit të kapitalit për 3 vjet e 4 muaj, bruto fitimi vjetor 310.000€ raporti në 1€ investime 0,35 bruto fitim. Çmimi i një vendi të punës është 150.000€, kurse fitimi për një punëtor është 52.000€.

6. PROGRAMI I PRODHIMIT TË UJIT TË GAZUAR

Uji mineral prodhohet ashtu që uji natyror me presion kalon nëpër materie inorganike (bazalt, qeramikë) dhe ngopet me ajër.

Pajisja është nga pompa e cila e vë ujin në shtypje. Përdoret si ujë hidrogjenik i pastër në familje ose në prodhimin e ushqimit.

Teknologjia e prodhimit të ujit mineral sipas këtij programi është prezantuar në patentën evropian EP 421-563-A e cila teknologji mund t'i përshtatet kushteve të shumë shteteve në transformim.

Nevojiten 60m², punësohen 6 punëtorë, kapitali prej 22.000€, koha e aktivizimit të programit është 3 muaj, ndërsa kapitali kthehet brenda 2 vjetëve, bruto fitimi vjetor 17.000€, raporti në 1€ investime 0,74 bruto fitim.

Një vend i punës kushton 3.700€, kurse fitimi për një punëtorë është 2.800€.

Problemi ekologjik duhet të zgjidhet.

VI. PROGRAMI PËR FORMIMIN E BIZNESEVE BUJQËSORE NË KUADËR TË INDUSTRIISË, XEHETARISË DHE PYLLTARISË

KARAKTERISTIKAT DHE RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE TË VEPRIMTARISË BUJQËSORE ME KARAKTER INDUSTRIAL, XEHETAR DHE TË PYLLTARISË

1. PROGRAMI I PRODHIMIT TË KAÇAVE

Ekzistojnë disa lloje të kaçave që duhet të kultivohen dhe të rriten për nevoja prodhuese. Kaçat përmbajnë vitaminë “C” 30-60 herë më shumë se limoni dhe shërben për prodhimin e marmelladave, pijeve, përdoret në prodhimtarinë e keksëve etj.

Ekziston interesim i madh për eksport, kjo bimë mbinë edhe në terrenet kodrinore malore, mbinë edhe në vendet e thata me lartësi mbidetare deri në 1.200m. Frytin e jep pas dy vjetëve, kurse më së shumti jep fryte në vitin e katërt, 5 tonë për 1 ha, kurse në terrenet e mira deri në 15t për 1ha. Shfrytëzohet zakonisht deri në 20 vjet.

Nevojitet lokal afarist për 150m², mund të punësohen 5 punëtorë, deponohen 30.000€, bruto fitimi vjetor 50.000€. programi mund të aktivizohet brenda vitit, kapitali mund të kthehet për 2 vjet. Raporti në 1€ investime 1,95€ bruto fitim.

Një vend i punës kushton 6.000€, kurse fitimi për një punëtor është 10.000€.

2. PROGRAMI PËR KULTIVIMIN E ELBIT DHE SOJËS

Elbi dhe soja shfrytëzohen në industrinë ushqimore dhe farmaceutike, por mund të shërbejnë si lëndë e parë për punëtori të vogël shtëpiake lidhur me prodhimin e ushqimit të shëndetshëm, prodhimeve mjekuese dhe kozmetike.

Nevojitet gjysmë hektari tokë, mundësisht korrja bëhet dy herë në vit. Në vjeshtë mbillet elbi me fryte të larta i cili do të korr rreth në fund të qershorit dhe kështu menjëherë në të njëjtën tokë të mbjellën llojet e hershme të sojës që arrin kah fundi i tetorit. Ndërmarrësve elbi dhe soja nga ferma vetanake do t’u shërbej si lëndë e parë për prodhimin e ushqimit të shëndetshëm. Prodhimet mjekuese dhe kozmetike që sot janë shumë të kërkuara në treg.

Nevojitet gjysmë apo një hektar tokë, të punësohen një apo dy punëtorë, të angazhohet kapitali prej 1.000 apo 2.000€, si shpenzime për farë dhe për shërbimet e mekanizimit. Programi të realizohet brenda një viti, kurse kapitali të kthehet për 15 muaj, ndërsa bruto fitimi vjetor do të realizohet 4.000 gjegjësisht 8.000€, në raport 1€ investime 4€ bruto fitim.

3. PROGRAMI PËR KULTIVIMIN E BIMËVE MJEKUESE

Në kuadër të këtij si më të rëndësishme janë *prodhimi i kamilicës, mentës, kuminës, pelinit, valerianes, zhumbicës, mullages së bardhë, sherbelës dhe bimët tjera të mbjellura në një sipërfaqe 3.000 – 6.000m², por me kusht që të bëhet plasmani i tyre në treg. Duhet përcaktuar lokacionin e repartit për mbjelljen dhe terjen e këtyre bimëve. Teknologjia është e thjeshtë, kërkon mjete të vogla financiare, ndërsa kërkesa e këtyre bimëve në treg është e madhe sepse në natyrë këto bimë gjenden shumë pak. Duhet zhvilluar sistemin kooperativist, përpunimin vetanak, paketimin dhe kontraktimin me tregti.*

Për kultivimin e këtyre bimëve duhet siguruar gjysmë hektari ku do të punësohen një apo dy punëtorë, të angazhohet kapitali prej 1.000 apo 2.000€ për nevojat e pajisjes teknike, makina, pajime, farës, plehrave etj. Kapitali mund të kthehet për 14 muaj në shumë prej 5.000 apo 10.000€ bruto fitim. Raporti në 1€ investime është 5€.

4. PROGRAMI PËR RITJEN E ROSAVE

Ky program mund të jetë i bazuar në miniferme të rritjes së rosave prej 250 gjegjësisht 500 në një cikël optimal prej 2 muaj, 6 cikla vjetor me nga 250 gjegjësisht 500 rosa do të kemi 4.500 gjegjësisht 9.000kg mish. Mund të locohen në kuadër të biznesit familjar, të ketë vendin e konsumit 20 gjegjësisht 30km ku do të shitej mishi i rosës, plasmani i këtij mishi nuk është problem – preferohet që lokacioni të jetë me organizimin e mbledhjes së mishit për thertore ose të prodhuesve të përpunimit të mishit. *Në këtë sistem mund të formohen edhe ferma të vogla të zogjve, patateve, bibave, lepujve etj.* Për realizimi i këtij programi është i nevojshëm një objekt i thjeshtë dhe pajisje e thjeshtë. Ky është një program i përshtatshëm për çdo ekonomi të vogël me kusht që të ketë një afërsi dhe kushte tjera për sigurimin e ushqimit.

Për realizimin e këtij programi nevojiten 50m² gjegjësisht 100m², varësisht prej kapacitetit të miniferms, të punësohen 1 apo 2 punëtorë, të angazhohet kapitali prej 11.000 apo 22.000€ për objekt dhe pajisje ku do të sigurohej bruto fitimi prej 12.000 apo 24.000€ në raport 1€ investime 1,1€ bruto fitim.

Duhet kushtuar kujdes faktorit ekologjik.

5. PROGRAMI I BYROSË SË PROJEKTIMIT DHE KONSULTINGUT PËR FERMA TË VOGLA

Në tregun tonë organizimi i këtyre shërbimeve që do të projektonin dhe këshillonin prodhimin e ekonomive të vogla bujqësore. Nga ky aspekt është e dobishme që të realizohen programet e tilla. Formimi i firmave të specializuara për një veprimtari që kishte me ofrua shërbime të plota dhe cilësore si p.sh. shërbime për formimin dhe mbajtjen e dhive, projektimin e stallave, blerjen e bagëtive themelore, aftësimin e ndërmarrësve për udhëheqjen dhe realizimin e punëve në këto ferma deri te grumbullimi i qumështit dhe i mishit.

Lokacioni duhet caktuar afër prodhuesve. Duhet kushtuar kujdes sigurimit të kuadrove profesionale për aplikimin e teknologjive me përvoja profesionale shkencore të kësaj veprimtarie.

Nevojiten 40 apo 80m² në pronën e ndërmarrësit, ku do të punësoheshin 3 apo 6 punëtorë, të deponohet kapitali prej 5.000 apo 10.000€ për pajisje dhe mjete të xhiros, të sigurohet bruto fitimi vjetor prej 30.000€ apo 60.000€ në raport 1€ investime 6€ bruto fitim.

Kapitali mund të kthehet për 6 muaj, ndërsa projekti të aktivizohet për 4 muaj. Çmimi për një vend pune është 1.700€, kurse fitimi për një punëtor 5.000€ deri 10.000€.

6. PROGRAMI I BARNATORES BUJQËSORE

Në barnatoren bujqësore mund të gjendet çdo gjë që është e nevojshme për bujqësi: fara, rasadi, mjetet e ndryshme për mbrojtjen e bimëve dhe rritjen e rendimenteve, vegla të vogla dhe pajisje të punës por edhe mund të jepen këshilla për mbajtjen e tokës, zgjedhjen e sorteve, kultivimin e bimëve, aplikimin e masave agroteknike etj.

Kjo barnatore mund të jetë në viset ku është e zhvilluar bujqësia.

Sipërfaqja për realizimin e këtij programi mund të jetë 60 gjegjësisht 120m², të punësohen 3 gjegjësisht 6 punëtorë, të deponohen 32.000 gjegjësisht 64.000€ për pajisjen teknike të barnatores. Bruto fitimi vjetor do të ishte 66.000€ gjegjësisht 132.000€. Raporti në 1€ investime do të jetë 1,29€ bruto fitim.

Çmimi për një vend pune është 10.700€, kurse fitimi për një punëtor 22.000€.

7. PRODHIMI I FIDANEVE TË MOLLAVE

Me zgjedhjen e sortës së mirë dhe me aplikimin e masave agroteknike, nën kujdesin e përhershëm profesional mund të kultivohen fidanët e kësaj peme. Klima më e përshtatshme është mediterane, përdoret ½ ha tokë, që ka përmbajtje të mirë të pllëshmërisë.

Për realizimin e këtij programi nevojitet sigurimi i gjysmë apo një hektari tokë ku do të punësoheshin një apo dy punëtorë, ku do të angazhohej kapitali prej 19.000€ apo 38.000€, kryesisht për pajisje, ku bruto fitimi vjetor do të jetë 35.000€ gjegjësisht 70.000€. Raporti në 1€ investime është 1,64€ bruto fitim.

Programi aktivizohet për një vit, kurse kthimi i kapitalit bëhet me shitjen e gjysmës së fidaneve.

8. PROGRAMI I RRRITJES SË ZOGJVE NË INKUBATOR

Të gjitha shtazët të cilat dalin nga vezët mund të rriten në mënyrë të plotë artificiale në sasi të mëdha të pakufizuar ku nevojitet vetëm veja e mbarsur. Makina që e mundëson këtë quhet inkubator. Në këtë program prezantohet inkubatori për rritjen e zogjve në përputhje me nevojat e tregut konkret. Kapaciteti është 6.000 ve në turn. Kapaciteti i këtij inkubatori duhet të jetë afër qendrës konsumuese.

Për realizimin e këtij programi nevojiten 100-200m² sipërfaqe, të punësohen 3-6 punëtorë, të deponohet kapitali prej 64.000€ gjegjësisht 128.000€ që do të shpenzohej kryesisht për pajisje. Bruto fitimi vjetor është 66.000€ gjegjësisht 132.000€ në raport 1€ investime 0,94€ bruto fitim.

Çmimi për një vend pune është 21.000€ kurse fitimi për një punëtor është 22.000€.

9. PROGRAMI I PRODHIMIT TË AKULLIT

Ky program është mjaft atraktiv, nuk kërkon kapital të madh, duhet të ketë lokacionin afër tregut gjegjësisht në vendin ku shkarkohen prodhimet bujqësore që kërkojnë transport në kushte të ftohta. Lokacioni mund të jetë edhe afër vendeve urbane turistike. Programi mund të konceptohet për një ton apo dy tonë akull varësisht nga kërkesa në treg.

Për realizimin e këtij programi nevojitet sipërfaqe prej 20-40m² që mund të merret edhe me qira, të punësohen 2 apo 4 punëtorë. Nevojitet të deponohet kapitali prej 16.000€, gjegjësisht 32.000€ që do të shpenzohej për pajisje mbi 60%. Bruto fitimi vjetor 50.000€ gjegjësisht 100.000€ në raport 1€ investime 3€ bruto fitim.

Problemi ekologjik duhet zgjedhur.

10. PROGRAMI PËR PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE PREJ TALLËS SË MISRIT DHE KASHTËS

Në çdo shtëpi mund të gjenden produkte të prodhuara prej tallës së misrit dhe kashtës që mund të përdoren për shporta të bukës, shporta për rroba të palara, çanta, mbulesa për mure dhe dysheme.

Prodhimtaria është e thjeshtë te këto produkte, kashta dhe tala mund të ngjyrosen, kurse ngjyra duhet të zgjidhet në përputhje me origjinën gjeometrike të prodhimit. Nevojitet një sipërfaqe e vogël e lokalit që mund të shërbejë edhe për nevoja të tjera. Këtu mund të punësohen edhe njerëz me të meta fizike.

Përvojat për prodhimin e këtyre produkteve mund të arrihen me organizimin e kurseve disa mujore.

Duhet siguruar sipërfaqen prej 15-30m², të punësohen 1 apo 2 punëtorë, kapitali fillestar 2.000€ deri 4.000€, bruto fitimi vjetor 7.000 apo 14.000€. Raporti në 1€ investime 3,5€ bruto fitim. Kapitali kthehet për 6 muaj, ndërsa programi aktivizohet për 2 muaj.

Çmimi për një vend pune është 2.000€, kurse fitimi është 7.000€ për një punëtor.

11. PROGRAMI PËR NDËRTIMIN E MINIFERMAVE TË DHIVE

Me qëllim të zhvillimit të blegtorisë intensive veçanërisht në sektorin individual është e nevojshme të realizohet programi i ndërtimit të miniferms së dhive në disa qendra fshatare tek ne e veçanërisht në qendrat malore kodrinore.

Janë disa lloje të dhive që mund të mbahen siç janë ato të angorës, ruse, kavkaze, e vendit, ballkanike. Jeton deri 20 vjet, produktiviteti ekonomik 7-8 vjet.

Rëndësia më e madhe është sa i përket prodhimit të qumështit dhe mishit. Produktet tjera janë lëkura, qimet dhe plehu. Lëkura është e rëndësishme për përpunim të mëtejshëm (për veshmbathje, gëzof, prodhimet e galanterisë, konfeksion). Qimet gjejnë përdorim për punimin e brushave të ndryshme, tepihëve, torbave, mbulesave, si shtesë në tekstil që e bënë më kualitativ. Qumështi i dhisë përmban më shumë vitamina dhe minerale se sa qumështi i deles dhe i lopës dhe shërben si ushqim mjaft i mirë për fëmijë, të vjetër dhe për të sëmurë. Krahas kësaj mishi i edhit veçanërisht kushton shumë shtrenjtë. Dhia saksone dhe Angole mund të jep 700-800l qumësht, kurse mesatarisht jep 1,8 – 1,2 edha në vjet. Ajo e vendit jep 130l qumësht, kurse rregullisht në vit një edh. Peshon 30-40kg kurse cjapi 40-60kg.

Në kuadër të një miniferme mund të mbahen 100 copë dhi që përafërsisht mund të formohen 20 miniferma të tilla në vise të ndryshme tek ne.

Nevojitet një sipërfaqe prej 100m² gjegjësisht për 20 miniferma nevojiten 2.000m², të punësohen 5 punëtorë gjegjësisht 100 punëtorë, të deponohet kapitali prej 60.000€ për një miniferme. Bruto fitimi vjetor do të realizohet 30.000€. Raporti në 1€ investime 0,5€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 12.000€, kurse fitimi për një të punësuar 6.000€. Programi aktivizohet për 1 vit, kurse kapitali kthehet për 2 vjet.

VII. PROGRAMET PËR KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESEVE NË TREGTI

KARAKTERISTIKAT DHE RËNDËSIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË TREGTISË

Një pjesë e madhe e njerëzve mendojnë se është lehtë të merret me tregti, sepse blerja e llojeve të ndryshme të prodhimeve është pjesë e aktivitetit të përhershëm në praktikën e njeriut prej lindjes gjer në vdekje. Përgjigjja mund të jepet se nuk është lehtë të merresh me tregti, përndryshe të gjithë ndërmarrësit kishin me qenë të suksesshëm në tregti. Mjerisht kjo nuk duket kështu.

Tregtia i ka ligjet e veta që duhet të respektohen. Nuk kemi ndonjë model të gatshëm i cili garanton sukses në tregti. Ndërmarrësi i suksesshëm duhet përcjellur ndryshimet në treg duke ia përshtatur ofertën kërkesës dhe duke përcjellur konkurrencën.

Sot tregtia është tregues i rëndësishëm i zhvillimit të ndonjë ekonomie. Sa më e zhvilluar të jetë ekonomia, tregtia e ka pjesëmarrjen më të madhe. Pajisja e kapaciteteve tregtare me shumicë dhe pakicë të depove tregojnë nivelin e zhvillimit teknik të tregtisë. Në tregti duhet të ekzistojnë më së paku dy partnerë. Çdo njëri partner duhet të ketë ndonjë mall të vlefshëm për tjetrin. Partnerët duhet të jenë të aftë të komunikojnë dhe të porosisin mallin për shkëmbim. Partnerët duhet të jenë të lirë që të pranojnë apo jo ofertën. Çdo njëri partner duhet të ketë dëshirë që të bënë tregti me partnerin tjetër. Qarkullimi do të sigurohet nëse dy partnerët kanë arritur marrëveshje për kërkesat e tyre.

Tregun e përbëjnë të gjithë blerësit potencial që kanë nevojë për një mall apo shërbim dhe të cilët janë të gatshëm të hyjnë në shkëmbim me shitësin. Për çdo ndërmarrës tregtar duhet gjetur përgjigjet në pyetje se kush është blerës potencial, çka ata kërkojnë, çfarë asortimenti, ku të blejnë, se a janë të tregut të brendshëm apo të jashtëm, çfarë sasive të mallit duhet blerë, se a blenë përherë apo kohë pas kohe, çfarë çmimi të volitshëm duhet pranuar, kuptohet çmimi më i lirë, kualiteti më i lartë, asortimenti më i gjerë kanë përparësi. Nga ky aspekt ndërmarrësi tregtar duhet zgjedhur llojin dhe tipin e kapacitetit të shitjes, përcaktimit të teknologjisë së punës, organizimi i punës etj.

Lokacioni i mirë do të thotë mundësia e tërheqjes së numrit të madh të konsumuesve dhe afarizmit me çmime sa më të ulëta. Lokacioni i dobët do të thotë shitje më e vogël, kurse qëllimi i ndërmarrësit tregtar është që të shet sa më shumë me dallim të çmimit sa më të madh.

Ekzistojnë disa tipe të lokacionit për objektet e shitjes siç janë: lokacioni në qendër të qytetit, lokacioni sekondar me qendra tregtare, lokacioni në vendet qarkulluese të transportit, lokacioni në viset tregtare të afërsisë.

Ekzistojnë edhe lokacione të veçanta, qendra tregtare. Ndërmarrësi duhet të mendojë mirë, kur merr vendim për hapjen e lokalit tregtar. Mirëpo mos harroni se as lokacioni i mirë, asortimenti i gjerë, ekzistimi i tregut nuk do të shpëtojnë nga likuidimi nëse nuk disponohet me dituri të mjaftueshme në tregti, mendohet në punë profesionale, që disponojnë me njohuri për mallra që i shesin, por ato duhet të kenë mjeshtëri dhe gjeturi për shitje.

Ndërmarrësi tregtar has edhe në problem të hulumtimit se çka dhe kujt t'i shitet, pastaj duhet të dijë të udhëheqë librat tregtarë, t'i përcjellë ligjet dhe rregullat e punës në tregti, të ketë njohuri dhe dituri themelore për lidhjen e kontratave me furnizuesit dhe blerësit, duhet të dijë t'i shfrytëzojë shërbimet e huaja, t'i hartojë kalkulimet dhe t'i vlerësojë efektet e shitjes. Nëse nuk

dinë t'i bënë vetë duhet shfrytëzuar shërbimet e huaja specializtike sepse kjo është më e lirë në krahasim me gabimet që bëhen.

Në mes të shitësit dhe blerësit lindin edhe ndërmjetësuesit goftë si individ ose si institucion. Është me rëndësi edhe transporti përmes së cilit bëhet bartja e mallit prej prodhuesit gjer te konsumuesi. Nevojitet depo për ruajtjen e mallit, nevojiten qendra distributive për përpunimin e mirë, paketimin dhe përgatitjet tjera të shitjes së mallit që shkojnë me rastin e realizimit të mallit te konsumatori i fundit.

Objektet më kryesore të tregtisë janë shitoret, depot, mjetet transportuese. Shitoret janë lokale të rregulluara në mënyrë të veçantë në të cilën takohen blerësi dhe shitësi. Nga aspekti i sasisë së shërbimeve që ju ofrohen blerësve ato mund të jenë vetëshërbime, vetëzgjedhje, shërbime të kufizuara dhe shërbime të plota. Sipas llojeve të shitësve kemi objekte klasike, diskonte etj., ndërsa sipas gjerësisë së asortimentit të ofertës objekte të specializuara universale. Nga aspekti i madhësisë së lokalit shitës ato lokale mund të jenë të mëdha, të mesme dhe të vogla. Depot janë lokale me pajisje dhe stabilimente të veçanta të destinuara për vendosjen dhe ruajtjen e materialit, gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme. Ndahen në depo të mëdha, të mesme dhe të vogla. Mund të jenë kryesore dhe ndihmëse, të mbyllura dhe të hapëta, të mbuluara dhe të pambuluara.

Sipas specificitetit mund të jenë silose, frigoriferë etj. Mund të jenë të mekanizuara dhe të automatizuara, në shkallë të ulët të mekanizmit dhe në shkallë të lartë të mekanizmit dhe automatizimit të lartë të depove. Sipas veprimtarive ekonomike mund të jenë tregtare, industriale, transportuese. Karakteristikë e përbashkët e tyre është që të kryhet aktiviteti në pranimin, vendosjen, ruajtjen dhe daljen e materialit. Qendrat distributive janë objekte bashkëkohore në të cilat mblidhen, ruhen, punohen, përgatitet malli për distribuim të menjëhershëm deri te blerësi. Këto janë pjesë përbërëse të infrastrukturës tregtare, me njësi bashkëkohore, nivel të zhvillimit të lartë teknologjik me përbërje të tregtisë. Mjetet transportuese janë në madhësi të ndryshme me pajisje teknike dhe destinime. Mundësojnë transportin e mallit dhe në këtë mënyrë lidhin depot dhe njësitë shitëse në kuadër të tregtisë dhe i lidhin prodhimin dhe tregtinë.

Kemi mjete transportuese të transportit të brendshëm dhe të jashtëm. Në veprimtarinë tregtare ndikim të madh kanë ndryshimet në kërkesat që i kushtëzojnë ndryshimet në standardin e qytetarëve. Ndikojnë ndryshimet e strukturës së konsumit për arsye të lindjes së tendencave të reja në stilin e jetës. Ndikim të madh kanë edhe migracionet e popullatës në mes të viseve të ndryshme ose në kuadër të agromelacionit urban.

Duhet pasur kujdes edhe ndryshimet në shkallën e konkurrencës, në rritjen e shpenzimeve të afarizmit, rregullativat ligjore të tregtisë, të kushteve sanitare etj.

Kryesisht programet janë identifikuar në lëmin e tregtisë të shitjes me pakicë, nëpërmes formave të ndryshme të kësaj shitje siç janë shitoret, vetëshërbimet, shtëpitë e mallrave, depot e shitjes me pakicë, shitoret klasike, shitja me anë të automatit, shitja lëvizëse, depot e shitjes me shumicë, programet e ndryshme në shërbimet e ndërmjetësimit siç janë shitja komisionare, depot, vendshkarkimet, programet për kontrollin e kualitetit, kuantitetit, shpedicionit etj.

Prezantohet identifikimi i disa programeve sipas artikujve të shitjes siç janë shitja e produkteve ushqimore gjegjësisht bujqësore, tekstilit, lëkurës, këpucëve, teknikës së bardhë, elektroindustrisë, mobilieve, të industrisë kimike, kozmetikës, plehra artificiale, shitja në konsignacion, shitja përmes diskontit, shitja përmes kioskut, shitja e prodhimeve grafike, suvenireve, shitja e mallrave të vjetra, shitja e pajisjes sportive, mallit të përzier, naftës dhe benzinës etj.

Problemet e ambientit nuk janë të shprehura dhe mund të zgjidhen me pak investime.

Për identifikimin e këtyre programeve janë bërë analiza shkencore profesionale nga autori i këtij punimi, janë shfrytëzuar përvojat e institucioneve dhe individëve profesional shkencorë të publikuara dhe të papublikuara me qëllim që shumë ide të dobishme nga rezultatet e këtyre projekteve të shërbejnë si elemente përbërëse të programeve konkrete të identifikuar të vepimitarive tregtare në kushtet tona.

1. PROGRAMI I 5 SHITOREVE TË SPECIALIZUARA TË VESHJES

Në këto shitore asortimenti është kufizuar, shiten dorëza, kravata, kapela, sheshira, ndërresa në dimensione të ndryshme me dizajn të lartë, kualitet të mirë, veçmas shiten për të gjitha gjinitë shitet konfeksioni.

Për një shitore të tillë nevojiten 60m² gjegjësisht 300m² për 5 shitore, punësohen 5 punëtorë gjegjësisht 25 punëtorë, kapitali i deponuar 50.000€ gjegjësisht 250.000€, bruto fitimi vjetor 40.000€ gjegjësisht 200.000€. Raporti në 1€ investime 0,80€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 10.000€, kurse fitimi për një punëtor është 8.000€. Programi aktivizohet për gjashtë muaj, kurse kapitali kthehet për një vjet e gjysmë.

2. PROGRAMI PËR FORMIMIN E 3 SALLONEVE TË SHITJES SË VESHJES SOLEMNE

Në jetën e konsumuesve ka raste të shumta solemne në të cilat duhet veshur në mënyrë specifike, mirëpo në shumë raste nuk kemi artikuj për solemnitete, me rastin e festave dhe gëzimeve të ndryshme. Kështu që shpesh herë edhe nuk kemi kohë që t'i vizitojmë shitoret për blerjen e këtyre rrobave. Për këso raste duhet të ofrojmë rroba për nevoja të femrave, meshkujve, fëmijëve etj. Nga ky aspekt në sallonin e tillë konsumatorët mund të gjejnë atë që e kërkojnë.

Është e nevojshme që përveç sallonit të shitjes mund të formohet edhe punëtori për punimin e këtyre veshjeve.

Një sallon i tillë mund të formohet në çdo 100.000 banorë në ato mese ku është edhe standardi i lartë jetësor. Salloni duhet të lokohet afër vendeve tregtare ku frekuenca e blerësve është e madhe.

Për formimin e një salloni nevojiten 60m² gjegjësisht 180m² për 3 sallone të tilla, mund të punësohen 8 gjegjësisht 24 punëtorë, kapitali i deponuar 56.000€ gjegjësisht 168.000€, bruto fitimi vjetor 136.000€ gjegjësisht 408.000€. Raporti në 1€ investime është 2,34€ bruto fitim.

Programi aktivizohet për 6 muaj, kurse kapitali kthehet për 8 muaj. Çmimi i vendit të punës është 18.600€, kurse bruto fitimi për një punëtor 45.300€.

3. PROGRAMI I FORMIMIT TË QENDRAVE TREGTARE FSHATARE

Dallojmë tri lloje të qendrave tregtare: Qendra tregtare kryesore fshatare, qendra tregtare ndihmëse fshatare dhe qendra tregtare e vendbanimit të vogël fshatar.

Qendra tregtare e vendbanimit të vogël të komunës është qeli e modelit të qendrave tregtare të fshatrave dhe kjo formë do të duhej të jetë e përfaqësuar përherë. Thënë ndryshe qendra tregtare kryesore dhe ndihmës fshatare janë forma shumë më të zhvilluara të qendrave tregtare të vendbanimeve të vogla të komunave.

Qendra tregtare fshatare të vendbanimeve të vogla është për fshatin njësoj si dhe qendra tregtare e fqinjësisë për bashkësinë lokale të qytetit. Konsumatori dhe punonjësi në fshat duhet që në fqinjësinë më të afërt t'i përmbush të gjitha nevojat më të rëndësishme si konsumatorë dhe si shitës i prodhimeve bujqësore.

Qendra tregtare të vendbanimeve të vogla duhet formuar së paku në 2 deri 3 mijë banorë.

Për furnizimin e popullsisë me artikuj të konsumit person (funksioni i parë) shitoret fshatare mund të luajnë rol të rëndësishëm vetëm se nevojitet që të porositen më me kujdes asortimenti i mallrave që ofrohet. Tregtia ambulante do të duhej të bëhej “dorë e zgjatur” e qendrave tregtare të fshatrave deri në fshatrat më të larta.

Funksioni i dytë i qendrave tregtare të fshatrave është të punojnë në përparimin e prodhimit bujqësor dhe të furnizojnë fshatarët me pjesë rezervë dhe me material riprodhues. Do të ishte ideale sikur krahas shitoreve të përziera të konsumit personal të lindin edhe shitore të repromaterialit dhe të pjesëve rezervë përkatëse për bujqësinë e vendbanimit të caktuar fshatar. Stili ambulant i kryerjes së këtij funksioni të dytë gjithashtu duhet të zbatohet.

Në territoret ku është formuar rrjeta e tregtisë fshatare, në punktet e përcaktuara më parë do të mbledheshin edhe tepricat e produkteve bujqësore. Ky stil tani aplikohet në rastin e mbledhjes së tepricave të tregut të qumështit. Në sezonin e grumbullimit, do të mund të improvizohen qendrat grumbulluese edhe në shtëpi ose në pasurinë e ndonjë prodhuesi bujqësor. Rrjeti i qendrave tregtare fshatare mundëson që në një hapësirë të gjerë të aktivizohen kapacitetet prodhuese, e jo vetëm që të përmbushen nevojat e konsumatorëve.

Në kushtet e disa fshatrave tona të zhvilluara qendra tregtare fshatare do të përfshinte ndërtimin e vetëshërbimit dhe 4 objekteve të specializuara.

Për realizimin e një qendre të tillë nevojiten 200m² për një vetëshërbim dhe nga 50m² për katër shitore gjegjësisht 200m², ku punësohen nga 4 vetë, kapitali i njëjtë. Në një qendër të tillë punësohen 36 punëtorë, deponohet kapitali prej 390.000€, me bruto fitim prej 300.000€. Raporti në 1€ investime është 0,75€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 10.800€, kurse fitimi për një punëtor është 8.300€.

Tek ne ekzistojnë mundësitë në bazë të nivelit të zhvillimit të disa fshatrave tona që më së paku të formohen 100 qendra të tilla fshatare. Për 100 qendra të tilla nevojiten 40.000m², mund të punësohen 3.600 punëtorë, kapitali i deponuar 3.900.000€, bruto fitimi vjetor 30.000.000€.

Programi aktivizohet brenda një viti, kurse kapitali i deponuar kthehet për një vit e gjysmë.

Qendrat tregtare ndihmëse dhe të vendbanimeve të vogla mund të formohen në lokalitet ku banojnë 1.000 deri 1.500 banorë, që është në një numër bukur të madh të fshatrave tona.

Në kuadër të këtyre qendrave duhet të ketë 5 deri në 8 shitore të cilat do të shërbejnë për plotësimin e nevojave të përditshme të konsumatorëve me të gjitha llojet e mallit tregtar dhe atë ushqimor, jo ushqimor, shitoret e specializuara, shitore të përziera etj.

Për ndërtimin e një shitoreje do të nevojiten përafërsisht 50m², ku do të punësoheshin 4 punëtorë me angazhim të një kapitali prej 60.000€ me bruto fitim vjetor prej 40.000€. Raporti në 1€ investime është 0,6€ bruto fitim.

Në një fshat një qendër e tillë tregtare do të ketë më së paku 5 shitore gjegjësisht 250m², në çdo shitore do të punësohen nga 4 vetë gjegjësisht 20 punëtorë, të sigurohet kapitali në shumë prej 300.000€, dhe bruto fitimi vjetor 200.000€. Çmimi i një vendi të punës është 15.000€, kurse fitimi për një punëtor 10.000€.

Programi aktivizohet për një vjet e gjysmë, kurse kapitali i deponuar kthehet gjithashtu për 1 vjet e gjysmë.

Në trevën tonë mund të formohen 200 qendra të tilla për të cilët nevojitet sipërfaqja prej 50.000m², të punësohen 4.000 punëtorë, të deponohet kapitali prej 60.000.000€, bruto fitimi vjetor 40.000.000€.

4. PROGRAMI PËR FORMIMIN E SHITOREVE LËVIZËSE (SHITJA AMBULANTE)

Shitja në kuadër të këtyre shitoreve realizohet përmes aparateve dhe pajimeve speciale të motorizuara (kamionë, autobusë, anije, automobil). Në këtë mënyrë tregtia me pakicë i ofrohet konsumit në vendet e largëta duke ia ofruar mallin. Mënyra më e vjetër e tregtisë ka qenë lëvizëse-udhëtuese ose tregtia nomade. Mirëpo gjatë kohës është modernizuar edhe njihet si tregti ambulante.

Ambulantë tregtare duhet të jetë e nivelit të lartë të organizimit bashkëkohor dhe disponojë me teknikë adekuate të shitjes dhe të distribuimit me pakicë. Në kushtet tona këto shitore mund të kenë më së paku 50 shitore.

Për një shitore të tillë nevojitet lokali minimal 5m², varësisht se me çfarë mjeti transportues realizohet kjo shitje. Duhet deponuar kapitalin afër 30.000€, të punësohen afër 4 punëtorë, bruto fitimi vjetor të jetë 45.000€. Raporti në 1€ investime është 1,5€ bruto fitim.

Për 50 shitore të tilla nevojiten 250m², punësohen 200 punëtorë, kapitali i deponuar 1.500.000€, kurse bruto fitimi vjetor 2.250.000€. Çmimi i një vendi të punës është 7.500€, kurse fitimi për një punëtor 19.000€. Programi aktivizohet për 6 muaj, kurse kapitali kthehet brenda vitit.

VIII. PROGRAMET E ZHVILLIMIT TË BIZNESIT ZEJTAR

KARAKTERISTIKAT DHE RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË BIZNESIT ZEJTAR

Në kuadër të prodhimitarisë zejtare prodhohen artikuj të ndryshëm të konsumit të gjerë që shërbejnë për plotësimin e nevojave të konsumuesve me kualitet të lartë, shije dhe me karakteristika specifike të cilat nuk do të mund të prodhoheshin në industri.

Edhe pse industria është duke u zhvilluar me të madhe, prodhimet zejtare nuk e kanë humbur rëndësinë dhe karakterin e vet. Në të vërtetë ka disa zeje shtëpiake që janë shuar, mirëpo gjithnjë kanë lindur zeje të reja në përputhje me kërkesat e tregut.

Zejtaria është veprimtari e rëndësishme ekonomike, perspektiva e saj është në prodhimin e serive të vogla ose unikate, të produkteve atraktive dhe profitabile, për të cilat prodhime prodhimtaria industriale nuk ka interes të veçantë, e këto janë degët metalo-përpunuese, industria përpunuese e drurit, ndërtimtaria ndërtimore, tekstili, lëkura etj. Tek ne në një kohë të gjatë ka traditë të veçantë me shumë elemente regjionale të cilat janë të ruajtura në zhvillimin e saj deri më tani.

Zejtarinë e kryejnë kryesisht personat fizik përmes punëtorive të veta, por edhe personat juridik përmes ndërmarrjeve, kooperativave etj.

Punësojnë kryesisht anëtarë të familjes por edhe anëtarë jashtë familjes. Pronarë janë kryesisht zejtarrët, mjeshtër të mirë që punojnë, por edhe mjeshtër të tjerë, nxënës në ekonomi me qëllim që të përgatiten zejtarrët për realizimin e qëllimeve praktike.

Nëpërmes kësaj veprimtarie punësohen komercialistë, aktivizer, kontabilistë, punëtorë profesional shkencorë etj.

Hapjen e dyqaneve zejtare kryesisht e bëjnë pronarët e lokaleve, zejtarë profesionist me kualifikime adekuate, të regjistruar në organe kompetente duke kryer veprimtari sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Veprimtarinë zejtare e kryejnë edhe punëtorë të tjerë në kuadër të ndërmarrjeve zejtare në përputhje me kërkesat dhe nevojat e zhvillimit të tyre.

Zejtari mund të ketë edhe beneficione të tjera të ndryshme të politikës doganore, kreditore etj.

Programet e prezantuara në këtë punim janë nga lëmenjtë e ndryshëm të prodhimitarisë zejtare dhe prodhimitarisë shërbyese.

Programet e prezantuara në këtë punim janë nga lëmenjtë e ndryshëm të prodhimitarisë zejtare dhe prodhimitarisë shërbyese.

Realizimi i prodhimitarisë së këtyre programeve kryhet në mënyrë gjysmë industriale, kryesisht me pjesëmarrje të punës së dorës.

Për kryerjen e veprimtarisë zejtare është me rëndësi aftësia profesionale e kuadrove me përvojë dhe mjeshhtëri adekuate si të vetë zejtarit ashtu edhe të punëtorëve të tjerë.

Prodhimet e këtyre programeve kryesisht u dedikohen lëmit të konsumit personal dhe konsumit prodhues në faza të ndryshme industriale.

Prodhimet zejtare realizohen në seri të vogla dhe sipas porosisë që do të thotë për blerës të njohur që do të thotë produkte që mund të konsumohen relativisht në kushtet e standardit të lartë ose për një pjesë të tregut që janë të interesuar prodhuesit industrial.

Çmimet e prodhimeve zejtare janë më të larta se sa ato industriale, duke pasur parasysh punën e dorës dhe atë kreative me kualitet të lartë, dizajn atraktiv dhe vetive dhe përparësive tjera konkurruese.

Prodhimet e këtyre programeve kryesisht mund të plasohen në tregun lokal apo regional, afër vendit ku është ndërtuar punësitoria zejtare, por ka edhe prodhime zejtare që duhet zhvilluar aktivitetet e marketingut me qëllim që të plasohen në treg më të gjerë si në vend ashtu edhe jashtë.

Zejtarët vetë i shesin produktet konsumues, mirëpo mund t'i shesin edhe përmes rrjetit tregtar.

Programet e propozuara zejtare kërkojnë një numër më të vogël të punëtorëve me shkollim të veçantë dhe veprimtari kreative dhe me një pjesëmarrje të dukshme të kuadrove jo prodhuese.

Programet e propozuara zejtare kërkojnë investime më të vogla në krahasim me vendet e punës në industri. Duhet theksuar veçanërisht nevojën e sigurimit të veglave, makinave, lëndës së parë dhe elementeve tjera materiale për realizimin e këtyre programeve. Nga ky aspekt është e nevojshme që zejtarët dhe punëtorët tjerë që orientohen në realizimin e këtyre programeve të bëjnë me kujdes zgjedhjen e tyre duke analizuar në mënyrë të detajuar, të gjithë faktorët që kushtëzojnë realizimin e këtyre programeve. Duhet theksuar se një numër i madh i këtyre programeve mund të realizohet në bazë të lokaleve ekzistuese ose në bazë të adaptimit të tyre, në bazë të bashkimit të mjeteve me partnerë të jashtëm.

Veprimtaria zejtare në realizimin e këtyre programeve mund të organizohet në kuadër të industrisë, në degë të ndryshme të saj qoftë përmes prodhimit të veglave të ndryshme, aparateve, lëndës së parë dhe mjeteve të tjera, qoftë përmes mirëmbajtjes së veglave të punës, remontit etj.

Nga ky aspekt duhet të ekzistojë një lidhje e ngushtë në mes të industrisë dhe zejtarisë. Kështu që një pjesë e produkteve dhe pjesëve rezervë që prodhohen në industri të prodhohen në zeytari. Në bazë të kësaj lidhjeje dhe bashkëpunimi afarist në mes të këtyre dy veprimtarive mund të identifikohen dhe të realizohen një numër i dukshëm i programeve për punësim.

Programet zejtare të punësimit mund të zhvillohen edhe në veprimtaritë bujqësore, qoftë në mirëmbajtjen e teknikës ose prodhimin e veglave të ndryshme që shërbejnë në bujqësi.

Prodhimet dhe shërbimet zejtare mund të gjejnë aplikim edhe në ndërtimtari, sidomos në prodhimin e shumë produkteve që mund të kompozohen në produkte të ndërtimtarisë, si dyer, dritare unike me karakter ndërtimor, përpunimi i mbeturinave nga xehet minerale që mund të kompozohen në prodhimet ndërtimore.

Gjithashtu edhe në kuadër të komunikacionit mund të aplikohen prodhimet dhe shërbimet zejtare sidomos në mirëmbajtjen e mjeteve transportuese dhe aktivitete të tjera.

Zejtaria prodhon një numër të produkteve dhe kryen shërbime që përdoren në konsumin e gjerë e sidomos aso produktesh nga dega e tekstilit, lëkurës, drurit përpunues, industrisë kimike, industrisë grafike, të letrës etj.

Në kuadër të këtyre degëve industriale është e mundur të zhvillohet dhe masivizohet prodhimtaria zejtare. Në bazë të punës zejtare mund të përpunohen shumë produkte bujqësore, pemëtaria, blegtoria, prodhimi i bulmetit, qumështit, mishit e shumë e shumë produkte të tjera të industrisë ushqimore.

Roli i programeve prodhuese zejtare qëndron në ndikimin e tyre në shfrytëzimin e lëndëve të para lokale, të vjetra të cilat më parë janë përdorë si material apo më mirë të themi të mbeturinave industriale.

Produktet dhe shërbimet në kuadër të prodhimeve zejtare mund të gjejnë aplikim në fshat dhe banorëve të qytetit dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në zvogëlimin e tendencave të migrimit të popullsisë.

Rëndësi të veçantë kanë zejet shtëpiake me karakter dekorues, kreativ, sidomos punët e argjendarisë, punët e qeramikës, prodhimi i tavolinave dhe inventarit të tjerë stolisës. Produktet e tilla mund të jenë atraktive në tregun e jashtëm dhe për turistët e brendshëm duke pasur parasysh që përveç këtyre produkteve prezantohet tradita, kultura dhe specifikat e viseve të ndryshme.

Me rastin e propozimit të programeve të lëmit të shërbimeve zejtare kemi pasur parasysh resurset materiale kadrovike, nevojat e tregut, nivelin e organizimit dhe faktorë të tjerë.

Në kuadër të programeve dhe shërbimeve personale zejtare mund të zhvillohen 35 shërbime siç janë artarët, rrobaqepësit, këpucëtarët, ndreqja e çadrave, ndreqja e stilografëve, instrumenteve të ndryshme muzikore, syzave, fotografive, frizerët, kozmetikës, pastrimi i rrobave etj.

Me rëndësi janë programet në lëmin e shërbimeve në pastrimin kimik dhe larjen e rrobave, fshirja e rrobave të lëkurës, ngjyrosja, hekurosja e rrobave etj.

Janë të rëndësishme edhe shërbimet në riparimin e aparateve elektrike, shërbimeve precize mekanike, servisimi i automobilave dhe makinave bujqësore etj.

Shërbimet në lëmin e ndërtimtarisë janë me rëndësi të veçantë nga të cilat mund të identifikohen edhe realizohen programe të shumta për mirëmbajtjen e banesave, elektroinstalimet, ndërtimi i ndërtesave, ngjitja e xhamave, tavolinave që përdoren në ndërtimtari, shërbimet dekorative, ngjitja e tapetave, parketit, ndërtimi i bunarëve, instalimi i nxehjes qendrore, shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit, rregullimi i kulmeve, rregullimi i mureve të fasadës, rregullimi i kalldërmave etj. Duhet kushtuar kujdes edhe shërbimeve të tjera zejtare, fotografimit në porcelan, galvanizimit, prodhimi dhe ndreqja e mullinjve të kafes, punët farkëtare, të shkrirjes, zdrukthëtarisë, punët metalo-përpunuese, punët mekanike, ndreqja e biçikletave, prerja e drunjte, punimi i jorganëve me dorë, qëndisja, punimi i goblenëve, punimet e pjekjes së llojeve të ndryshme të bukës, ëmbëlsirave, ngjyrosjes, shkrimit të firmave, pastrimit të lokalit, rregullimit të vitrinave etj.

Programet e shërbimeve zeytare te ne mund të identifkohen dhe realizohen në më se 150 veprimtari, dhe atë 25% në shërbimet personale, 20% në shërbimet ndërtimore, 8% në mirëmbajtjen e aparateve elektrike, 6% në shërbimet precize mekanike, 5% në servisimin e automjeteve transportuese dhe bujqësore dhe 30% në shërbimet tjera zeytare etj.

Meqenëse zeytaria nuk është e zhvilluar në mënyrë proporcionale në qendrat komunale dhe qytete, identifikimi i programeve zeytare mund të jetë i rëndësishëm për lokimin e këtyre programeve në viset e ndryshme tek ne.

Duhet iniciuar zhvillimin e zeytarisë kryesisht private me qëllim të punësimit të numrit sa më të madh të punëtorëve në këtë veprimtari.

Në kuadër të ndërmarrjeve dhe punëtorive private duhet aplikuar organizimin bashkëkohor me qëllim të shfrytëzimit të lokalit ekzistues, pajisjeve, teknike, të aftësohen kuadrot, të aplikohen dhe të përsosjen teknologjitë e reja etj.

Problemet e ambientit nuk janë aq të shprehura dhe mund të zgjidhen me pak investime, por përkundrazi realizimi i disa prej këtyre programeve janë të orientuara në rregullimin e ambientit.

Në bazë të analizave profesionale shkencore me rastin e identifikimit të këtyre programeve janë përcaktuar edhe norma adekuate të ndërtimit të lokaleve afariste që për formimin e një servili do të nevojiten 100m², mund të punësohen 15 punëtorë kurse për një punëtor mund të shërbejnë 30m². Te shërbimet personale për një punëtor mund të nevojiten përafërsisht 10m², te shërbimet për pastrimin kimik të rrobave 12m², te ndreqja dhe mirëmbajtja e pajisjes teknike dhe te shërbimet mekanike precize 8m², te servilet e mjeteve transportuese dhe makinave bujqësore 20m², kurse te shërbimet ndërtimore dhe mirëmbajtja e banesave 5m², te shërbimet tjera 7m².

Programet e identifikuar në kuadër të zeytarisë të prezantuara në këtë punim në bazë të disa elementeve karakteristike duken kështu: programi i punësimit në veprimtaritë zeytare të automobilistikes, programi zeytar në përpunimin e plastikës, programi zeytar për përpunimin e qeramikës, gurit, kristalit dhe qelqit, programi zeytar për përpunimin e vulave, emblemave, shenjave ngjitëse, çelësave, programi për prodhimin e veglave ndihmëse ortopedike, programi për prodhimin e kurorave funerale, programi për prodhimin e shportave me thurje të thuprave, përpunimi i mbeturinave të plastikës-prodhimi i granulatave, prodhimi i pullave dhe kapëseve metalike, prodhimi i valixheve, prodhimi i kapakëve filetorë, prodhimi i zink shiritave, prodhimi i folive nga plumbi, prodhimi i pllakave të shtypura, prodhimi i stabilimenteve, shputëzave dhe pjesëve për nivelizim për konfeksion, prodhimi i bulonave për dru, thumbave dhe boshteve të tjera të plotë dhe të zbrazët, prodhimi i blloqeve të qelqta zbukuruese, prodhimi i elementeve shtrënguese të linjave me rrymë të lartë, prodhimi i rrjetave të thurura në bazë të telit të aluminit, prodhimi i lidhëseve për shirita në transportimin horizontal për bartjen e zhavorrit dhe gurëve të imët, rërës, prodhimi i verigave për ndërtimtari dhe orendi, prodhimtaria e plumbit sekondar, programi i prodhimit të lëndëve të para sekondare, programi prodhues – shërbimet ndërtimore-zeytare për mirëmbajtjen e banesave, programi prodhues – shërbimet elektroinstaluese për mirëmbajtjen e banesave, programi prodhues – shërbimet e instalimit të ujit për mirëmbajtjen e banesave, servisi universal për kryerjen e shërbimeve në mirëmbajtjen e banesave, prodhimi i furrave për djegien e mbeturinave, programi për themelimin e kooperativës zeytare të autotransportuesve, servisi për mekanizmin bujqësor, programi për eksploatimin e gurit gëlqeror, programi për përpunimin e punëtorisë metalopërpunuese, programi për prodhimin e mullinjve të dorës për bluarjen e mishit, kafes, pemëve, perimeve, programi për përfitimin e vajit elektrik, programi i prodhimit të enëve nga qeramika dhe argjila, programi i prodhimit të elementeve nga qeramika, programi i prodhimit të gjilpërave dhe produkteve të ngjashme, programi i prodhimtarisë së galanterisë metalike, programi i punëtorisë për elementet lidhëse

metalopërpunuese që do të përdroreshin në xehetari, programi i prodhimit të shkrepave prej druri, programi i prodhimit të galanterisë së letrës, programi i prodhimit të pajisjeve ndihmës, inventarit dhe veglave tjera për spital, programi i ndërtimit të vijës termoizoluese, programi për prodhimin e produkteve nga metali, programi i prodhimeve nga llamarinat, programi për formimin e punëtorisë së farkëtarisë, programi për përpunimin e brushave të metalit, programi për mbështjelljen e elektromotorëve, programi i formimit të kooperativave zejtare, programi i formimit të servisit për mirëmbajtjen e makinave të renda në xehetari, në ndërtimtari etj., programi i repartit për mbrojtjen sipërfaqësore, programi i formimit të servisit të shërbimeve daktilografike, programi i formimit të laboratorit për zhvillimin dhe aplikimin e inovacioneve tekniko-teknologjike, programi për organizimin e servileve, remontit reparaturës si mjete transportuese dhe mekanizmit, programi për grumbullimin, klasifikimin dhe shpërndarjen e mbeturinave, programi i prodhimit të hallkave, programi i punëtorisë për ndërtimin e mjeteve piroteknike, programi i punësimit në bazë të përpunimit të letrës, programi i prodhimit nga llojet e ndryshme të letrës, programi i punësimit në lëmin e artizanatit shtëpiak në bazë të prodhimit nga druri, programi i punësimit në lëmin e artizanaleve shtëpiake në bazë të prodhimeve nga metali etj.

Ekzistojnë disa zeje atraktive që mundësojnë shtimin e punësimit me çmime të lira dhe rentabilitet të lartë. Programet mund të identifikohen në lëmin e zejes prodhuese dhe shërbyese.

Në kuadër të zejeve prodhuese janë të rëndësishme programet e zejes prodhuese në ndërtimtari, në industrinë e tekstilit, të gomës, të lëkurës, të plastikës, të industrisë së drurit, përpunimit të metaleve, përpunimit të arit, të argjendit, zejeve shërbyese në mirëmbajtjen e teknikës së bardhë, ujësjellësit, kanalizimit, autoserviseve të automobilave, prodhimi i veglave të ndryshme, përpunimi i qeramikës, përpunimi i gurit, përpunimi i mbeturinave të xhamit, libërlidhësit, hartimi i vulave, prodhimi i kristaleve, letrës etj.

1. PROGRAMI ZEJTAR PËR PËRPUNIMIN E VULAVE, EMBLEMAVE, SHENJAVE NGJITËSE TË ÇELËSAVE

Për produktet e këtij programi te ne ndihet nevoja sidomos kur kemi parasysh zhvillimin e shpejtë të ndërmarrjeve dhe punëtorive private të cilat kanë nevojë për vula, për emblema të ndryshme, për çelësa për mbylljen e lokaleve afariste dhe banesave, shtëpive, automobilave etj. Këto produkte janë atraktive. Ë qendër urbanistike si në qytet ashtu edhe në fshatra të mëdha mund të konsumohen. Sigurimi i lëndës së parë për prodhimin e këtyre produkteve nuk është problem, këto mund të prodhohen nga mbeturinat e plastikës, hekurit etj. Mund të përdoren makina të thjeshta që nuk kushtojnë shtrenjtë, të jenë universale apo të specializuara. Veprimtaria zejtare mund të kryhet në lokalitete e banimit apo punëtorinë e marrë me qira apo të ndërtuar. Duhet kushtuar kujdes asortimentit të këtyre prodhimeve por njëkohësisht edhe dizajnit. Në prodhimin përfundimtar të këtyre produkteve mund të kompozohen edhe prodhime të tjera siç janë futrollat, vjegcetet etj. Në këto prodhime mund të vihen shenja të karakterit reklamues propagandistik qoftë të firmës së prodhuesit apo ndonjë firme tjetër nëse produktet janë unike dhe shërbejnë për nevojat e konsumuesve etj.

Realizimi i programit të këtyre prodhimeve zejtare nuk prish ambientin dhe shpenzimet për rregullimin e ambientit janë më të vogla.

Për realizimin e këtij programi nevojitet sipërfaqe prej 110m², ku do të punësohen 14 punëtorë, ku do të angazhohej kapitali prej 138.000€, e do të realizohej bruto fitimi vjetor prej 158.000€. Raporti në 1€ investime është 1,9€ bruto fitim.

Afati i aktivizimit të programit është 3 muaj kurse afati i kthimit të kapitalit të deponuar është 6 muaj deri në 3 vjet.

Çmimi i një vendi të punës është 9.800€, kurse fitimi për një punëtor është 11.200€.

Në kuadër të këtij programi mund të formohen punëtori zejtarë të veçanta varësisht nga nevojat e tregut, profesionet e zejtarëve, sigurimi i kapitalit të lokalit afarist etj.

Nëse zejtarët janë të orientuar për zeje të veçanta të këtyre produkteve për shembull për prodhimin e çelësave veprimtaria mund të filloj edhe me sigurimin e sipërfaqes prej 15m² me një kapital prej 15.000€, ku mund të punësohen 4 punëtorë që do të ishin anëtarë të familjes ose shembulli tjetër te prodhimi i vulave të sigurohen vetëm 30m² me kapital prej 51.000€, të punësohen 3 punëtorë ose te prodhimi i emblemave të sigurohen 10m² të punësohen 2 punëtorë dhe të sigurohet kapitali prej 3.000€. Këtu duhet pasur parasysh që të mos dyfishohen kapacitetet, të hulumtohet tregu në mënyrë që të mos kemi ofertën më të madhe se sa kërkesën për këto produkte.

Sidomos realizimi i këtij programi te ne ka rëndësi të madhe meqë në këtë program mund të punësohen 14 punëtorë e meqë mund të jetë atraktive në qendra si qytete dhe fshatra mund të rritet numri i punëtorëve.

2. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E VEGLAVE NDIHMËSE ORTOPEDIKE

Në kuadër të këtij programi për prodhimin e veglave ortopedike ndihmëse do të organizohet prodhimtaria e këtyre veglave:

Karrocat ortopedike dhe patericar, karroca për të sëmurit, tavolina, shtretër për të sëmurit etj.

Për realizimin e këtij programi nevojitet lokali afarist prej 300m². Pajisja është kryesisht e vendit, lëkura me dimensione të ndryshme, gypat e ndryshëm nga çeliku, druri dhe të tjera mund të gjinden në rrjetin tregtar. Numri i të punësuarve është 40 punëtorë të rinj.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të sigurohet kapitali në shumë prej 300.000€ që do të shpenzohej kryesisht për lokal afarist dhe pajisje teknike, bruto fitimi vjetor mund të jetë 280.000€, kurse raporti në 1€ është 0,9€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 7.500€, kurse fitimi për një punëtor është 7.000€. programi aktivizohet për 6 muaj deri në një vit.

3. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E KURORAVE FUNERALE

Lënda e parë për prodhimin e kurorave është rrushkulli, ngjyra e nilinit, thupra për prodhimin e kornizave, teli dhe plastika.

Me kapacitet prodhues mund të punohen deri në 1.800 copë kurora të dimensioneve të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme të aranzhimit.

Teknologjia e prodhimit të kurorave përfshin këto faza:

- Prodhimi dhe përgatitja e luleve të plastikës dhe elementeve të tjera nga plastika.
- Prodhimi i luleve bëhet me makina gjysmë automatike.
- Përgatitja e thuprave dhe punimi i kornizave.
- Veshja e kornizave me kurora në rrushkull.
- Ngjyrosja e kurorave dhe
- Aranzhimi i kurorave.

Reparti prodhues për prodhimin e kurorave përfshin:

- Vijën për prodhimin e luleve 10m².

- Vijën për finalizimin e kurorave 80m².
- Vijën për ngjyrosjen e kurorave 10m².

Sipërfaqja e nevojshme gjithsej 100m².

Përveç këtij objekti duhet të sigurohet platoja me strehë me një sipërfaqe prej 50m² për magazinimin e rrushkullit.

Pajisja përfshin dy makina gjysmë automatike për plastikë, njëmbëdhjetë kallëpe, kazan për ngjyrosje dhe vegla të nevojshme (darët, gërshërët etj.).

Mund të punësohen 13 punëtorë, prej të cilëve 50% me kualifikim të lartë dhe të kualifikuar.

Prodhimtaria e planifikuar prej 1.800 copë kurora nuk do të çrregullonte dukshëm raportin në mes të ofertës dhe kërkesës në treg.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të angazhohet kapitali prej 65.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 70.000€. Raporti në 1€ investime është 1,07€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 5.000€, kurse fitimi për një punëtor 5.400€.

Programi aktivizohet për 6 muaj, kurse kapitali i deponuar kthehet brenda vitit.

4. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E SHPORTAVE ME THURRJE TË THUPRAVE

Rëndësia e programit qëndron në atë se tërë prodhimi mund të eksportohet, lënda e parë është nga vendi, mundësia e inkuadrimin të numrit të pakufizuar të fuqisë punëtore të pakualifikuar (meshkuj, femra, fëmijë, pleq).

Vëllimi i prodhimitarisë varet nga numri i kooperuesve të angazhuar, me këtë rast numri minimal i kooperuesve duhet të jetë 100. punohet 8 muaj dhe atë prej shtatorit deri në prill.

Mund të punësohen 10 punëtorë të përhershëm (drejtoria dhe regjia) dhe 100 kooperues nga fshatrat në rrethinë.

Nevojitet sipërfaqja e mbuluar prej 100m² (drejtoria dhe pjesa për finalizimin dhe magazinimin e thuprave të njoma, përgatitjen, zierjen dhe qërimin e thuprave).

Nevojiten dy makina për qërimin e thuprave.

Për 25 vjet tërë prodhimtaria eksportohet në tregun konvertibil (shportat, shportëzat, mobiliet e thurura).

Për realizimin e këtij programi nevojitet të angazhohet kapitali në shumë prej 25.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 35.000€, kurse raporti në 1€ investime 1,5€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 2.500€, kurse fitimi për një punëtor është 3.500€.

Programi aktivizohet për 6 muaj, kurse kapitali i deponuar kthehet brenda vitit.

Problemi ekologjik i ngjashëm si te programet tjera.

5. PROGRAMI I PËRPUNIMIT TË MBETURINAVE TË PLASTIKËS – PRODHIMI I GRANULATEVE

Programi prodhues i granulateve nga llojet e ndryshme të lëndës së parë sekondare të plastikës (poliamidet, polietilenet, polimetilmetn akrilatet, polipropilenit).

Kapaciteti 3.000 tonë granulat në vit.

Objektet ndërtimore të tipit montazhi në sipërfaqe prej 550m².

Prej pajisjeve nevojiten gërshërët sferike, transportieri, dhënësi elektrik, mulliri goditës me prerje transporti pneumatik, silosi mesatar etj.

Për pajisje heqin 80% të vlerës së përgjithshme.

Punësohen 46 punëtorë me strukturë kualifikuese dhe profil përkatës.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të sigurohet kapitali prej 184.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 200.000€, raporti në 1€ investim është 1,1€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 4.000€, kurse fitimi për një punëtor është 4.350€.

Programi aktivizohet për 6 muaj, kurse kapitali i deponuar kthehet brenda vitit.

Problemi ekologjik si te programet tjera.

6. PROGRAMI I PRODHIMIT TË PULLAVE DHE KAPËSEVE METALIKE

Me këtë program parashihet prodhimi i pullave metalike, kapëseve dhe nitoneve për xhins dhe rroba ushtarake dhe kalem për industri të tekstilit.

Kapaciteti është 7.000.000 copë pulla dhe kapëse. Objekti ndërtimor në sipërfaqe prej 400m², prej pajisjeve duhen presa e shpejtuar, automati me vegla, makina për montimin e pullave, automat makina për prodhimin e pullave, veglave etj.

Mund të punësohen 21 punëtorë me strukturë kualifikuese përkatëse.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të sigurohet kapitali në shumë prej 63.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 60.000€, raporti në 1€ investime 1,0€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 3.000€, kurse fitimi për një punëtor është 3.000€.

Programi aktivizohet për një vjet e gjithashtu edhe kapitali i deponuar kthehet brenda vitit.

Problemi ekologjik si te programet tjera.

7. PROGRAMI I PRODHIMIT TË VALIXHEVE

Në kuadër të këtij programi prodhohen valixhet e tipit “samsonite”, “delsey” dhe të ngjashme për bagazh personal, kryerja e punëve administrative mandej prodhimi i valixheve speciale për mjekësi dhe paketimi i veglave.

Kapaciteti 15.000 copë në vit, sipërfaqja e nevojshme prej 500 m².

Prej pajisjeve nevojiten lakueset, shpueset, frezet, aparatet, veglat etj.

Mund të punësohen 15 punëtorë.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të sigurohet kapitali në shumë prej 60.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 75.000€, kurse raporti në 1€ investime është 1,25 bruto fitim.

Programi aktivizohet për një vjet, kurse kapitali i deponuar kthehet brenda një viti.

Çmimi i një vendi të punës është 4.000€, kurse fitimi për një punëtor është 5.000€.

Problemi ekologjik si te programet tjera.

8. PROGRAMI I PRODHIMIT TË KAPAKËVE FILETORE TË TIPIT PILFER PROOF

Kapakët filetove prodhohen nga alumini ose llamarina e bardhë. Në kuadër të këtij programi prodhohen kapakët filetove të këputshëm nga alumini me dimensione 18, 20, 22, 24, 28, 33, 38, 45 dhe 55mm, për industrinë e pijeve dhe për industrinë farmaceutike.

Kapaciteti është 50.000.000 copë kapakë filetove në vit.

Për vendosjen e pajisjeve dhe magazinimin e prodhimtarisë nevojiten të sigurohen 250m² të hapësirës së mbuluar dhe 150m² lokale të tjera përcjellëse (zyrë, gardërobë dhe portieri).

Prej pajisjeve nevojiten presa e shpejtuar ekscentrike me vegla shumë goditëse pneumatike, transporti, turbo-fryrëse, makina për qortim, makina për shtypjen e filetit, vendosja-derdhja e plastikës etj.

Mund të punësohen 18 punëtorë me strukturë kualifikuese dhe profil përkatës.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të sigurohet kapitali në shumë prej 162.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 180.000€, raporti në 1€ investime 1,11€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 9.000€, kurse fitimi për një punëtor është 10.000€.

Programi aktivizohet për një vit, kurse kapitali i deponuar kthehet për një vit e gjysmë.

Problemi ekologjik si te programet tjera.

9. PROGRAMI I PRODHIMIT TË ZINK SHIRITAVE

Në kuadër të këtij programi prodhohen shiritat të leguruar me alumin për prodhimin e randeveleve për elektroindustrinë, zink shiritat të leguruar me plumb për industrinë e baterive, zink shiritat nga zinku i pastër për mbrojtjen katolike, zinko-grafine dhe elementet me destinim të veçantë.

Kapaciteti i tregut do të ishte 600 tonë zink shirita të pastër, 300t zink në bazë të A1 legurës dhe 300t zink shirita në bazë të plumbit.

Objekti ndërtimor duhet të ketë sipërfaqe prej 200m².

Pajisja kryesisht importohet dhe merr 85% të vlerës së tërësishme të kapitalit.

Mund të punësohen rreth 55 punëtorë.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të deponohet kapitali në shumë prej 220.000€, kurse bruto fitimi vjetor mund të jetë 180.000€. Raporti në 1€ investime 0,8€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 4.000€, kurse fitimi për një punëtor është 3.000€.

Afati i aktivizimit të programit është 6 muaj, kurse kthimi i kapitalit të deponuar për një vjet e gjysmë.

Problemi ekologjik si te programet tjera.

10. PROGRAMI I PRODHIMIT TË LIDHËSEVE PËR SHIRITA NË TRANSPORTIN HORIZONTAL PËR BARTJEN E ZHAVORRIT DHE GURËVE TË IMËT, RËRËS

Në kuadër të këtij programi prodhohen lidhëset për shirita në transportin horizontal për bartjen e zhavorrit (lidhëset me kukëza, pjesët e prapme lakuese të imët etj. Dhe elementet për sigurim.

Mund të prodhohen 10.000€ në vit.

Objekti ndërtimor ka sipërfaqen prej 150m².

Prej pajisjeve nevojiten makina për prerje, makina për lakim, aparatet për saldim, pajisja për paketim etj. Mund të punësohen 12 deri në 15 punëtor.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të sigurohet kapitali në shumë prej 120.000€, kurse bruto fitimi vjetor mund të jetë 80.000€. Raporti në 1€ investime është 0,80€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 8.000€, kurse fitimi për një punëtor është 5.300€.

Afati i aktivizimit të këtij programi është një vit, kurse koha e kthimit të kapitalit të deponuar është 2 vjet.

Problemi ekologjik i ngjashëm si te programet tjera.

11. PROGRAMI I PRODHIMIT TË PLLAKAVE TË SHTYPURA

Në kuadër të këtij programi prodhohen pllaka njështrësore, dyshtresore, shumështrësore dhe pllaka multiple.

Gjatë vitit mund të prodhohen 15.000 copë pllaka.

Objekti ndërtimor përfshin sipërfaqen prej 150m².

Mund të punësohen 30 punëtorë.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të sigurohet kapitali në shumë prej 187.500€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 187.500€, raporti në 1€ investime është 1€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 6.250€ e gjithashtu edhe fitimi për një për një punëtor është i njëjtë.

Programi aktivizohet brenda vitit, kurs kapitali i deponuar mund të kthehet për një vit gjysmë.

Problemi ekologjik i ngjashëm si te programet tjera.

12. PROGRAMI I PRODHIMIT TË STABILIMENTEVE (APARATEVE, SHPUTËZAVE DHE PJESËVE PËR NIVELIZIM) PËR KOFEKSION

Duke marrë parasysh lëmin e aplikimit (koleksionimin) stabilimentet ndahen në aparate me destinim special dhe në aparate të cilat përfordohen në makina të thjeshta dhe speciale.

Gjatë vitit mund të prodhohen 11.000 copë aparate, 1.000 copë shputëza dhe 1.000 copë për nivelizim.

Objekti ndërtimor është në madhësi prej 120m².

Prej pajisjeve duhet të përdoren presa hidraulike, vinçi me kanzulletorne universale, makinë shpuese, vegla të ndryshme për prerje dhe lakim, automobili.

Mund të punësohen 20 punëtorë.

Për realizimin e këtij programi nevojitet kapitali prej 140.000€, ku do të realizohej bruto fitimi vjetor prej 70.000€. Raporti në 1€ investime është 0,5€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 7.000€, kurse fitimi për një punëtor është 3.500€.

Afati i aktivizimit të programit për 1 vit, kurse afati i kthimit të kapitalit të deponuar për 2 vjet.

Problemi ekologjik si te programet tjera.

13. PROGRAMI PRODHUES – SHËRBIMET NDËRTIMORE – ZEJTARE PËR MIRËMBAJTJEN E BANESAVE

Për kryerjen e kësaj veprimtarie nevojitet të sigurohet lokali prej 50m² si lokal afarist dhe 20m² për depo.

Prej pajisjeve nevojiten (automjeti, mikseri, pompa, veglat për punë ndërtimore, zejtare, veglat e dorës, inventari i repartit dhe afarist etj.

Mund të punësohen 20 punëtorë.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të sigurohet kapitali në shumë prej 60.000€, bruto fitimi vjetor është 70.000€, raporti në 1€ investime është 1,20€ bruto fitim.

Një vend i punës kushton 3.000€, kurse fitimi për një punëtor është 3.500€.

Programi aktivizohet brenda vitit, kapitali i deponuar kthehet po ashtu brenda vitit.

Problemi ekologjik i ngjashëm si te programet tjera.

14. PROGRAMI PRODHUES – SHËRBIMET ELEKTROINSTALUESE PËR MIRËMBAJTJEN E BANESAVE

Për kryerjen e kësaj veprimtarie nevojitet të sigurohen 70m², e prej kësaj 50m² lokal afarist.

Prej pajisjeve nevojiten automjeti, aparati për saldim, pompa, kompletet e veglave elektroinstaluese, inventari i repartit dhe afarist etj.

Mund të punësohen 20 punëtorë.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të sigurohet kapitali në shumë prej 60.000€, ku do të realizohej bruto fitimi vjetor në shumë prej 70.000€. Raporti në 1€ investime është 1,2€ bruto fitim.

Një vend i punës kushton 3.000€, kurse fitimi për një punëtor është 3.500€.

Problemi ekologjik i ngjashëm me programet tjera.

15. PROGRAMI PRODHUES – SHËRBIMET E INSTALIMIT TË UJIT NË MIRËMBAJTJEN E BANESAVE

Për kryerjen e punëve të instalimit të ujit nevojitet të sigurohet hapësira në madhësi prej 70m².

Prej pajisjeve nevojiten automjetet, makina për shpuarjen e mureve, saldimi dhe shqyrtimi i vlerave matëse, veglat komplet, inventari i aparatit dhe afarist. Mund të punësohen 20 punëtorë.

Për realizimin e këtij programi nevojitet të sigurohet kapitali në shumë prej 60.000€, ku do të realizohej bruto fitimi në shumë prej 70.000€. Raporti në 1€ investime është 1,2€ bruto fitim.

Një vend i punës kushton 3.000€, kurse fitimi për një punëtor është 3.500€. Programi aktivizohet brenda vitit e gjithashtu edhe kapitali i deponuar kthehet brenda vitit.

16. PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT AUTOTRANSPORTUES

Me themelimin e kooperativave krijohen mundësitë për bashkimin e numrit më të madh të autotransportuesve individual, pastaj krijohen kushte për punësim të punëtorëve të rinj për kryerjen e shërbimeve më kualitative të autotransportuesve, bëhet lidhshmëria më e madhe në bazë të fitimit me ndërmarrjet shoqërore dhe me ato private, mund të bëhet planifikimi afatgjatë për zhvillimin e këtyre shërbimeve etj.

Në kooperativë kryesisht do të organizohen këto punë: furnizimi i autotransportuesve të bashkuar me pjesë rezervë dhe me mjete të tjera të punës.

- Organizimi i marrëdhënieve kooperuese me ndërmarrjet shoqërore dhe private.
- Punët kreditore-kursimore për nevoja të kooperativës.
- Punët administrative-profesionale dhe punë të tjera.

Me themelimin e kooperativës në marrëdhënie të rregullt pune do të punësoheshin 10 punëtorë, ndërsa numri i zejtarëve, respektivisht i autotransportuesve të bashkuar në fazë e parë do të ishte diku rreth 70.

Për realizimin e këtij programi duhet siguruar sipërfaqen e nevojshme prej 40m², kapitalin në shumë prej 40.000€, bruto fitimi vjetor do të jetë 30.000€, kurse raporti në 1€ investime është 0,75€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 4.000€, kurse fitimi për një punëtor 3.000€. Afati i aktivizimit të programit është 3 muaj, kurse kapitali i deponuar kthehet për një vit e gjysmë.

17. PROGRAMI PËR FORMIMIN E PUNËTORISË METALO-PËRPUNUESE

Këtë punëtori duhet locuar qendrat shkollore me qëllim të aftësimin të kuadrove profesionale ku kryesisht do të angazhoheshin nxënësit e shkollave, qendrave zeytare për prodhimin e mallit jashtë standardit, përpunimin e çelikut, bronzit, mesingut dhe metaleve të tjera. Për realizimin e këtij programi ekziston lënda e parë që mund të sigurohet në tregun e vendit, ndërsa disa vegla mund të prodhohen në vetë punëtorinë ose në fabrikën e veglave dhe të autopjesëve tek ne.

Për realizimin e këtij programi nevojitet sipërfaqe prej 150m², të punësohen 25 punëtorë, të angazhohet kapitali prej 110.000€, ku do të realizohet bruto fitimi vjetor prej 77.000€.

Rëndësia e këtij programi qëndron jo vetëm në aftësimin e kuadrove profesionale prodhuese por edhe në plotësimin e nevojave të tregut për shumë produkte që do të prodhoheshin sipas porosisë për nevojat e ndërtimtarisë, për nevojat e amvisërisë etj.

Problemi ekologjik nuk është aq i shprehur.

18. PROGRAMI PËR PRODHIMIN E MULLINJVE TË DORËS PËR BLUARJEN E MISHIT, KAFES, PEMËVE E PERIMEVE

Për realizimin e këtij programi duhet siguruar lëndën e parë si llamarinën e zinkuar dhe çelikon nga shkretoret e ndryshme. Pajisjet mund të sigurohen në tregun e brendshëm, ndërsa prodhimet destinohen kryesisht për konsum të gjerë. Duhet prodhuar në dimensione dhe sortiman të ndryshëm, dizajni të jetë i mirë dhe të kenë çmime të volitshme me qëllim që këto produkte të depërtojnë te një numër sa më i madh i familjeve që do t'i përdornin për nevoja të përditshme, e veçanërisht për përgatitjen e lëngjeve, mishit për friz, përgatitjen e kafes së freskët etj.

Ky program punëson 30 punëtorë, nevojitet sipërfaqe prej 150m², të deponohet kapitali në shumë prej 100.000€, bruto fitimi vjetor 40.000€, raporti në 1€ investime është 0,4€.

Çmimi i një vendi të punës është 3.300€, kurse fitimi për një punëtor XX0€.

Programi aktivizohet brenda vitit, kurse kapitali kthehet për një vit e gjysmë.

Problemi ekologjik si te programet tjera.

19. PROGRAMI PËR PËRFITIMIN E VAJIT ETIRIK NGA MBETURINAT E DRURIT (NGA HALORET, DELLINJES, GJETHEVE TË MAJDANOZIT)

Lënda e parë për këtë program sigurohet nga treva e Deçanit, Istogut, Dragashit. Vaji elektrik mund edhe të importohet. Plasohet kryesisht përmes prodhimeve të industrisë farmaceutike, kozmetike, mjeteve për larje dhe pastrim. Nevojitet sipërfaqja prej 100m², punësohen 10 punëtorë, **kapitali i deponuar 80.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 40.000€. Raporti në 1€ investime është 0,5€ bruto fitim.**

Çmimi i një vendi të punës është 4.000€, kurse fitimi për një punëtor është 2.000€. Programi aktivizohet brenda vitit, kurse kapitali i deponuar kthehet për 2 vjet.

Për realizimin e këtij programi përveç punëtorëve të përhershëm punësohen edhe një numër i madh kooperantësh që mund të realizojnë të ardhura për familjet e tyre.

20. PROGRAMI I PRODHIMIT TË ENËVE NGA QERAMIKA DHE ARGJILA (GLINA)

Në kuadër të këtij programi prodhohen enë të ndryshme me karakter dekorativ që mund të gjejnë plasman të volitshëm si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm. Lënda e parë mund të sigurohet në tregun e brendshëm kurse pajisja për prodhimin e këtyre prodhimeve mund të blihet në tregun e brendshëm dhe në atë të jashtëm.

Në kuadër të këtij programi mund të punësohen 30 punëtorë, sipërfaqja e nevojshme është 210m², kapitali i deponuar në shumë prej 150.000€. Bruto fitimi vjetor 60.000€, raporti në 1€ investime është 0,4€ bruto fitim.

Një vend i punës kushton 5.000€, kurse fitimi për një punëtor është 2.000€.

Programi aktivizohet për një vjet, kurse kapitali i deponuar kthehet për 2 vjet.

Problemi ekologjik nuk është i shprehur.

21. PROGRAMI I PRODHIMIT TË ELEMENTEVE NGA QERAMIKA

Në kuadër të këtij programi mund të përdoret mielli i gurit, rëra, çimentoja. Mund të prodhohen galanteritë e betonit.

Baza e lëndës së parë gjendet në trevën e Kaçanikut, Deçanit, Mitrovicës ndërsa kallëpet mund të sigurohen në vend dhe nga bota e jashtme.

Mund të punësohen 30 punëtorë, nevojitet sipërfaqe prej 210m², kapitali i deponuar është 140.000€, bruto fitimi vjetor 56.000€, raporti në 1€ investime është 0,4€ bruto fitim.

Një vend i punës kushton 4.700€, kurse fitimi për një punëtor është 1.900€.

Programi aktivizohet brenda vitit, kurse kapitali i deponuar kthehet brenda 2 vjetëve.

22. PROGRAMI I PRODHIMIT TË GJILPËRAVE DHE PRODUKTEVE TË NGJASHME (PËRTHEKUESE, GJILPËRA ME KOKË)

Në kuadër të këtij programi prodhohen gjilpëra për amvisëri, për qepje me dorë dhe në makinë.

Duke pasur parasysh zhvillimin e industrisë së tekstilit e sidomos punës me dorë këto prodhime janë gjithnjë e më të kërkuara. Lënda e parë mund të sigurohet nga tregu i brendshëm dhe i jashtëm. Makinat duhet të jenë të specializuara.

Në kuadër të këtij programi punësohen 30 punëtorë. Sipërfaqja nevojshme për realizimin e këtij programi është 200m², kapitali i deponuar rreth 150.000€, bruto fitimi vjetor është 75.000€, kurse raporti në 1€ investime është 0,5€ bruto fitim.

Një vend i punës kushton 5.000€, kurse fitimi për një punëtor është 2.500€.

Programi aktivizohet brenda vitit, kurse kapitali i deponuar kthehet për një vit e gjysmë.

Problemi ekologjik nuk është shprehur.

23. PROGRAMI I PRODHIMIT TË GALANTERISË METALIKE

Në kuadër të këtij programi mund të prodhohen produkte të ndryshme si pulla, përthekuese, shnalla që mund të përdoren në prodhimet e konfeksionit dhe në amvisëri. Zhvillimin e këtij programi duhet lidhur me zhvillimin e industrisë së tekstilit dhe të lëkurës.

Lënda e parë gjendet në tregun e brendshëm dhe të jashtëm dhe ka karakter special. Makinat blihen në tregun e jashtëm.

Për realizimin e këtij programi nevojitet sipërfaqe prej 250m², të angazhohet kapitali në shumë prej 150.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 60.000€, raporti në 1€ investime është 0,4€ bruto fitim.

Mund të punësohen 30 punëtorë.

Çmimi i një vendi të punës është 5.000€, kurse fitimi për një punëtor është 2.000€.

Programi aktivizohet për një vit, kurse kapitali i deponuar kthehet për 2 vjet.

Ky program mund të lokohet në qendrat e qytetit ku banojnë më se 30.000 banorë.

24. PROGRAMI I PRODHIMIT TË SHKREPSAVE PREJ DRURI

Në kuadër të këtij programi mund të prodhohen shkrepset të kombinuara me dru dhe plastikë, si dhe ambalazhi me dizajn të veçantë. Për prodhimin e këtyre produkteve lënda e parë mund të sigurohet në tregun e brendshëm, ndërsa substancën kimike duhet siguruar në bashkëpunim me rrjetin tregtar që merret me shitjen e kësaj materie. Produkti është i destinuar për konsum të gjerë.

Programi punëson 30 punëtorë, sipërfaqja e nevojshme 150m². Duhet të angazhohet kapitali në shumë prej 100.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 70.000€. Raporti në 1€ investime është 0,7€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 3.300€, kurse fitimi për një punëtor është 2.300€.

Programi aktivizohet brenda vitit, e gjithashtu edhe kapitali i deponuar kthehet brenda vitit.

Problemi ekologjik nuk është i shprehur.

25. PROGRAMI I PRODHIMIT TË GALANTERISË SË LETRËS

Në kuadër të këtij programi përpunohen mbështjellësit për ëmbëlsira, pjata për një përdorim, gota të ndryshme etj.

Në kuadër të këtij programi kemi të bëjmë me numër të madh të materialeve që mund të shërbejnë si produkte reklamuese, dekorative të punuara nga lloje të ndryshme të letrës.

Ky program është projektuar për përpunimin e galanterisë së kartuçit në seri të vogla. Prodhimet mund të jenë sipas porosisë. Pajisja teknike është kryesisht nga tregu i jashtëm. Programin duhet locuar në vendet konsumuese, kryesisht në ato urbane ku gjenden objektet hoteliere turistike, objektet industriale etj. Duhet kushtuar kujdes dizajnit, kualitetit, çmimit të prodhimit, organizimit të shitjes etj.

Për realizimin e këtij programi nevojitet sipërfaqja prej 100m², mund të punësohen 20 punëtorë, kapitali i deponuar është 75.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 50.500€, raporti në 1€ investime është 0,7€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 3.750€, kurse fitimi për një punëtor është 2.600€.

Programi aktivizohet për një vit, kurse kapitali i deponuar kthehet brenda vitit. Problemi ekologjik nuk është i shprehur.

26. PROGRAMI I PRODHIMEVE NGA LLAMARINA

Në kuadër të këtij programi mund të themelohet punëtorja që kryesisht do të kryhet puna me dorë me ndihmën e makinave dhe veglave të thjeshta. Prodhimet janë të serisë së vogël dhe unikate, me dimensione, lloje dhe trashësi të ndryshme të llamarinës. Përveç produkteve që destinohen për konsum të gjerë mund të prodhohen edhe sipas porosisë.

Në tërësitë urbanistike ku jetojnë me së 20.000 banorë mund të zhvillohet ky program e veçanërisht ku jetojnë 5-6 njësi ndërtimore me numër të madh banorësh është e nevojshme të formohet një punëtor i tillë e cila duhet të jetë sa më larg ndërtesave për shkak të zhurmës që shkaktohet gjatë punës në punëtor. Programi duhet të jetë elastik ndaj kërkesës.

Produktet duhet të jenë të kualitetit të lartë, çmimi i volitshëm si dhe të jepet garancioni për produktet e kryera.

Për realizimin e këtij programi nevojitet sipërfaqja prej 90m², të punësohen 10 punëtorë, kapitali i deponuar të jetë 64.000€, bruto fitimi vjetor 90.000€. Raporti në 1€ investime është 1,4€ bruto fitim vjetor.

Çmimi i një vendi të punës është 6.400€, kurse fitimi për një punëtor 9.000€. Programi aktivizohet për një vit, kurse kapitali i deponuar kthehet brenda vitit.

27. PROGRAMI PËR FORMIMIN E PUNËTORISË SË FARKËTARISË

Zeja e farkëtarëve është e njohur, puna e tyre është e respektuar dhe e kërkuar, mirëpo për shkak të nivelit teknik aktiviteti i kësaj zeje ka qenë në margjinë.

Në kuadër të kësaj punëtorie mund të kryhen punë të ndryshme në prodhimin e rrethojave të oborreve, ballkoneve, roletneve, mbrojtjes për dritare, vitrina, shtylla për radiator, mbrojtës, rrethoja për kamion etj.

Këto produkte duhet të jenë kualitative dhe dekorative, që mund t'i kryejë vetëm zeja e farkëtare. Prodhimet janë të tipit të serisë së vogël, kryesisht unikate me veti dekorative dhe të ndërtuara prej llojeve të ndryshme të farkimit në baza tradicionale.

Nevojitet sipërfaqja prej 100m², ku do të punësoheshin 10 punëtorë, me një angazhim të kapitalit në shumë prej 80.000€ dhe bruto fitim vjetor prej 76.000€. Raporti në 1€ investime është 0,95€ bruto fitim.

Një vend i punës kushton 8.000€, kurse fitimi për një punëtor është 7.600€.

Programi aktivizohet brenda vitit, kurse kapitali i deponuar kthehet për një vit e gjysmë.

28. PROGRAMI PËR MBËSHTJELLJEN E MOTORËVE

Servisi i tillë mund të themelohet pothuajse në çdo komunë. Lënda e parë duhet të jetë teli prej bakri dhe prej llamarinës me dimension të ndryshëm që mund të sigurohet në tregun e brendshëm.

Shërbimet mund të kryhen për nevoja të ndërmarrjes, gjegjësisht për personat fizik.

Nevojitet sipërfaqja prej 50m², të punësohen 10 punëtorë, të angazhohet kapitali në shumë prej 40.000€, bruto fitimi vjetor 28.000€.

Çmimi i një vendi të punës është 4.000€, kurse fitimi për një punëtor është 2.800€.

Programi aktivizohet për 3 muaj, kurse kapitali kthehet për një vit e gjysmë.

29. PROGRAMI I REPARTIT TË SPECIALIZUAR PËR MBROJTJEN SIPËRFAQËSORE

Reparte të tilla mund të formohen në çdo ndërmarrje të madhe që do të shërbente për nevoja të veta, por edhe repart që do të ishte qendror për nevoja të shumë ndërmarrjeve. Pajisja mund të jetë nga vendi, lënda e punës mund të sigurohet nga ndërmarrjet e vendit, veçmas nga Trepça etj. Shërbimet do të kryheshin edhe për nevoja të qytetarëve.

Për realizimin e këtij programi nevojiten 150m² lokal, mund të punësohen 20 vetë, kapitali i deponuar duhet të jetë 105.000€, bruto fitimi vjetor është 73.500€, raporti në 1€ investime është 0,7€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 5.250€, kurse fitimi për një punëtor është 3.700€. Programi aktivizohet për 6 muaj, kurse kapitali i deponuar mund të kthehet brenda vitit.

Nuk është i shprehur problemi ekologjik.

30. PROGRAMI I SERVISIT TË SHËRBIMEVE DAKTILOGRAFIKE

Në kuadër të këtij programi do të kryheshin punët e shtypjes, fotokopjimit, të shumëzimit, korrektura, lektura, redaktura etj. Nevojiten të sigurohen 15 deri 20 kompjuterë, disa aparate fotokopjuese, tavolina me karrige.

Mund të aftësohen lokalet e pashfrytëzuara ose të adoptohen lokalet në ndërtesa dhe shtëpi ekzistuese. Shërbimet mund të kryhen kryesisht për ndërmarrje dhe institucione të tjera, mund të ofrohen edhe shërbime informatike – administrative siç janë punët administrative në shërbimet e udhëheqjes së ndërmarrjes që kryhen përmes sektorëve teknike. Këto servise mund të formohen në ato qendra ku janë të koncentruar numër i madh i ndërmarrjeve dhe i punëtorive të pavarura.

Në çdo servis apo byro të tillë mund të punësohen 15 punëtorë, të sigurohet sipërfaqja prej 75m², kapitali i deponuar është 50.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 45.000€. Raporti në 1€ investime është 0,86€ bruto fitim.

Çmimi i një vendi të punës është 3.300€, kurse fitimi për një punëtor është 3.000€. Programi aktivizohet për një vjet, kurse kapitali i deponuar kthehet për një vjet e gjysmë.

Problemi ekologjik nuk është i shprehur.

Këso servile mund të hapen në çdo qendër ekonomike kulturore të përafërsisht 30 serviseve të tilla që do të punësonin 450 punëtorë. Sipërfaqja e nevojshme për këto servile është 2.250m², kapitali i deponuar afër 1.500.000€, bruto fitimi vjetor mund të jetë 1.350.000€. Raporti në 1€ investime është 0,9€ bruto fitim.

Literatura

- AFADAS, “Aspekte të drejtimit financiar të agrobiznesit”.
- Analiza dhe Studime të Zhvillimit Ekonomik Shoqëror të Kosovës hartuar nga Ministrinë e Ndryshme të Qeverisë së Kosovës.
- Arthur Young “The managers Handbook”.
- G. Howard Poteet, UNIDO, Doracakët “Filloni dhe përparoni biznesin tuaj”, të botuara nga ILO, “Starting up your own business”.
- Harold B. Maynard, HANDBOOK OF MODERN MANUFACTURING MANAGEMENT, 1980.
- Harvey S. Rosen “Financa publike”.
- ILO “Improve Your Business”, 2001.
- ILO, “Know about business, training package”.
- Irving Burstiner “Small business handbook”.
- Isak Mustafa - Bazat e Ekonomisë së Ndërmarrjes
- Isak Mustafa - Biznesi në Ekonominë e Tregut
- Isak Mustafa “Ligjerata të shkruara nga Burimet Njerëzore” tema: “Të mësuarit në një organizatë” në kuadër të kurs specializimit të studimeve posdiplomike, të mbajtura më 16 dhe 17 prill 2004, Univerziteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi Fakulteti Ekonomik në Shkodër.
- Isak Mustafa “Ligjerata të shkruara për lëndën mësimore Kontabiliteti Financiar i Avancuar “ Univerziteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi Fakulteti Ekonomik, dhjetor 2003.
- Isak Mustafa “Ndërmarrja në Biznesin Bashkëkohor”, 1997.
- Isak Mustafa “Referatet hyrëse të Konferencës së parë dhe dytë Ndërkombëtare të Biznesit dhe Punësimit” mbajtur në Pejë, 2002, 2003
- Isak Mustafa “Shfrytëzimi i artikujve të ndryshëm të nxjerrura nga interneti”.
- Isak Mustafa, “Biznesi në Ekonominë e Tregut”, QBV “EUREKA” 1992.
- Isak Mustafa, “Puna në Biznes”1991, QBV “EUREKA”
- Isak Mustafa, “Bazat e Ekonomisë së Ndërmarrjes”, 1972 Prishtinë.
- Isak Mustafa, “Drejtori në Udhëheqjen e Biznesit” , QBV “EUREKA”- Pejë 1993.
- Isak Mustafa, “Ligjerata të shkruara nga Marrëdhëniet kombëtare dhe ndërkombëtare”, tema: “Funksioni i kontratave në zhvillimin e ekonomisë së tregut”, në kuadër të kurs specializimit të studimeve posdiplomike të mbajtura më 18 dhe 19 qershor 2004, Univerziteti i Vlorës Ismail Qemali Fakulteti i tregtisë në Vlorë.
- Isak Mustafa, “Organizimi i sistemit financiar të ndërmarrjeve industriale të Kosovës”, 1980.
- Isak Mustafa, Bashkëpunimi Ekonomik i Shkodrës me Pejën, Simpoziumi Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”, Shkodër, 2002.
- Isak Mustafa, Kahjet e Kosovës në Integrimet Evropiane, punim në Konferencën Ndërkombëtare, “Integrimet Evropiane”, Shkodër, 2004
- Isak Mustafa, Ligjerata e mbajtur në seminarin e ndryshme për nevojat e kadrove të administratës lokale dhe qendrore të Kosovës, 2000-2002
- Isak Mustafa, ligjeratë në seminarin e International Training Centre Of The ILO Enterprise Development Programme

Isak Mustafa, Roli i funksionit të kualitetit në sistemin e menaxhimit të ndërmarrjes”, prezentuar në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare “Ditët e Kualitetit”, Prishtinë, 2003

Isak Mustafa, Work Paper, “New Program Initiatives for Study Enterprises Development Information System in Kosova”, prezentuar në Work Shop “Information Society: trends, poicies and strategies”, organized by “Dunarea de Jos” University Galati, Romania

J.D. Ryan, Lee A. Eckert, Robert J. Ray, “Small Business an enterpreneur’s plan”.

Josef L Bower, “Mjeshtria e drejtimit të përgjithshëm” , 1993.

Lewis J.Altfest and Alan B.Lechner “Introduction to Business”, 1978 New York.

Local and regional tax administration in transition countries, Budapest, Hungary, 2000

MANAGEMENT I PODUZETNISTVO, 1000 Programa Ulaganja za Mala i Srednja Poduzeca, Zagreb1994.

Michael Wots - Çfarë është Ekonomia e Tregut?

Punimet e prezentuara në delnet nga programi i qendrës ndërkombëtare ILO, UNDP.

R. W.Mondy, A.Sharplin, E.B.Flippo 1988 Allyn and Bacon, Management INC, Boston, Toronto.

Raymond W.Y.Kao, “Enterpreneurship and enterprise development”,.

Verner Vajdenfeld, Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Evropën Lindore, 1999

W. Edwards Deming, THE NEW ECONOMICS For Industry, Government, Education, 1994.